

UNIVERSITETI I EJL
ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY

FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT
ФАКУЛТЕТОТ ЗА ЈАЗИЦИ, КУЛТУРИ И КОМУНИКАЦИЈА
FACULTY OF LANGUAGE, CULTURE AND COMMUNICATION

STUDIME PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

TEZA:

TEORITË BASHKËKOHORE TË KOMUNIKIMIT DHE SJELLJA E GJINIVE NË RJETET SOCIALE
KOMUNIKUESE

KANDIDATI:

Burbuqe Kaprolli Hamzai

MENTORI:

Doc. Dr. Veton Latifi

Tetovë, Maj 2011

Tabela e përmbajtjes:

Abstrakti.....	4
Fjalët kyçe.....	8
Hyrja.....	8
Pjesa e parë	
I. Hulumtimet paraprake-Rishikimi I literaturës.....	12
Teoritë e komunikimit.....	12
1.1 Teoria e penetrimit social- <i>Irwin Altman Dalmás Taylor</i>	12
1.2 Teoria e gjinive- <i>Deborah Tannen</i>	15
1.2.1 Femrat dëshirojnë lidhje, ndërsa meshkujt status.....	17
1.2.2 Biseda raportuese kundër bisedë së reportit.....	17
1.2.3 Të folurit publik përballë të folurit privat.....	18
1.2.4 Mënyra e tregimit të ngjarjeve.....	18
1.2.5 Dëgjimi.....	19
1.2.6 Parashtrimi i pyetjeve.....	19
1.2.7 Konflikti.....	19
1.3 Teoria e kultivimit- <i>George Gerbner</i>	20
1.3.1 Shfaqja e agresionit fizik.....	21
1.3.2 Frikë nga ecja vetë natën.....	21
1.3.3 Aktivitetet e perceptuara të policëve.....	22
1.3.4 Mosbesimi i përgjithshëm i njerëzve.....	22
II. Rrjeti social bashkëkohor.....	22
2.1 Historiku i rrjetit social.....	22
2.2 Faktet mbi përdorimin e rrjetit social.....	23
2.3 Varshmëria e të rinjve nga interneti.....	25
2.4 Teoria e internetit- <i>Hans Dieter Huber</i>	27
III. Komunikimi dhe rrjeti social <i>facebook</i>	28
3.1 Depërtimi I meshkujve dhe femrave në rrjetin social.....	28
3.2 Argumentet pro dhe kundër teorive paraprake.....	29
3.2.1 Përdorimi i gjuhës dhe gjinitë.....	29

3.2.2	Konsistencën kognitive përballë bisedave kundër argumentuese.....	29
3.2.3	Pseudonimi përballë zbulimi i vetes.....	29
3.2.4	Promovimi i vetes përballë mbylljes së vetes.....	29
3.2.5	Komunikimi i argumentuar përballë komunikimi i ndërtuar mbi marrëdhënie.....	29
3.2.6	Temat diskutuese të femrave dhe meshkujve.....	29
3.2.7	Aktiviteti meshkuj përballë femra.....	30
3.2.8	Koha dhe vendi i zhvillimit të komunikimit.....	30

Pjesa e dytë

IV.	Formulimi i problemit dhe qëllimet kyçe.....	31
V.	Parashtrimi I hipotezave.....	33
5.1	Hipoteza kryesore: Po që se gjinitë përdorin internetin njëllonj, atëherë femrat do të hapin veten më tepër se meshkujt.....	33
5.2	Hipoteza ndihmëse: Po që se nxënësit e shkollave fillore në Gostivar përdorin njëllonj rrjetin social, atëherë shqiptarët do hapin veten më tepër se etnitë tjera.....	34
VI.	Metodologjia e punës.....	34
VII.	Instrumentet e përdorura në studim.....	35
7.1	Metoda kuantitative-sasiore, pyetësori.....	35
7.2	Metoda kualitative.....	36
a)	Studim Rasti.....	36
b)	Intervista.....	36
VIII.	Etika e hulumtimit.....	42

Pjesa e tretë

IX.	Grumbullimi dhe analiza e të dhënave.....	43
9.1	Të dhënat e përgjithshme.....	43
9.2	Analiza e rezultateve në bazë të pyetësorit.....	48
X.	Rishikimi I analizës së të dhënave-rezultatet.....	81
10.1	Krahasimi i të dhënave teorike dhe rezultateve të nxjerra në terren.....	85

Përfundimi.....	92
Shtojca 1-Pyetësorët.....	95
Literatura.....	107

Abstrakti

Ky hulumtim pretendon të analizojë sjelljen dhe raportet komunikuese të gjinive-etnive në shkollat fillore të Gostivarit në Maqedoni. Pjesa më e madhe e punimit gërsheton lidhjen në mes të aspektit teorik të komunikimit të gjinive-etnive si dhe zbatimit të po këtyre gjërave në praktikë.

Interneti dhe përdorimi i kompjuterit është bërë element bashkëkohor dhe i patjetërsueshëm i përditshmërisë sonë. Në mesin e shumë gjërave që shfrytëzohen në internet, facebook-u, si rrjet më i njohur social është bërë trend ekzistues kohëve të fundit.

Problemi që pretendon të prezantohet në këtë punim është analiza e disa nga vetive që shfrytëzuesit e këtij rrjeti përdorin gjatë kycje në të. Sjellja e gjinive, lloji i gjuhës që ata përdorin, komunikimi që ata kanë në mes veti si dhe varshmëria nga ky rrjet janë disa nga çështjet që analizohen këtu. Krahasimi i gjërave është bërë duke u nisur nga teoria e depërtimit social- hapjes së vetes, teorisë së gjinive dhe karakteristikave që ato shfaqin në përditshmëri, teorisë së kultivimit-sa sjelljet e gjinive dhe etnive mbjellin raporte sociale, si dhe teorisë së internetit dhe varshmërisë së sajë.

Ky punim mbështetet në dy hipoteza edhe atë:

- Hipoteza kryesore: Po që se gjinitë përdorin internetin njëllor, atëherë femrat do të hapin veten më tepër se meshkujt.
- Hipoteza ndihmëse: Po që se nxënësit e shkollave fillore në Gostivar përdorin njëllor rrjetin social, atëherë shqiptarët do hapin veten më tepër se etnitë e tjera.

Metodat e përdorura në hulumtim janë:

- Metoda kuantitative-sasiore, pyetësi dhe numri i përgjithshëm i të anketuarve është 237. Grupa e fokusit përbëhet nga nxënës të katër shkollave fillore në Gostivar edhe atë: Ismail Qemali, Goce Dellçev, Vëllazërim Bashkimi si dhe Mustafa Kemal Atatürk.
- Studim rasti me ç'rast është bërë analiza e profilit të nxënësve të shkollave fillore si dhe,
- Intervista e cila është zhvilluar në katër shkollat fillore me 20 nxënës të klasave varësisht lejes që ata kanë dhënë për të bërë intervistën.

Pas përfundimit të analizave pritet që femrat dhe shqiptarët të jenë më të hapur dhe komunikativ, në krahasim me të anketuarit e tjerë. Gjithashtu pritet që nxënësit shqiptarë dhe meshkujt të jenë shfrytëzuesit më të mëdhenj të rrjetit social bashkëkohor në krahasim me etnitë dhe gjininë tjetër. Ky punim do të sjell një laramani përgjigjesh të cilat rezultate do të përfaqësojnë situatën reale të sjelljes së nxënësve të shkollave fillore në Gostivar.

Абстрактот

Ова истражување има за цел да го анализира однесувањето и односите на комуницирање на родовите-етникумите во основните училишта во Гостивар-Македонија. Во најголемиот дел на трудот се испреплетува врската, односот меѓу теоретскиот аспект на податоците како и спроведувањето на овие работи во практика.

Интернетот и употребата на компјутерот стана современ неоспорен елемент на нашето секојдневие. Меѓу најголемиот број на работи кои што се користат на интернет, facebook како и познатата социјална мрежа станаа постоечки тренд во последно време. Проблемот и целта која се презентира на овој труд е да изврши анализа на некои од карактеристиките на оваа мрежа кои што ја користат истата при приклучување на истата. Односот помеѓу машкиот и женскиот род, јазикот кој што го користат, комуникацијата која што ја имаат меѓусебно како и зависноста од оваа мрежа се некои од прашањата кои се спроведуваат во овој труд. Анализата на нештата почнува од теоријата на социјалниот продор-отварањето на себе си, теоријата на родовите како и карактеристиките кои што истите ги изразуваат во текот на секојдневието, теоријата на негување на тоа колку родовите и етникумите создаваат социјални односи, како и теоријата на интернетот и нивната зависност.

Овој труд се засновува врз две хипотези и тоа:

- Главна хипотеза: Доколку родовите го користат интернетот еднакво, тогаш женските ќе се отворат себе си повеќе од машките

- Помошна хипотеза: Доколку учениците од основните училишта во Гостивар ја користат исто социјалната мрежа, тогаш Албанците ќе се отворат себе си повеќе од другите етникуми

Методите кои што се искористени во текот на истражувањето се:

- Квантитативна-количинска метода, прашалникот и вкупниот број на анкетирани е 237.

Учесници беа ученици од четири основни училишта во Гостивар и тоа: Исмаил Кемали, Гоце Делчев, Велазерими-Башкими и Мустафа Кемал Ататурк.

- Студија на случај при што се извршени анализи на профилот на ученици во основните училишта како и

- Интервјуто кое што е водено во четири основни училишта по 20 ученици во паралелки во зависност од дозволата која беше дадена да се направи интервјуто

По завршувањето на анализите се очекува учениците од женски род и припадниците од Албанската националност да бидат по отворени и по комуникативни, во споредба со другите анкетирани. Истотака се очекува учениците Албанци и мажите да бидат најголемите корисници на

социјалата мрежа. Овој труд ќе донесе разноликост на одговори, резултати кои што ќе ја претставуваат реалната состојба на однесување на учениците по основните училишта во Гостивар.

Abstract

This research tends to analyze communicative behaviors and gender-ethnicity relationships of primary schools students in Gostivar, Macedonia. This research mostly combines the rapport between theoretical part of communication among gender-ethnicity and the implementation of the same things in practice.

The use of computer and internet became indelible and contemporary element of our daily life. Among the many things used on the internet, Facebook, the social network became a current trend recently.

The problem presented at this research is to analyze some of the features that social network users use while they are connected to it. Genders behavior, type of languages they are using, the form of communication they are using between them and their dependence from the social network these are some of the issues analyzed here. Comparison of things is done starting from the social penetration theory-self disclosure, gender theory and characteristics they appear on daily life experience, cultivation theory how much gender and ethnicity behavior help creating social relationship and internet theory plus its dependence.

This research is based in two hypotheses:

- The main hypothesis: If males and females use internet same, then females will disclose themselves more than males.
- Auxiliary hypothesis: If primary school students in Gostivar use social network same, then, Albanians will self-discourse more than other ethnicities.

Methods used at this research are:

- Qualitative method-questionnaire and the total number of interviewed students are 237. Focused group are students of four primary schools in Gostivar: Ismail Qemali, Goce Dellçev, Vëllazërim Bashkimi and Mustafa Kemal Atatürk.
- Case study in which it has been an analyze of students profile of primary school students and
- Interview which has been developed in four primary schools with 20 students dependents on the permeation they gave to make the interview.

After finishing these analyses it's expected that students with Albanian ethnic background and females to be more self-discoursed and communicative compared with the other interview students. Also, it's expected that that students with Albanian ethnic background and females to be the biggest users of contemporary social network in a comparison with other ethnicity and gender. This research will bring a wide amount of responses which results will represent the real situation of primary schools students behavior in Gostivar.

Fjalët kyçe

Teoria e Depërtimit (penetrimit), Teoria e Gjinive, Teoria e Kultivimit, Komunikimi, Facebook-rrjeti social komunikues, gjinitë, etnitë, nxënësit, kompjuteri.

Hyrja

Komunikimi është pjesë e pandashme e përditshmërisë njerëzore ashtu siç shprehet edhe vetë Paul Watzlawick në librin e tij *Pragmatics of human communication: "Ne nuk mund të mos komunikojmë"*. Ky proces mund të zhvillohet verbalisht apo joverbalisht ndryshe thënë duke u shkruar apo lexuar si dhe duke komunikuar nëpërmes të gjuhës trupore, gjesteve, mimikave të fytyrës, lëvizjeve të trupit e kështu e radhë. Nga ana tjetër të gjithë ne jemi dëshmitarë të kohës së teknologjisë dhe kompjuteristikës duke veçuar në këtë radhë përdorimin e rrjetit aq të njohur social të kësaj kohe, rasti i facebook-ut. Ditë për ditë numri i përdoruesve të saj rritet, kompani të mëdha publikojnë të rejtat aty, menaxherë të ndryshëm kontrollojnë profilin e kandidatëve të ri si dhe gazetarët shpesh e më shpesh publikojnë shkrimet e veta në rrjet. Pikërisht duke marrë parasysh këtë fakt, unë vendosa të bëj një studim rreth çështjes së këtij "preokupimi kaq të njohur modern".

Tema bazohet në krahasimin e aspekteve teorike dhe praktike të procesit të komunikimit. Është një ndërlidhje e *teorisë së penetrimit social, asaj të gjinive, dhe kultivimit* duke kombinuar me *komunikimin në internet*.

Pjesa e parë gërsheton aspektin teorik të sjelljeve njerëzore duke vazhduar më pastaj në të dhëna praktike të mbështetura në terren. Grupa e fokusit janë nxënësit e shkollave fillore në Gostivar edhe atë duke kombinuar nxënës të klasave të pesta, gjashta, shtata dhe të teta nga të tre etnitë, shqiptarë, maqedonas dhe turq, dhe normalisht nga të dy gjinitë, femra dhe meshkuj.

Problemi i trajtuar në punimin: *"Teoritë bashkëkohore të komunikimit dhe sjellja e gjinive në rrjetet sociale komunikuese"* është analiza e disa nga vetive që shfrytëzuesit e rrjetit modern social përdorin gjatë kyçjes në të. Nga ana tjetër ky studim gërsheton aspekte teorike të komunikimit, psikologjisë, sociologjisë dhe informatikës. Si sillen meshkujt në facebook dhe cila është sjellja e femrave aty? Kush nga këto dy gjini hapën veten më tepër? Cilat nga gjinitë publikojnë më tepër fotografi, komentojnë meshkujt më shumë apo femrat, kush nga gjinitë plotëson profilin më tepër? Mënyra e komunikimit dhe sjellja e gjinive është botë në vete, cila është kjo botë, si ta mësojmë atë dhe si të përmirësojmë sjelljen ndaj njëri tjetrit me qëllim që të kemi një komunikim më të suksesshëm janë preokupimet e këtij punimi. Gjatë gjithë kohës të dhënat krahasohen në mes të gjinive-meshkuj dhe femra si dhe tre etnive-shqiptarë, turq dhe maqedonas.

Punimi përfshin disa faza, fillimisht bëhen analiza dhe krahasime paraprake rreth këtyre çështjeve, çka autorë të ndryshëm shkruajnë rreth teorive dhe rrjetit social. Në këtë fazë analiza bazohet në studimet paraprake që janë bërë rreth këtyre lëmeve, duke u ndalur në teoritë apo elementet e tjera teorike, duke grumbulluar informata nga libra, artikuj të ndryshëm shkencor, gazeta, të dhëna nga faqe të ndryshme të internetit si dhe filma të ndryshëm që drejt për së drejti lidhen me këto çështje.

Faza e dytë përmban aspektin metodologjik, llojet e metodave të përdorura në studim. Theks i veçantë i përkushtohet hipotezës kryesore dhe asaj ndihmëse, teknikave të grumbullimit të të dhënave, analizave tabelare të bashkangjitura me grafikone të ndryshme.

Studimi në fjalë gërsheton dy hipoteza, atë kryesoren dhe ndihmësen. Hipoteza kryesore qëndron me sa vijon: Po që se gjinitë përdorin internetin njëllë, atëherë femrat do të hapin veten më tepër se meshkujt. Ky përfundim sillet nga vetë përditshmëria njerëzore, fakte të ndryshme dëshmojnë që femrat hapin veten më tepër nga meshkujt por, të dhënat në terren nuk janë dhe aq pro hipotezës së theksuar. Andaj punimit në fjalë i është bashkangjitur edhe hipoteza ndihmëse sipas të cilës thuhet se: Po që se nxënësit e shkollave fillore në Gostivar përdorin njëllë rrjetin social, atëherë shqiptarët do hapin veten më tepër se etnitë e tjera. Hipoteza e dytë del si rrjedhojë e analizave të bëra në terren. Shumica e shkollave fillore në Gostivar kanë kombinim të paraleleve edhe atë nga të tre etnitë. Nga ana tjetër ekzistojnë shkolla të mbushura me nxënës të vetëm një etnie siç janë shqiptarët apo vetëm turqit në shkollën Mutafta Kemal Atatürk.

Sipas rezultateve të nxjerra në terren mund të vërejmë që shqiptarët nuk janë etnia e vetme që hapin veten më tepër, bile nxënësit maqedonas janë ata të cilët më tepër hapin veten në krahasim me dy etnitë e tjera.

Përfundimisht duhet theksuar që faza e tretë përmban përshkrimin, komentimin e rezultateve duke krahasuar të dhënat e nxjerra në terren me të dhënat paraprakisht të analizuar në aspekt teorik. Në këtë fazë vërehet lehtë që aspekti teorik dhe ai praktik ndeshen në disa pika të përbashkëta dhe nga ana tjetër dëshmojnë të kundërtën në disa pika të tjera. Këtu, të dhënat e nxjerra në terren janë të bashkangjitura me një shumësi rezultatesh të përshkruara në tabela dhe grafikone. Të dhënat shpjegohen në mënyrë të detajuar.

Gjatë këtij punimi është shfrytëzuar metoda kuantitative gjegjësisht pyetësorin. Ai përbëhet prej gjithsej gjashtëmbëdhjetë pyetjeve me ç ‘rast, 1. pjesa e parë përbëhet prej të dhënave të përgjithshme edhe atë: gjinia, etniteti, klasa, shkolla si dhe e-mail adresa; 2. pjesa e dytë prej katërmbëdhjetë pyetjeve përbëhet prej të dhënave me të rrethuar, gjegjësisht përgjigjeve shkallë si dhe 3. pjesa e fundit prej pyetjeve të cilat kërkojnë përgjigje të hapura, mendimet e lira të anketuarve.

Përpos asaj, në studim është përdorur edhe studimi i rastit duke analizuar profilin e disa nga studentët, normalisht me lejen e tyre si dhe intervistën e cila të ndihmon në sjelljen e rezultateve akoma më të detajuara. .

Ajo që bën këtë punim më dinamik është pikërisht prezantimi i argumenteve i nxjerrë nga literatura e shumëllojshme mbi lëmin në fjalë, dhe rezultatet përfundimtare të zhvilluara në terren, gjegjësisht vendin tonë.

Pas analizës së studimeve në aspekt teorik dhe praktik, është bërë krahasim i këtyre të dhënave duke u mbështetur në argumente të cilat përkrahin hipotezat dhe disa të tjera të cilat prezantojnë rezultate të kundërta.

Sipas të dhënave në aspekt teorik dhe rezultateve të nxjerra në terren del që: Meshkuj dhe femrat: Meshkujt dhe nxënësit maqedonas u bëjnë më shumë komente gjinive që ato i përkasin. Meshkujt janë më të paraprirë për të paraqitur veten si “dominant” përderisa femrat janë ata të cilat shprehin veten në nivel më të ulët duke u pajtuar për vendimet apo qëndrimet që ka shprehur dikush tjetër. Meshkujt janë ata që dëshirojnë të promovojnë veten ndërsa femrat janë ata të cilat vetëm përkrahin atë që është thënë më parë femrat janë ata të cilat gati se gjatë tërë kohës paraprihen të japin komente siç janë: shumë bukur dukesh, edhe unë mendoj ashtu, edhe unë pajtohem me X personin që je fenomenale, fustanin e kishe shumë të bukur, vërtetë fustani ishte fantazi. Femrat janë ata të cilat japin përfundime dhe qëndrime të njëjta përderisa tek meshkujt vërehet pak a shumë një individualizëm.

Shqiptarët, turqit dhe maqedonasit: 37% e nxënësve shqiptarë kanë të publikuara foto provokative në rrjetin social për dallim nga etnitë e tjera të cilët kanë më pak foto nga këto. Në krahasim me etnitë, për sa i përket gjinive, rrjedh që 34% e meshkujve kanë të publikuara fotografi provokative në profilin tyre përderisa femrat shumë pak gati aspak. Gjysma e shqiptarëve deklarojnë që facebook ju pengon në kryerjen e obligimeve, përderisa pjesa më e madhe e maqedonasve mendojnë që nuk u pengon facebook. Turqit dhe femrat shkruajnë fjali më të gjata, shkruajnë komente më të gjata apo flasin më tepër. Nxënësit maqedonas janë më të hapur në publikim të fotografive në krahasim me nxënësit e tjerë në bazë të gjinive del që meshkujt kanë më tepër se 100 fotografi të publikuara në facebook. Nxënësit turq kontrollojnë profilin tyre gjatë orës së mësimi më shumë nga nxënësit e tjerë, meshkujve kontrollojnë profilin e facebook-ut gjithashtu gjatë orës së mësimi. Të tri etnitë dhe gjinitë përdorin rrjetin social facebook në shtëpi, besoj prindërit e tyre të jenë në dijeni për këtë gjë.

Punimi ka rëndësi të veçantë si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik. Përparësia e punimit në aspektin teorik është mungesa e studimeve të kësaj natyre në vendin tonë, dhe si e tillë gjen vend në grupin e temave më pak të punuara paraprakisht. Me këtë rast, studimi ndihmon nxjerrjen në pah të sjelljeve të fëmijëve në këtë rrjet, mënyrës së komunikimit, varshmërisë nga rrjeti social, analiza e mënyrës së njëjtë të menduarit, veprimit të njëjtë, sjellje e cila më pastaj ndikon në ndërtimin e personalitetit të tyre si individë. Ky punim ka rëndësi në fushën e komunikimit ndër personal ati grupor si dhe aspektit të varshmërisë nga teknologjitë bashkëkohore komunikuese.

Aspekti praktik I temës ndihmon në grumbullimin e të dhënave të cilat të dhëna japin rezultate reale mbi situatën në fjalë. Këto të dhëna ndihmojnë studimet në të ardhmen, hapin shumë fusha të reja analiza të cilat në vendin tonë fatkeqësisht janë të mangëta.

Pjesa e parë

I. Hulumtimet paraprake-Rishikimi I literaturës

Teoritë e komunikimit

1.1 Teoria e Penetrimit social-*Irwin Altman dhe Dalmás Taylor*

Procesi i komunikimit i cili zhvillohet gjatë takimeve të rralla apo shpeshta në mes të individëve është një çështje shumë e rëndësishme për shumicën e studiuesve. Si zhvillohen këto procese, si të kemi një komunikim me të suksesshëm dhe efektiv, si të tejkalojmë barrierat në mes veti dhe ca elemente të tjera janë preokupim i studiuesve të shkencave të komunikimit.

Gjatë periudhës së studimeve, studentët të cilët banojnë në qytetin ku studiojnë e kanë problem takimin e parë me shokun e dhomës të cilët ndajnë banesën bashkë. Takimi i parë, me kë do të jetoj në dhomë, si më qëllon shoku, çfarë veti ka ai janë çdo herë pyetje preokupuese për ta. Raportin në mes të individëve, sjelljen dhe qëndrimin e tyre e analizojnë edhe dy studiuesit Altman dhe Taylor¹.

Dy shokë që akoma nuk janë bërë miq të mirë janë në hall. Nuk e din në qoftë se do të behën shokë apo jo. Nuk e dinë për çfarë tema do të flasin? Njëri mendon për të dashurën e tij në shtëpi. Çka nëse ajo nuk më do më, me kë është tani ajo? Nga ana tjetër është në hall. Nuk e din në qoftë se duhet t'i tregojë shokut të dhomës apo jo, mund ta ndiej si për të afërt apo jo? Të ndajë këtë hall me shokut e dhomës së tij, njeriun më të afërt të universitetit? Fundja njeriun me të cilën e ndan dhomën e përbashkët. Njerëzit janë kompleks, natyra njerëzore është shumë komplekse Altman, Taylor (119). Njerëzit mendojnë për atë se si do flasin, çka të flasin, çka t'i thonë njëri-tjetrit dhe si t'ia thonë atë. Në atë moment djali mendon se si djemtë e mëdhenj nuk qajnë.

Teoria e Penetrimit apo Depërtimit shoqëror flet për marrëdhëniet njerëzore. Fazat se si zhvillohet afrimi njerëzor. Si bëhet krijimi apo ndërtimi i raporteve Altman, Taylor (119). Sipas këtyre dy studiuesve ky raport mund të krahasohet me kokrrën e qepës. Ashtu siç ka qepa disa cipa, dhe duke ja hequr ato ne i afrohem thellë e me thellë brendësisë së sajë, në të njëjtën mënyrë edhe njerëzit këmbëjnë informata. Fillimisht duke filluar nga më të përgjithshmet siç janë emri, mbiemri, nacionaliteti, vendi ku jetojnë duke vazhduar në ato më të komplikuarat dhe më intime. Normalisht kjo renditje nuk është e njëjte me të gjithë njerëzit njëloj. Ka raste kur ndodh që me një njeri të flasim me orë të tëra dhe të mos

¹ Teoria e penetrimit-depërtimit dhe teoritë e përfshira më poshtë janë të e përshkruar në detaje në librin “A first look at Communication theory” të studiuesit Emm Griffin.

e dimë se si e ka emrin apo mbiemrin ai person Altman, Taylor (119). Thellësia e hapjes së vetes sipas studiuesve shkon drejt qendrës së qepës, metaforikisht thënë Altman, Taylor (120). Sipas tyre në qendër nuk ka privatësi Altman, Taylor (120). Sa më thellë që depërtojmë fijet e qendrës aq edhe privatësia minimizohet dhe e kundërta, sa më sipërfaqësisht që kalojmë pjesët e qepës dhe flasim për informata intime, aq më larg jemi qendrës dhe aq më tepër i largohemi qendrës së qepës.

Thellësia e penetrimit është shkalla e intimitetit Altman, Taylor (120). Sipas studiuesve të dhënat periferike apo më të përgjithshme këmbehen më shumë dhe më shpejtë nga informatat private Altman, Taylor (121). Sipas studimit që kanë bërë këta të dy del që *65 për qind e të dhënave janë të përgjithshme apo informata publike, 19 për qind e të dhënave janë gjysmë private dhe vetëm 2 për qind e të dhënave që këmbehen janë informata intime.*

Hapja vetes është reciproke sidomos në fazat e para të hapjes. Do të jap aq informata sa ti do më japësh mua. Do të hap veten aq sa ti apo vetja jote Altman, Taylor (121). Në këtë fazë vjen në shprehje edhe bilanci, apo mosrespektimi i barabartë sjell në disbilanc apo prishje të komunikimit.

Penetrimi apo depërtimi është më i shpejtë në fillim dhe vazhdon duke u ngadalësuar më pas, në vazhdim, gjegjësisht në fazat e tjera Altman, Taylor (121). Njerëzit komunikojnë me njëri tjetrin tema të ndryshme në fillim, duke vazhduar në ato që i pëlqejnë të dytë shumë. Pas përcaktimit të temave të përbashkëta, apo gjërave që të dy apo më tepër palëve ju interesojnë, atëherë, ky raport bëhet më i afërt dhe më i qëndrueshëm.

Depenetrimi² është proces i cili mbyll fushat fazë-fazë, dalë ngadalë e jo menjëherë Altman, Taylor (121). Në këtë fazë mbyllja e hapësirave të hapura, bëhet gradualisht, nivel pas niveli. Hapja e vetes bëhet në thellësi e jo në fleta të ndryshme apo biseda të ndryshme. Njerëzit zgjedhin temat e bisedës, zgjedhin fazat e hapjes dhe më pastaj vazhdojnë hapjen në lidhje me këto biseda dhe nuk hapen të bisedojnë rreth temave të tjera. Rasti me shembullin në fjalë shokët e dhomës flasin thellë për temat që ata të dy kanë vendosur të flasin. Ai nuk i ka shpalosur shokut të vet faktin që babai i tij është alkoolik. Kjo është temë që nuk preferon të flasë me dikë tjetër po as edhe me shokun e dhomës së vet Altman, Taylor (122).

A do të jemi miq ne të dy në të ardhmen? Përgjigja do të ishte varet nga minuset dhe pluset që kam nga ti. Raporti i krijimit të marrëdhënies sipas studiuesve Thibaut dhe Kelley varet nga pluset dhe minuset që njerëzit kanë nga njëri tjetri Altman, Taylor (122). Ndryshe thënë varet nga përfitimet që u ngelin në fund, nga të ardhurat, kënaqësia racionale, dhe stabiliteti i lidhjes. Në qoftë se një palë ka stabilitet, kanë pika të përbashkëta apo tema të përbashkëta për të komunikuar atëherë normalisht që

² Depenetrimi është koncept të cilin e përdorin studiuesit Altman dhe Taylor. Kuptimi i këtij procesi parasheh të kundërtën e hapjes së vetes gjegjësisht mos hapjen e individëve apo mbylljen e tyre.

edhe do të vazhdojnë të mbajnë raporte të mëtutjeshme. Nga ana tjetër në qoftë se ky raport apo kjo marrëdhënie numëron më tepër minuse nga që janë pluset, kjo marrëdhënie do të ndërpritet.

Zakonisht individët mundohen të parashohin të ardhmen në kuptim të analizës se ku çon kjo shoqëri në të ardhmen? Sa mund të zgjas komunikimi ynë i përbashkët, deri ku do vazhdojmë ne? Sipas studiuesit Jhon Stuart Mill, njerëzit shikojnë apo tentojnë t'i *maksimizojnë* principet e sjelljeve njerëzore dhe t'i *minimizojnë* kostot e tyre Altman, Taylor (123). Ndryshe thënë, njerëzit mundohen të harxhojnë më pak dhe të përfitojnë apo të marrin më tepër nga të tjerët. Ose njerëzit mundohen të jenë fitimtarë në këtë raport, duke harxhuar më pakë, dhe duke përfituar më tepër. Njerëzit tentojnë të shoqërohen me individë me prapavijë të njëjtë me veten apo të përafërt me ta Altman, Taylor (123). Kjo ka të bëjë edhe me *konsistencën kognitive*³ me ç 'rast individët parapëlqejnë të shohin, dëgjojnë apo lexojnë gjëra që atyre ju interesojnë, është e përafërt me interesat e tyre dhe jo gjëra që janë ndryshe nga këto preferenca. Po që se një informatë është në kundërshtim me informatat që ai apo ajo dëshiron t'i lexojë, ai njeri nuk do të lexojë atë gazetë më.

Një rast i tillë do të mund të ishte gazeta ditore Koha e cila është pro Partisë Demokratike Shqiptare e cila normalisht mbron dhe promovon interesat e kësaj partie. Individë të ndryshëm lexojnë këtë gazetë, shumica e tyre normalisht janë njerëz të njëjtit tabor. Kryeredaktorët apo gazetarët zgjedhin apo shkruajnë tituj të cilët lavdërojnë këtë tabor politik. Mjafton një ditë të analizohen vetëm titujt e kësaj gazete do të shihni që opozita lavdërohet dhe pozita shahet. Një gjë e tillë ndodhën edhe gjatë shoqërimit të njerëzve. Ju mund të njihni të vërtetën dhe ta dini atë rreth shokut apo shoqes tuaj por, jo çdo herë ia thoni të vërtetën asaj sepse e dini që ai apo ajo nuk parapëlqen të flasë apo të dëgjojë ato tema.

Nga ana tjetër studiuesit mendojnë që njerëzit përpos që parapëlqejnë të flasin tema të njëjta apo të përafërta me ato që ata janë mësuar t'i dëgjojnë, shpesh u ndodhën atyre që të kënaqen duke dëgjuar tema krejt ndryshe nga preferencat e tyre, kjo çështje nga studiuesit vlerësohet si "opposit attract"-sulmi i kundërt Altman, Taylor (123).

Ky lloj i kombinimit shkakton dinamizëm në bisedë andaj jo çdo herë tipat me prapavijë të njëjtë me disbalanc plusesh e minusesh kanë probleme gjatë komunikimi apo depërtimit.

Krahasimi i këtyre dy niveleve në komunikim quhet niveli krahasues Altman, Taylor (124). Është një fazë kritike me ç 'rast individët krahasojnë këto pika, sa ne jemi të lumtur apo pikëlluar me miqtë që kemi. A jemi më tepër të lumtura apo më pak dhe a jemi me tepër të pikëlluar për ato miq që kemi.

Kjo çështje sipas dy studiuesve Altman dhe Taylor (124) është ngushtë e lidhur me të kaluarën fëmijërore të individëve. Shpesh për analizë të këtij niveli duhet krahasuar të kaluarën e individëve. Si

³ Konsistenca kognitive është koncept i psikologjisë sociale e cila përshkruan balancën që individët e krijojnë në trurin e tyre me qëllim që të mos shkaktojnë tension psikologjik atij.

kanë qenë ata si fëmijë? Kanë qenë të hapur apo tipa të mbyllur, të turpshëm apo jo të turpshëm, komunikativ apo të heshtur?

Një rast praktik është shembulli me njërin nga të punësuarit në Qendrën e Karrierës. Tip që nuk parapëlqente të komunikojë në telefon me individët apo përfaqësues të kompanive. Sa herë që studenti kishte një detyrë të caktuar lidhur me telefonin, anashkalonte obligimin, vështirësonte punën. Kjo gjë vazhdoi derisa i njëjti nuk qe i angazhuar në një projekt të patjetërsueshëm me ç ‘rast kishte obligim të kontaktojë mbi 300 individë në telefon. Nga ajo radhë, personi në fjalë ndërroi qasjen dhe sjelljen ndaj gjërave. Tani jam e sigurt që po t’i epet mundësia të zgjedh mënyrën e komunikim me njerëzit, do të zgjedh telefonin më tepër se çdo lloj komunikimi tjetër.

Nga këtu del që studenti ka qenë shumë person i mbyllur në të kaluarën, jo shumë komunikativ dhe jo shumë i hapur me të tjerët. Kjo në fakt më pastaj reflekton në të ardhmen e personit, mënyrën e sjelljes dhe qasjes ndaj gjërave.

Gjatë fazës së krahasimit, të mirat dhe të këqijat, pluset dhe minuset, zakonisht individët mundohen të krahasojnë të këqijat që mund t’i mbetin nga këto persona. Cila është e keqja më e madhe që mund të më ndodh nga ky person? Pasi njeriu krahaso këtë rezultate mund të sjellë përfundim në qoftë se dëshiron të mbetet mik me të apo jo. Mbajtja e lidhjeve në të ardhmen varet edhe nga stabiliteti i lidhjes, sa ajo lidhje është stabile. Rasti i njëjtë është edhe me studentët në kampua me ç ‘rast shoqërimi shok dhome -student duket më e qëndrueshmja dhe më stabilja nga të gjitha.

Në procesin e hapjes dhe mbylljes së vetes është shumë me rëndësi të përcaktohen kufijtë e kësaj hapjeje apo mbylljeje. Deri ku i kemi kufijtë e hapjes, a është kjo hapje e njëjtë me të gjithë apo ndryshon? Në bazë të kësaj më pastaj ne caktojmë deri në çfarë niveli duhet të bisedoj me ty. Përcaktimi i barrierave sipas Altman dhe Taylor është shumë me rëndësi për shkak se në bazë të kësaj përcaktohen edhe rolet e intimitetit siç e quajnë këta dy studiues. Normalisht që ka elemente të cilat çdo kush nga ne i mban të fshehta të tjerat që janë më pak të fshehta dhe gjëra krejtësisht të hapura.

Përpos përcaktimit të kufijve, ne duhet të mësohemi t’i tejkalojmë edhe barrierat e ndryshme që të dalin përgjatë kohës Altman dhe Taylor (126). Duke respektuar këto rregulla normalisht që edhe komunikimi zhvillohet në kahje më pozitive.

1.2 Teoria e gjinive-*Deborah Tannen*

Përse meshkujt mendojnë ndryshe për një gjë dhe femrat krejtësisht ndryshe? Cila nga këto “ndryshe” është më e saktë? A thua vallë meshkujt dhe femrat i përkasin të njëjtës botë? Jhon Gray do të përgjigjej duke thënë: Meshkujt vinë nga Marsi ndërsa femrat nga Venera Gray (21).

Kur studiuesja Debora Tannen analizoi fëmijët e klasës së dytë, vërejti që kishte të bëj me dy specie, lloje krejt ndryshe të individëve Tannen (470). Bëhet fjalë për njerëz të llojeve të ndryshme që më pastaj Debora Tannen i quan teori të gjinive. Biseda e meshkujve dhe femrave është komunikim ndërkulturor Tannen (470), ndryshe thënë si komunikim në mes të dy kulturave të ndryshme. Komunikimi i femrave është komunikim i një kulture dhe komunikimi i meshkujve është një komunikim i një kulture tjetër. Dhe si e tillë normalisht që ky komunikim nuk mund të merret si i mirë apo më pak i mirë por, si lloj komunikimi *ndryshe* nga ai paraprak. Andaj qasja e këtillë e gjërave ndryshon rezultatet.

Po që se të gjithë ne nisemi që kemi të bëjmë me individë apo grupe njerëzisht të cilët i përkasin kulturës tjetër nga ajo e jona, ashtu edhe i shohim ato, si të tillë dhe qasja ndaj tyre është ndryshe. Normalisht po që se anëtarët e një kulture tjetër i pranojmë si të tillë duke mos i gjykuar si të mirë apo të këqij, edhe komunikimi me ta do të jetë më i lehtë. Ndryshe thënë, këto njerëz nuk janë më të mirë apo më pak të mirë nga ne por, thjeshtë i përkasin një grupi tjetër njerëzish. Andaj, kur meshkujt janë shumë të dhënë ndaj futbollit, duhet ta marrim si normale do të thotë këta njerëz janë të tillë, që meshkujve në përgjithësi u pëlqen futbolli, dinë të shohin futboll me orë të tëra dhe këtë nuk e bëjnë me qëllim të keq por, thjeshtë futbolli është loja që ato ndiejnë kënaqësi duke parë.

Më pastaj kur studiuesja Tannen analizon sjelljet e të dy gjinive në klasë të gjashtë e sheh që është njëlloj sikur të lëvizësh në një planetë komplet ndryshe, komplet tjetër Tannen (471). Natyra e këtyre dy gjinive është shumë komplekse andaj edhe analiza ndaj meshkujve dhe femrave nuk është e lehtë për t'u bërë.

Ne mundohemi të flasim me njëri tjetrin sinqerisht, mirëpo duket sikur ne flasim gjuhë të ndryshme ose të paktën dialekte të ndryshme gjuhësore Tannen (471). Debora këtë fenomen e quan si dialekt gjuhësore edhe atë duke u nisur nga fjala gjini (gender) dhe dialekt (dialect) që sjell fjalën *genderlect*. Komunikimi i meshkujve dhe femrave është si dialekt në vete apo gjuhë në vete andaj edhe studiuesja merret me analizë të këtyre dialekteve.

Idetë e paraqitura më sipër mund të analizohen thellësisht edhe në filmin *When Harry met Sally*, Reiner (1989)⁴. Insertet e filmit përshkruajnë raportin e këtyre dy gjinive. Sjelljet e shpeshta që kanë femrat dhe meshkujt. Qëndrimi ndaj dukurive të ndryshme, prezantimi i argumenteve. Femrat mendojnë që meshkujt nuk i duan ato për pamjen e brendshme por për atë të jashtmen. Nga ana tjetër meshkujt mendojnë që femrat ka raste kur pëlqehen nga pamja e jashtme por, ka edhe raste kur i respektojnë ato edhe për nga pamja e brendshme.

⁴ *When Harry met Sally* është filmi të cilën studiuesja shfrytëzon si referencë për të gjithë ata të cilët dëshirojnë të vërejnë elementet e teorisë në praktikë.

Sipas studiueses personazhi femër i prezantuar në film, që në këtë rast prezanton gjininë femërore kërkon intimitet, përderisa personazhi mashkull kërkon pavarësi Tannen (473). Sipas studiueses meshkujt janë të paraprirë të mos qenë të varur nga dikush, liria është çështja që më së shumti e pëlqejnë dhe kërkojnë në një lidhje. Me këtë rast, femrat janë ata të cilat çdo herë mundohen të krijojnë raporte të varura me dikë, raporte lidhjeje apo ndryshe thënë raporte intimiteti që në fakt është e kundërta nga ajo që kërkojnë meshkujt. Duke krahasuar të dhënat e studiueses, vijmë në përfundime të caktuara edhe atë:

1.2.1 Femrat dëshirojnë lidhje, ndërsa meshkujt status

Nga analiza që ka bërë studiuesja Tannen, vijmë në përfundim që gjinia femërore përherë parapëlqen lidhjen me njerëzit apo dhe me meshkujt përderisa meshkujt janë ata të cilët çdo herë kërkojnë statusin, të kenë balancë dhe forcë mbi gjërat, sikur ata janë gjithçka Tannen (473). Statusi nga ana tjetër nënkupton edhe pozicionimin në hierarki. Do të thotë meshkujt janë ata të cilët çdo herë dëshirojnë të kenë pozitë udhëheqëse në këtë hierarki, të jenë mbi të tjetër të jenë mbi gjithçka. Këtë gjë zakonisht e bëjnë duke e paraqitur veten çdo herë si fitimtar nëpër gara të ndryshme, qoftë ajo edhe duke luajtur karta, mos u hidhëro njeri apo edhe ndonjë lojë tjetër Tannen (473). Këto dallime bëjnë që më pastaj meshkujt dhe femrat të kenë pikëpamje të ndryshme rreth situatave të njëjta Tannen (473).

1.2.2 Biseda raportuese kundër bisedë së reportit

Këto dy lloje të bisedave dallojnë mënyrën e komunikimit të meshkujve dhe të femrave. Bisedat e reporteve⁵ janë bisedat që shpesh bëjnë meshkujt dhe që në fakt është ngushtë e lidhur me të folurit publik. Në këto lloj bisedash meshkujt parapëlqejnë bisedat në publik aty ku ka shumë njerëz me ç' rast ata janë në qendër të vëmendjes. Për sa i përket tregimit të ngjarjeve të ndryshme, meshkujt bëjnë ngjarje ku çdo herë ata janë fitimtarë apo ata janë heronj të bisedës. Në aspekt të dëgjimit, meshkujt zakonisht e anashkalojnë bisedën e femrave duke uzurpuar atë, sikur sërish ata dinë gjithçka apo duke e anashkaluar atë Tannen (474). Meshkujt janë të paraprirë që më me lehtësi të tejkalojnë konfliktet. Ata janë të përgatitur paraprakisht që konfliktet janë pjesë e përditshmërisë andaj edhe më me lehtësi i përballojnë ato Tannen (474).

⁵ Koncepti i bisedave raportuese dhe atyre të raportit fatkeqësisht nuk përdoren në fjalorin tonë. Që të dyja i referohen një kuptimi, raportit. Por në teorinë e gjinive dhe gjuhën angleze këto dy kuptime nuk janë të njëjta. Dallimet e tyre janë të përshkruara sipër.

Femrat nga ana tjetër i paraprihen bisedave private. Parapëlqejnë bisedat më intime vetëm me një shok apo shoqe me ç ‘rast ndihen më mirë në këto lloj takimesh. Zakonisht i ikin bisedave publike. Gjatë tregimit të ngjarjeve të ndryshme femrat paraqesin veten si viktimë. Me këtë rast ato asnjëherë nuk e përshkruajnë veten ne ato ngjarje, sikur një vajze që këta njohin u ka ndodhur kjo apo ajo gjë dhe jo atyre vetë personalisht.

Femrat nga ana tjetër dinë të dëgjojnë shumë, ata janë dëgjuese shumë të mira. Femrat koncentrohen maksimalisht gjersa tjetri apo tjetra flet diçka. Këtë shpesh e bëjnë duke bashkangjitur gjestet joverbale siç janë lëvizjet e kokës apo shenjat verbale po, po, të dëgjoj, të ndjek ty, ashtu është Tannen (474).

Femrat bëjnë pyetje shpesh si shenjë e asaj që jam duke ndjekur bisedën apo me qëllim të krijimit të raporteve apo marrëdhënieve. Kjo gjë është shumë me rëndësi gjatë një bisede të zakonshme.

Për sa i përket konfliktit, femrat zakonisht i ikin konfliktit. Nuk duan të bien në konflikt pasi konsiderojnë atë si vështirë të menaxhueshëm apo konflikti sipas tyre shkakton problem Tannen (474).

1.2.3 Të folurit publik përballë të folurit privat

Femrat janë ato të cilat zakonisht preferojnë apo parapëlqejnë bisedat private Tannen (474). Femrat në këtë rast duhet thënë që flasin më shumë se meshkujt Tannen (474). Një anekdotë rreth kësaj çështjeje flet për raportin e një gruaje dhe burri. “Një grua i thotë burrit që për kohën prej 10 viteve ti nuk më ke thënë se çmendon. Ndërsa i shoqi ia kthen, nuk kam dashur të të ndërpres e dashur.” Kjo anekdotë shumë bukur përshkruan natyrën e femrave të cilat shumë flasin dhe meshkujve që gati se nuk flasin aspak.

Meshkujt parapëlqejnë bisedat në publik përpara disa njerëzve të tjerë me ç ‘rast kanë më tepër hapësirë dhe mundësi për t’u treguar përpara të tjerëve. Nga ana tjetër femrat parapëlqejnë biseda më intime më të ngushta ndërmjet veti. Biseda që nuk i din çdo kush, biseda që nuk bëhen përpara shumë njerëzve.

1.2.4 Mënyra e tregimit të ngjarjeve

Meshkujt nëpër biseda të ndryshme shpesh parapëlqejnë të tregojnë ngjarje të ndryshme të bashkangjitura me barsoleta për të qeshur Tannen (474). Andaj zakonisht parashtrojnë pyetjen a e kape këtë, a mund ta kapish këtë që në fakt qëndron në vend të asaj a je në gjendje të kuptosh këtë barsolete apo a e kuptove poentën e kësaj? Ata zakonisht janë heronjtë e ngjarjes. Këtë ia bashkëngjisin tregimeve apo ngjarjeve të ndryshme që u kanë ndodhur në jetë dhe ata dalin fitimtarë.

Nga ana tjetër femrat parapëlqejnë të tregojnë ngjarje për shoqërinë, ngjarje që të vjetërve u kanë ndodhur me ç ‘rast dëshirojnë të paraqesin ndjenjën sikur u intereson për të tjetër dhe jo vetëm për veten Tannen (475).

1.2.5 Dëgjimi

Zakonisht femrat dinë të dëgjojnë shumë. Këtë e bëjnë me lëvizje të ndryshme të kokës apo duke pohuar verbalist tërë kohën Tannen (475). Femrat mendojnë dhe pohojnë që meshkujt nuk dëgjojnë, nuk i dëgjojnë ata derisa flasin dhe kjo nuk është e vërtetë. Meshkujt shpesh duket sikur nuk dëgjojnë biseda, sikur paralelisht dëgjojnë edhe diçka tjetër apo dikë tjetër. Kjo gjë shpie në përshtypjes sikur ata nuk dëgjojnë dhe normalisht kjo gjë nuk është e vërtetë.

1.2.6 Parashtrimi i pyetjeve

Në filmin Kur Sally takoi Harryn, shihet qartë që aktorja femër parashtron shumë pyetje dhe kjo në fakt është karakteristikë shumë e zakonit të femrave. Këtë gjë femrat e bëjnë me qëllim që të krijojnë një lidhje apo raport. Raport që më pastaj shpie në ndërtimin e një marrëdhënie të mëtutjeshme Tannen (475). Kjo zakonisht i bashkëngjitet bisedave të zakonshme si për shembull, filmi ishte shumë i mirë a të pëlqeu edhe ty? Këto pyetje më pastaj ndihmojnë në ndërtimin e raporteve apo marrëdhënieve të mëtutjeshme apo ndryshe thënë krijimit të lidhjeve. Femrave u duket sikur meshkujt nuk i dëgjojnë ato, nuk parashtrojnë pyetje apo nuk inkuadrohen në bisedë, thjeshtë meshkujt nuk i kuptojnë ato Tannen (476).

1.2.7 Konflikti

Meshkujt janë ata të cilët më së miri dinë të ballafaqohen me konfliktin. Meshkujt dinë të anashkalojnë konfliktin dhe në përgjithësi të shfaqen si fitimtarë, njerëz të cilët dinë të ulin situata të tensionuara. Nga ana tjetër femrat janë ata të cilat nuk parapëlqejnë të krijojnë situata konflikti por, derisa krijohen ato atëherë dinë edhe tu dalin ballë atyre gjër në fund.

Parashtrohet pyetja: A do të thotë kjo që meshkujt dhe femrat duhet të fillojnë të mësojnë “gjuhën” e njëri tjetrit ashtu siç ne mësojmë gjuhën franceze apo spanjolle? Studiuesja Tannen i përgjigjet pyetjes me një PO të madhe. Duke u nisur nga ky fakt, atëherë gjërat ndryshojnë pasi nisemi nga fillimi që ne dimë pak për këtë gjuhë apo nuk dimë aspak, andaj edhe si të tillë duhet të nisemi ta mësojmë. Nga kjo

më pastaj ne fillojmë të mësohemi të flasim me gjuhën femërore apo në të kundërtën meshkujt femrat fillojnë të mësojnë gjuhën e meshkujve apo ndryshe than gjuhën mashkullore Tannen (477).

Duke analizuar të gjitha faktet e përmendura paraprakisht, lindën një pyetje shumë e diskutueshme . A është vërtetë biseda apo bisedat që bëjnë meshkujt dhe femrat një komunikim ndërkulturorë? Jo çdo herë meshkujt apo femrat janë të ndryshëm nga njëri tjetri. Nganjëherë edhe mushkut dinë të flasin apo të mendojnë si femrat apo e kundërta femrat të sillen apo të mendojnë si meshkujt. Ka shuam meshkuj që janë dëgjues shumë të mirë. Apo në të kundërtën femra dëgjuese shumë të këqija shumë më të këqija se meshkujt bile. Andaj përgjithësimi i tillë i gjërave duhet shpesh të jetë i bashkangjitur me fakte apo argumente. Në këtë rast fakte e tilla do të ishin analizat e shumta, nëpër grupe të ndryshme, gjinishë analiza e një numër të caktuar meshkujve apo femrave Tannen (478).

Sipas dy studiuesve Kunkel dhe Bureson që janë marrë me analizë të çështjeve që ka prezantuar studiuesja Tannen thonë që meshkujt dhe femrat kuptohen njëri me tjetrin. Ata dinë të kuptojnë gjuhën dhe gjestet që përdorin këta dy gjini Tannen (479).

Andaj edhe studimi im bazohet në analizën e sjelljeve të gjinive dhe etnive duke respektuar gjithnjë të dhënat teorike dhe sa këto të dhëna vërtetë vlejnë në praktikë.

1.3 Teoria e kultivimit-George Gerbner

Fjalën kultivim në përditshmërinë tonë jemi mësuar ta dëgjojmë kur i referohemi pemëve apo perimeve, gjërave që mbillen, mbahen, ushqehen dhe në fund i pret frytet. Fjala kultivim në komunikim përdoret si mënyrë mbjelljeje ideve që prezantojnë në institucione apo shtëpi mediatike.

Studiuesi George Gerbner çështjen e kultivimit e analizon në përdorim të televizionit. Sipas tij, sa më tepër që individët shikojnë televizion, aq më tepër janë të varur nga ajo Gerbner (385). Shikuesit e fuqishëm, ashtu siç i emëron ai vetë këta individë, shikojnë botën si një botë të frikshme ngaqë ndikohen shumë nga ky medium. Ndarja e individëve në këto dy grupe bëhet në bazë të shikueshmërisë së televizionit në ditë duke analizuar numrin e orëve që individët bëjnë çdo ditë, dhe më pastaj në javë dhe muaj.

Në pyetjen se çka njerëzit zakonisht shikojnë në televizion Gerbner thotë “*dhunë*” Gerbner (385). Sipas tij njerëzit çdo ditë në televizion shikojnë shumë dhunë, materiale të dhunshme, filma të dhunshëm, filma vizatimor të dhunshëm, lajme të dhunshme.

Ajo që studiuesi e gjen si të rrezikshme është ideja e të qenit i varur nga ky medium dhe më pastaj potencialit për rrezik nga kjo varësi. Njerëzit që shohin shumë TV fillojnë të varen nga ky medium dhe

më pastaj krijojnë ide të njëjta kolektive të kësaj varësie duke u ndikuar maksimalisht. Njerëzit fillojnë të parafytyrojnë realitetin shoqëror ashtu siç prezantohet nëpër këto media Gerbner (386).

Ne zakonisht shohim në lajmë që në vendet Irak, Iran njerëzit bëjnë shumë luftë. Zakonisht nëpër lajme na parafytyrohen skena të shtëpive, lokaleve të djegura, njerëz të gjakosur nëpër rrugë bomba, armë të hedhura për toke. Nga këto pamje të përsëritura aq shpesh krijohet bindja që në këtë vend njerëzit vetëm luftojnë. Unë asnjë lajm deri më tani nuk kam parë pamje të këtyre vendeve në gjendje normale. A thua vallë si përshkruhet jeta nëpër këto vende, si jetojnë këta njerëz, a thua vallë këta njerëz vetëm luftojnë dhe nuk bëjnë gjë tjetër?

Duke marrë parasysh faktin që njerëzit nuk kanë shumë kohë, ata brenda ditës bëjnë shumë punë dhe natën në kohën kur ata shikojnë lajmet ndikohen nga ata kjo ndodh shumë normal pasi ata nuk kanë edhe shumë kohë për të analizuar. Zakonisht njerëzit shikojnë apo dëgjojnë atë që atyre ju servohet përpara dhe para tyre servohen pikërisht këto materiale.

Nga ana tjetër në bazë të psikologjisë sociale njerëzit parapëlqejnë të shikojnë, dëgjojnë apo lexojnë materiale që korrespondon me idetë e tyre. Kjo në teorinë e shkencave të psikologjisë sociale njihet si *konsistenca kognitive* Argandoria (2008).

Njerëzit shikojnë një program të caktuar televiziv pasi sipas teorisë së konsistencës kognitive, nuk dëshirojnë të shkaktojnë tension në tru. Në qoftë se një person është më afër bindjeve le të themi të Partisë së Bashkimit Demokratik për Integrim normalisht që do të shijojë programin shtetëror të Maqedonisë pasi ky televizion kontrollohet nga partia që është në pozitë, dhe në këtë kohë në pozitë është kjo parti. Nga na tjetër po ky person nuk do të parapëlqej të lexojnë le të themi gazetën Koha pas kjo gazetë zakonisht lavdëron partinë opozitare dhe kritikon atë në pozitë.

Sipas studiuesit George Gerbner, shikuesit e TV ndahen në dy grupe edhe atë në shikues të fuqishëm dhe shikues të butë. shikuesit e butë janë individët të cilët shikojnë televizion dy orë në ditë. Sipas tij këta individë janë më pak të rrezikuar nga dhuna. Ndërsa individët të cilët shikojnë më tepër se katër orë në ditë sipas Gerbner janë shumë të ndikuar nga televizioni Gerbner (388).

Gerbner mendon që individët të cilët shikojnë më shume sa katër orë në ditë televizion dhe që ndryshe njihen si shikues të rëndë kanë më tepër mundësi të:

- 1.3.1 Shfaqja e agresionit fizik: gjasat janë më të mëdha që të jenë të kyçur në dhunë, sipas tij këta individë shfaqin më tepër agresione fizike. Kjo thuhet nga analizat që janë bërë nga vete studiuesi.
- 1.3.2 Frikë nga ecja vetë natën: këta individë frikohen të ecin vetë natën apo të rrinë në errësirë. Shpesh kërkojnë të jenë të shoqëruar nga miq pasi nuk mund të qëndrojnë vetëm.

- 1.3.3 Aktivitetet e perceptuara të policëve: sipas studiuesit besohet që njerëzit që janë të inkuadruar më tepër dhunës që në këtë rast janë policët mendojnë që dhuna është shumë e pranishme në shoqëri. Sipas tij këta individë shpesh vizatojnë pistoletat çdo kund.
- 1.3.4 Mosbesimi i përgjithshëm i njerëzve: Njerëzit me shikim të madh të televizionit kanë mosbesim të theksuar tek njerëzit e tjerë. Ata nuk u besojnë njerëzve përreth tyre Gerbner (389).

II. Rrjeti social bashkëkohor

2.1 Historiku i rrjetit social

Rrjeti social facebook u hap në shkurt të vitit 2004. Ajo ka gjithsej mbi 500 milion përdorues aktiv në të gjithë botën Wikipedia (2010). Përdoruesit krijojnë profilin e tyre aty duke vënë informata personale për jetën e tyre duke këmbyer mesazhe të ndryshme, duke publikuar fotografi interesante, dhe duke u shoqëruar me njëri tjetrin. Zakonisht njerëzit krijojnë grupe të ndryshme shoqërimi qoftë në shkolla kompani të ndryshme, organizata me ç ‘rast të dhënat i shpalosin aty dhe për kohë të shkurtër informohen më shumë njerëz njëkohësisht.

Termi për herë të parë u jepet studentëve në një universitet gjatë një kursi për një semestër në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me qëllim që ky libër tu shërbejë atyre si libër që do njihen më mirë vetë njëri me tjetrin. Çdo kush që deklaron veten si 13 vjeçar ka të drejtë të bëhet pjesë e këtij rrjeti social.

Fillimisht rrjeti, u bë i njohur nga Mark Zuckerberg me shokun e dhomës së studimeve në fakultetin e shkencave kompjuterike Eduardo Saverin, Dustin Moskovitz dhe Chris Hughes Wikipedia ⁶(2010).

Compete.com në janar të vitit 2009 rangoi facebook si rrjetin social më të përdorur nga e gjithë bota. Compete.com është analizë e shërbimeve të ueb trafikimit në SHBA dhe publikon përafërsisht 1000000 vizitues të ueb faqeve në të gjithë botën Wikipedia (2010).

Zuckerberg formuloi një ueb faqe në kohën gjer sa ishte student në vitin e dytë në Harvard me ç ‘rast kishte publikuar foto të studenteve dhe detyra e tyre ishte për të zgjedhur cilat nga këto ishin më atraktive dhe cilat jo. Më pastaj duhej të zgjidhej personi më atraktiv nga të gjithë. Kjo ndodhi në 28 tetor të vitit 2003. Për ta përfunduar punimin e tij, Zuckerberg zbuloi, vodhi gjithë rrjetet e mbrojtura të Harvard dhe kopjoi fotografitë e ID të e studentëve të cilët qëndronin në konvikte. Në katër orët e para online, kjo ueb faqe arriti të prekë 450 vizitorë dhe 22.000 shikues të fotografive. Për këtë veprim, Zuckerberg ishte i

⁶ Në vitin 2010 përpara publikut shfaqet edhe filmi shumë i njohur mbi rrjetin social: “The Social Network” me regji të David Fincher

përfshijtur pasi kishte shpërndarë të dhëna personale, pa të drejtë kopjimi, të dhënat personale duke shkelë intimitetin e studentëve në konvikte. Gjatë semestrit derisa ai ishte i përjashtuar shfrytëzoi rastin për të krijuar një mjet social duke aplouduar 500 fotografi me nga një foto për faqe dhe me seksion për komente. Ai u hapi këtë shokëve të klasës dhe ata filluan ta shpërndajnë atë. Semestrin e ardhshëm Zuckerberg filloi të shkruaj kodet për këtë ueb faqe të re në janar të vitit 2004. Në 4 shkurt të vitit 2004 Zuckerberg langoi ueb faqen në të njëjtin lokacion ku gjendet tani me The facebook në facebook.com Wikipedia (2010).

2.2 Fakte mbi përdorimin e rrjetit social

Total active users (in millions)			
Date	Users	Days later	Monthly growth
August 26, 2008	100	1,665	178.38%
April 8, 2009	200	225	13.33%
September 15, 2009	300	150	10%
February 5, 2010	400	143	6.99%
July 21, 2010	500	166	4.52%
—	600	136 (ongoing)	—

Tabela 1.1 Paraqitja e të dhënave statistikore mbi përdorimin e rrjetit social komunikues

Nga të dhënat vërehet lehtë që numri i përdoruesve të rrjetit social është rritur shumë. Në vitin 2008⁷ numri i përgjithshëm i përdoruesve të tij ka qenë 100 milion përderisa në vitin 2010 do të thotë dy vite më vonë, ky numër rritet në 500 milion e në rritje të sipër. Këto numra paraqesin realitetin dhe ky realitete shpreh që njerëzit janë përdorues të mëdhenj të rrjetit social facebook.

Përdorimi i rrjetit social është ndaluar në disa shtete edhe atë në Pakistan, Syri, në Republikën e Kinës, në Vietnam, Uzbekistan si dhe Bangladesh. Në disa vend pune duke arsyetuar që humb kohën e punëtorëve Wikipedia (2010).

⁷ Nga tabela e marrë në internet vërehet që numri i shfrytëzuesve të rrjetit social është në rritje e sipër. Të dhënat e fundit janë publikuar afër 1 viti më parë.



Figura 1.1 Faqja e facebook-ut, pamje e marrë nga interneti

Njerëzit krijojnë profilin e tyre duke vendosur të dhëna personale mbi datën e lindjes, gjininë, preferencat e tyre, muzikën, librat, filmat dhe të ngjashme, më pastaj duke postuar foto të ndryshme. Shpesh njerëzit krijojnë grupe të veçanta Cincilei (2009) me ç ‘rast i bashkëngjitin këtyre grupeve pa marrë parasysh vendin ku gjinden, nacionalitetin, ngjyrën, apo gjuhën që ato flasin. Faqe të tilla janë faqet interesante për të qeshur, ato të horoskopit, lojërat e ndryshme që postojnë siç është rasti me “Farm wille”⁸.

Rrjeti social shpesh përdoret nga kompani të ndryshme si hapësirë apo baner reklamues. Kompani të ndryshme shpallsin informata të ndryshme duke i postuar në faqen e tyre apo duke e dërguar në secilën faqe të individëve duke përfshirë miqtë e tyre. Shumica e gazetarëve postojnë kolumnat e tyre aty para se të publikohen me qëllim që të shohin sa është interesimi i lexuesve.

⁸ “Farm wille” është lojë shumë e njohur e rrjetit social të cilën lojë shfrytëzuesit e rrjetit e përdorin shumë shpesh duke i kushtuar orë të tëra lojës.

Në facebook njerëzit këmbëjnë mesazhe të ndryshme duke dhënë komplimente për mënyrën se si duken, janë veshur, apo si kanë kaluar diku. Thjesht një rrjet që shoqëron individët në mes veti në të gjithë botën.

2.3 Varshmëria e të rinjve nga interneti

Në Novi Sad të Serbisë është hapur klinikë e rehabilitimit për persona të cilët shfaqin varshmëri ndaj Facebookut. Në një deklaratë të dhënë nga shefi i klinikës Dr. Dragan Stefanović, thotë që personat qëndrojnë të paktën një muaj derisa të kurohen dhe më pastaj mjekët do të vendosin në qoftë se ato persona duket të dalin apo jo.

Një 33 vjeçare serbe e cila nuk dëshironte të jep të dhëna mbi identitetin e saj vuante nga sëmundja *like* e facebookut. Pasi kishte vendosur disa të dhëna ajo nuk kishte marrë asnjë like dhe kishte bërë tentim për vetëvrasje Banjaluka-news (2010).

Raste të tilla janë në numër në Serbi dhe sipas të dhënave nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, 3000 nga personat që i pikasin kategorisë së varësisë jetojnë në Serbi dhe kjo shifër parashikohet të katërfishohet në të ardhmen FAKTI⁹ (2010).

Sipas Psikologes në Universitetin e Kalifornisë-Los Angeles Joanna Lipari, ka përshkruar disa elementet që karakterizojnë të varurin nga Facebook edhe atë:

1. Humbni gjumin duke ndenjur në facebook
2. Qëndroni më shumë se një orë në facebook,
3. Obsesionoheni pas të dashurit të kaluar
4. Injoroni punën për facebook
5. Ideja që do leni facebook-un ju pikëllon Banjaluka-news (2010).

Sipas saj, njerëzit prezantojnë vetëm kremin e kremit në facebook dhe dëshirojnë të bëhen miqtë tu, a nuk është pikëlluese dhe zhgënjyese kjo gjë? Ajo emëron facebook-un si një tokë të lumtur *happyland*

Femrat e reja janë të varura nga facebook

Sipas një studimi e botuar nga Oxygen Media, një e treta nga femrat 18-34 kontrollojnë facebook-un kur ata zgjohen në mëngjes. Dhe 39 për qind janë të bindura që facebook-u të bën të varur Gaudin (2010). 50 për qind e shfrytëzuesve logohen në faqen e tyre çdo ditë. 79 për qind e femrave nuk e kanë problem të postojnë fotot e tyre duke u puthur, 42 për qind e tyre janë të papuna O'Neil (2010).

⁹ FAKTI është gazetë ditore e Republikës së Maqedonisë.

Nga raporti i bërë në Universitetin e Leeds në Angli thuhet që njerëzit të cilët kalojnë pjesën më të madhe online janë më të paraprirë të shfaqin simptome të depresionit. Ndërsa njerëzit të cilët ndërveprimet shoqërore i bëjnë nëpër rrjete siç është facebook, ka një im pakt serioz në shëndetin e tyre mental O’Neill (2010).

Simptomat e varshmërisë nga interneti-facebook.

Dr. Kimberly Young ka bërë studime të varshmërisë së internetit në USA në vitin 1996 në Shoqatën Psikologjike Amerikane. Që atëherë studimet kanë treguar varshmëri të madhe nga interneti në disa shtete edhe atë Itali, Pakistan, Gjermani dhe Republikën Çeke. Qendra trajtimi janë hapur në USA dhe më gjerë.

Ja disa nga simptome që karakterizojnë këtë varshmëri, Netaddiction (1995).

1. A ndiheni si i preokupuar me internetin?
2. A ndiheni që dëshironi të përdorni internetin aq shumë sa që të arrini kënaqësi?
3. A keni bërë tentim të vazhdueshëm për të kontrolluar për ta ndalë përdorimin e internetit?
4. A ndiheni i liruar, qetë, në disponim të ndryshueshëm kur dëshironi të fikni ose ç kyçni internetin?
5. A rrini në internete më gjatë se ç kishit planifikuar?
6. A keni rrezikuar ndonjë lidhje tuajën të rëndësishme, punë, mësim ose karrierë pune për shkak të internetit?
7. A keni gënjyer pjesëtarët e familjes, trapistin ose të tjerët ë lidhje me shfrytëzimin e internetit që ju bëni?
8. A përdorni internetin në vend që të tejkaloni problemet apo zgjidhjet e tyre?

Simptomat tjera

- Nuk mund të kontrolloni veprimet tuaja
- Eufori e tepruar përderisa i afroheni apo kur largoheni nga interneti
- Anashkaloni miqtë apo familjen
- Anashkaloni gjumin për të qëndruar natën
- Jeni i pasinqertë me të tjerët
- Ndjeni faj, turp ose depresion për shkak të veprimeve online
- Ndryshime fizike në dukje siç janë marrje peshe, ose humbje peshe, kok dhembje, dhembje shpine
- Tërheqje nga aktivitetet e tjera që ju ofrojnë kënaqësi Frasier (2010).

2.4 Teoria e internetit-Hans Dieter Huber

Shekullin e kaluar dërgimi i letrave është bërë nëpërmes të postës, paraprakisht njerëzit kanë biseduar me atë të telefonit me qëllim që të mbajnë lidhjen komunikuese me të afërmit që kanë pasur në anë tjetër të botës. Për të blerë një gjë duhet të shkosh në shitoren e caktuar. Për të bërë pagesat duhet të vizionesh bankën ku ti je e regjistruar. Kjo gjë sot ka ndryshuar shumë.

Njerëzit sot këmbëjnë letra me njëri tjetrin shumë shpesh nëpërmes të internetit, shumë shpejt për të njëjtën periudhë kohore pa marrë parasysh vendin se ku gjinden. Njerëzit dinë të komunikojnë me të tjerit duke u parë në mes veti me anë të kamerës sikur të ishin në një dhomë me njëri tjetrin, të dëgjojnë njëri tjetrin dhe të paguajnë shumë lirë, gjë e cila ka kushtuar shumë më shtrenjtë më parë. Tani ti mund të paguash rrymën, ujin, telefonin dhe pagesat e tjetra nëpërmes të internetit. Ti mund të porosisësh gardërobë nga një shtete tjetër për të ardhur në shtëpinë tënde. E gjitha kjo mundësohet vetëm nëpërmes të internetit. Kjo gjë normalisht që të ndihmon në kohë ty.

Studiuesi Hans Dieter Huber është munduar të analizojnë punën e internetit duke e krahasuar atë me teorinë e sistemit. Ky studiues bën analiza nëpërmes të teorisë së sistemit më ç ‘rast thotë që interneti funksionon njëllë si kjo teori.

Teoria e Hans Dieter Huber shpjegohet nëpërmes të sistemit. Sipas studiuesit Huber, interneti si sistem operon në ambiente të ndryshme Huber (1995). Interneti sipas tij funksionin si një rrjet komunikues me ambientin se ku ndodhet. Për shembull, ky sistem lidhet ngushtë me korrentin prej nga edhe fillon puna e tij, më pastaj lidhet ngushtë me pjesën e rëndë të kompjuterit ndryshe thënë pjesës harduerike, kabllot e caktuar, lidhja telefonike, varet nga mënyra se si është e lidhur ndërtesa se ku ruhen këto terminale dhe sigurisht përdoruesi është pjesë e këtij ambienti të përshkruar paraprakisht. Të gjitha këto janë komponentë të vetë sistemit.

Të gjitha sistemet komunikuese janë sisteme të mbyllura operimi. Ndryshe thënë asnjë sistem nuk mund të funksionojnë jashtë sistemit. I gjithë komunikim zen vend në sistem aty edhe ku mund të zhvillohet dhe jo jashtë saj apo diku tjetër.

Interneti si sistem

“Interneti mund të definohet si një sistem” Heylighen, Joslyn (1992) i cili operon në një ambient të caktuar. “Interneti mund të përshkruhet si një sistem komunikimi, i përbërë prej komponentëve të caktuara bashkëveprimi i të cilave, është vëzhguese ndaj një vëzhguesi” Huber (1995).

Nga këtu mund të përfundojmë që interneti sipas studiuesit Hans Dieter Huber, krahasohet njëllë si me teorinë e sistemit. Sipas kësaj teorie, Ludvig von Bertalanffy në 1928, zbuloi që teoria e sistemit

funksion si tërësi. Ajo njëlloj mund të krahasohet me trupin apo organizmin e njeriut. Në qoftë se zemra e njeriut nuk funksionon, atëherë nuk funksionon as edhe i tërë trupi. Ata si të tilla i ndihmojnë njëra tjetrës. Asnjëra nga ato nuk është e ndarë por, funksionojnë në atë tërësi. Për shembull dora ka funksionet e veta, përderisa në qoftë se e nxjerrim dorën nga trupi, ajo nuk funksionon Heylighen, Joslyn (1992) .

Sipas studiuesit Hnas Huber, edhe kompjuteri funksionon si tërësi me ç ‘rast, kompjuteri përbëhet prej monitorit, tastierës, dëgjueseve, printerit, më pasta ka internetin, interneti ka programet e veta, faqe të ndryshme Huber (1995). Në qoftë se nuk ka internet atëherë automatikisht del që ti nuk mund të kontrollosh mailin, nuk mund të marrësh ndonjë informatë në google, nuk mund të shohësh filmin tënd të preferuar apo të dëgjosh një muzikë shumë të bukur.

III. Komunikimi dhe rrejt social *facebook*

3.1 Depërtimi i meshkujve dhe femrave në rrjetin social

Gjatë takimit të njerëzve në jetën tonë të përditshme, neve na ndodhën të këmbëjmë informata nga më të ndryshmet. Normalisht që këto informata si të tilla nuk janë të njëjta me të gjithë njerëzit që ne njohim apo takojmë çdo ditë. Me disa nga ato këmbëjmë informata më të përgjithshme siç janë, emri, mbiemri, vendi nga vijnë, prapavija jonë edukativo arsimore, e kështu me radhë, përderisa me disa të tjerë këmbëjmë informata më intime siç janë informata mbi ndonjë shenjë në trupin tonë, sëmundje tonën personale. Gjërat që ne i konsiderojmë si shumë të afërta dhe nuk dëshirojmë të tjetër t’i dinë. Pikërisht idetë e analizuara paraprakisht, janë bazë e studimit të teorisë së penetrimit social ose ndryshe thënë, të teorisë së depërtimit shoqëror të studiuesve: Irwin Altman & Dalmas Taylor Altman & Taylor, (119). Duke u nisur nga vetia e hapjes së vetes-self disclosure¹⁰, shumica e studiuesve, në këtë rast edhe ata të Komunikimit të ndërmjetësuar me kompjuter (CMC), kanë analizuar idenë e hapjes së individëve. E inspiruar nga kjo dukuri e teorisë së depërtimit shoqëror, dhe artikujve të studiuesve të ndryshëm gjinden pika të përbashkëta midis këtyre gjërave të studiuar paraprakisht. Gjithsesi që teoria e hapje së vetes, është një teori shumë e gjerë në vete, andaj, fokusi I analizës përqendrohet në rrjetin më të njohur social, facebook.

Nga na tjetër teoria e gjinive e studiueses Deborah Tannen shpjegon detajisht sjelljet e të dy gjinive gjatë jetës së përditshme. Sipas saj, komunikimi i gjinive duhet të konsiderohet si një gjuhë në vete, ashtu siç potencohet më lartë. Shpesh na ndodh që të mos kuptojmë meshkujt apo femrat, na ndodh që të keqkuptohemi. Sa femrat apo meshkujt hapin vete e tyre në facebook? Cila nga këto gjini hapin veten më tepër? Gjithsesi që meshkujt apo femrat në raport me teorinë e depërtimit shoqëror mund të manifestojnë

¹⁰ Hapja e vetes është koncept I Teorisë së penetrimit. Sipas studiuesve Altman dhe Taylor, njerëzit hapin veten njëlloj si fijen e qepës, duke hyrë thellë e thellë në brendi të saj.

elemente nga hapja e vetes nëpërmes të shumë mënyrave. Analiza e gjërave mund të nis nga këndvështrimi I numrit të shokëve, shoqeve që ato kanë në këtë rrjet, më saktësisht në profilin e tyre, numrin e fotografive, si dhe informatave që ato japin në këtë profil.

Argumentet pro

3.2.1 Përdorimi i gjuhës dhe gjinitë

Femrat janë ata të cilat gjatë komunikimit në CMC¹¹ përdorin forma të tjera përderisa komunikojnë me femrat dhe, meshkujt janë ata të cilët përdorin formë komplet tjetër përderisa komunikojnë me meshkujt Savicki (2000).

3.2.2 Konsistenca kognitive përballë bisedave kundër argumentuese

Meshkujt janë ata të cilët janë më tepër të paraprirë të bëjnë kontribute autoritative dhe të shprehin mos pajtueshmëri përderisa femrat janë ata të cilat paraprinë të shprehin pajtueshmëri ndaj tjerëve Guiller & Durndell (2006).

3.2.3 Pseudonimi përballë zbulimi i vetes

Femrat janë ata të cilat tentojnë të fshehin veten nëpërmes pseudonimeve përderisa meshkujt janë at të cilët paraqesin emrat e vetë të vërtetë Lee & Oshagan (1998).

3.2.4 Promovimi i vetes përballë mbylljes së vetes

Nga ana tjetër, studiuesi Lee, mbi analizën e përbormit të gjuhëve që gjinitë shfrytëzojnë gjatë komunikimit nëpër CMC, thuhet që meshkujt dinë të pozicionohen duke bërë promovim të vetes, sarkazëm, ofendime dhe pohim përderisa femrat janë ata të cilat parapëlqejnë mesazhe të cilat paraqesin përkrahje dhe orientim personal Lee (2007).

3.2.5 Komunikimi i argumentueshëm përballë komunikimi i ndërtuar mbi marrëdhënie

Meshkujt janë ata të cilët parapëlqejnë të komunikojnë për objektet siç janë veturat dhe kompjuterët si dhe për evenimentet e jashtme siç janë politika dhe sporti Herring (2006).

Argumentet koftra

3.2.6 Temat diskutuese të femrave dhe meshkujve

¹¹ Ndarja e argumenteve në pro dhe kundër qëndron në bazë të parashtrimit të hipotezave. Të parat përkrahin hipotezat ekzistuese përderisa të dytat kundërshtojnë atë.

Sipas studiuesit Soukup në artikullin e tij mbi ndërveprimet e gjinive në CMC, meshkujt janë ata të cilat vrapojnë pas paraqitjes më argumentative nëpër “chatet” e ndryshme në internet, përderisa femrat parapëlqejnë krijim të raporteve-marrëdhënieve dhe intimitetit. Nga ky paragraf mund të shohim që femrat janë ata gjini të cilat dëshirojnë të krijojnë lidhje intime përderisa meshkujt janë ata të cilët dëshirojnë të duken më të fuqishëm dhe argumentativ Soukup (1998).

3.2.7 Aktiviteti meshkuj përballë femra

Meshkujt janë pjesëtarë më aktiv nëpër “chate” të ndryshme përderisa femrat janë më pak aktive Krivak (2008). Ky përfundim është një e dhënë konkrete mbi atë se kush hapën veten më tepër, meshkujt apo femrat dhe nga kjo e dhënë del që meshkujt janë më aktiv nga femrat.

3.2.8 Koha dhe vendi i zhvillimit të komunikimit

Njerëzit janë ata të cilët bëjnë vendime personalisht për veten e tyre kur dhe si do të hapin veten e tyre Walther, Heid, Kim, Westerman, Tong (2008). Kjo është një argument mbi atë se si do qoftë gjinia femërore apo mashkullore janë vetë ata persona që vendosin për veten e tyre kur dhe si do të hapin veten e tyre.

Pjesa e dytë

IV. Formulimi i problemit dhe qëllimet kyçe

Studimet e shumta nga lëmi i komunikimit dhe informatikës dëshmuar fakte që gjinitë ekzistuese kanë dallime dhe pika të përbashkëta në mes veti për sa i përket komunikimit të tyre në rrjetin social komunikues. Si manifestohen këto dallime në terrenin ku unë bëj analiza? Cilat janë këto dallime? Si duhet anashkaluar ato? Këto dhe pyetjet e tjera janë bazë e studimit të zhvilluar më pas.

Punimi me temë : *“Teoritë bashkëkohore të komunikimit dhe sjellja e gjinive në rrjetet sociale komunikuese”* ka për bazë analizën e disa nga vetive që shfrytëzuesit e rrjetit modern përdorin gjatë kycjes në të. Duke u nisur nga aspekti teorik i shkencave të komunikimit, psikologjisë, sociologjisë dhe informatikës, studimi sjell në pah analizën praktike të gjërave në terren.

Kush nga meshkujt dhe femrat hapën veten më tepër? Cilat nga gjinitë publikojnë më tepër fotografi, komentojnë meshkujt më shumë apo femrat, kush nga gjinitë plotëson profilin më tepër? Mënyra e komunikimit dhe sjellja e gjinive është botë në vete, cila është kjo botë, si ta mësojmë atë dhe si të përmirësojmë sjelljen ndaj njëri tjetrit me qëllim që të kemi një komunikim më të suksesshëm janë preokupimet e këtij punimi. Analiza në fjalë ka për qëllim krahasimin në mes të gjinive-meshkuj dhe femra si dhe tre etnive-shqiptarë, maqedonas dhe turq duke analizuar detajisht këto të dhëna.

Punimi me temë: *“Teoritë bashkëkohore të komunikimit dhe sjellja e gjinive në rrjetet sociale komunikuese”* përfshin disa faza:

- Fillimisht bëhen analiza dhe krahasime paraprake rreth këtyre çështjeve, çka autorë të ndryshëm shkruajnë rreth teorive dhe rrjetit social. Në këtë fazë analiza bazohet në studimet paraprake që janë bërë rreth këtyre lëmeve, duke u ndalur në teoritë apo elementet e tjera teorike, duke grumbulluar informata nga libra, artikuj të ndryshëm shkencor, gazeta, të dhëna nga faqe të ndryshme të internetit si dhe filma të ndryshëm që drejt për së drejti lidhen me këto çështje.
- Faza e dytë përmban aspektin metodologjik, llojet e metodave të përdorura në studim. Theks i veçantë i përkushtohet hipotezës kryesore dhe asaj ndihmëse, teknikave të grumbullimit të të dhënave, analizave tabelare të bashkangjitura me grafikone të ndryshme.
- Përfundimisht duhet theksuar që faza e tretë përmban përshkrimin, komentimi e rezultateve duke krahasuar të dhënat e nxjerra në terren me të dhënat paraprakisht të analizuar në aspekt teorik.

Kjo analizë bazohet në krahasimin e gjithsej 237 shfrytëzuesve të rrjetit social me ç ‘rast pjesëmarrës janë nxënësit e shkollave fillore në qytetin e Gostivarit edhe atë: Ismail Qemali, Goce Dellçev, Vëllazërim Bashkimi si dhe Mustafa Kemal Atatürk. Për sa i përket klasës ata bëjnë pjesë në të katër klasat e shkollës fillore edhe atë klasës së pestë, gjashtë, shtatë dhe të tetë.

Çështjet të cilat më pastaj do të përpunohen dhe argumentohen i përkasin disa pikave duke i dhënë theks të veçantë këtyre çështjeve. Pikë e rëndësishme në këtë punim është ideja e patjetërsueshme dhe e nevojshme e qenieve sociale për të komunikuar ashtu siç thotë edhe vetë Paul Watzlawick në librin e tij *Pragmatics of human communication: “Ne nuk mund të mos komunikojmë”*.

Duke ndier nevojën e patjetërsueshme të individëve për të komunikuar, menjëherë pas kësaj na lindin disa çështje të tjera. Po që se potencojmë idetë e studiuesve Altman dhe Taylor, do të shohim që ata i japin një rëndësi shumë të veçantë mënyrës së komunikimit që njerëzit bëjnë në mes veti. Ndër të tjera do të ndalem në pikat:

- Sipas studiuesve të dhënat periferike apo më të përgjithshme këmbehen më shumë dhe më shpejtë nga informatat private Altman, Taylor (121).
- Sipas studiuesit Jhon Stuart Mill, njerëzit shikojnë apo tentojnë t’i *maksimizojnë* principet e sjelljeve njerëzore dhe t’i *minimizojnë* kostot e tyre Altman, Taylor (123).

Cila është mënyra e komunikimit që të rinjtë në Gostivar përdorin? Sa të rinjtë mbajnë llogari për të “hyrat” dhe “dalat” që ata krijojnë në shoqëri, janë fitimtarë apo humbës ata? Po që se Deborah Tannen pohon që meshkujt dhe femrat janë një kulturë ne vete atëherë cila është kjo kulturë, a mësohet vështirë ajo, a duhet ta dije çdo gjini atë? Sipas saj, biseda e meshkujve dhe femrave është komunikim ndërkulturor Tannen (470). Dhe nga na tjetër në pyetjen se çka njerëzit zakonisht shikojnë në televizion Gerbner thotë “*dhunë*” Gerbner (385). Por, përpos dhunës, njerëzit fillojnë ta parafytyrojnë realitetin shoqëror ashtu siç prezantohet nëpër këto media Gerbner (386).

Si prezantohet realiteti shoqëror në facebook? Si ndikon ky realitete tek të rinjtë?

Psikologja e Universitetit të Kalifornisë-Los Angeles Joanna Lipari emëron facebook-un si një tokë të lumtur *happyland*, por a thua në të vërtetë kjo është toka e lumtur?

Janë këto disa nga çështjet që të nxisin ide diskutabile në kokë para së gjithash përpara vetes dhe të tjerëve më pastaj. Nga ana tjetër, na preokupojnë të gjithëve, ne jemi pjesë e këtyre ngjarjeve dhe si të tilla nuk mund t’i anashkalojmë pa i vënë re.

Punimi i magjistraturës mbi *Teoritë bashkëkohore të komunikimit dhe sjellja e gjinive në rrjetet sociale komunikuese* ka rëndësi të veçantë si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik. Përparësia e punimit në aspektin teorik është mungesa e studimeve të kësaj natyre në vendin tonë, dhe si e tillë gjen vend

në grupin e temave më pak të punuara paraprakisht. Me këtë rast, studimi ndihmon nxjerrjen në pah të sjelljeve të fëmijëve në këtë rrjet, mënyrës së komunikimit, varshmërisë nga rrjeti social, analiza e mënyrës së njëjtë të të menduarit, veprimit të njëjtë, sjellje e cila më pastaj ndikon në ndërtimin e personalitetit të tyre si individë. Ky punim ka rëndësi në fushën e komunikimit ndër personal ati grupor si dhe aspektit të varshmërisë nga teknologjitë bashkëkohore komunikuese.

Aspekti praktik I temës ndihmon në grumbullimin e të dhënave të cilat të dhëna japin rezultate reale mbi situatën në fjalë. Këto të dhëna ndihmojnë studimet në të ardhmen, hapin shumë fusha të reja analiza të cilat në vendin tonë fatkeqësisht janë të mangëta. Ndonëse ky punim është modest në përmbajtjen e saj, vlerësoj si i tillë të ndihmoj në vazhden e punimeve që do të nxirren në të ardhmen dhe nga ana tjetër të plotësojnë ato të deritanishmet. Studimet e këtij lloji janë të mangëta në vendin tonë nga ana tjetër ballafaqimi me këto çështje është i pamohueshëm. Duke krahasuar të dhënat paraprake dhe sjelljet e individëve në vendin tonë, rezultatet në të ardhmen hapin rrugë edhe të analizave të shumta mbi këtë lëmi.

Duke vlerësuar sërish komunikimin si pjesë të pandashme dhe internetin përditshmëri, mendoj që ky punim sjell në pah rezultate konkrete të sjelljeve njerëzore. Në një mënyrë apo tjetër secili nga ne gjen veten në sjelljet e këtilla.

V. Parashtrimi i hipotezave

Analiza mbi teoritë e komunikimit dhe sjelljen e gjinive-etnive në rrjetin social komunikues, s' do mend që ka hapësirë të madhe studimi. Këndi im fokusohet pikërisht në disa nga teoritë bashkëkohore të komunikimit edhe atë në teorinë e Penetrimit Social, të Gjinive, Kultivimit si dhe Internetit. Nga ana tjetër grupa e fokusit është e përcaktuar tek nxënësit e katër shkollave fillore në Gostivar. Mosha e nxënësve tek të cilët zhvillohet analiza gjithashtu i përket disa gjeneratave.

Duke u nisur nga fakti që hipoteza është një thënie e caktuar e cila mund të vërtetohet dhe verifikohet Bryman (9) punimi me temë: *Teoritë bashkëkohore të komunikimit dhe sjellja e gjinive në rrjetet sociale komunikuese* ngërthen në vete disa hipoteza edhe atë:

5.1 Hipoteza kryesore: Po që se gjinitë përdorin internetin njëllor, atëherë femrat do të hapin veten më tepër se meshkujt.

Hipoteza është ndërtuar në bazë të rishikimit të literaturës. Pas leximit të materialeve të gjetura, del që disa nga studiuesit mendojnë që meshkujt janë përdorues më të mëdhenj të internetit. Femrat janë ata që japin komente më të thella, meshkujt janë ata që japin komente më sipërfaqësore apo nuk komentojnë aspak. Zakonisht përfundimet e tilla sipas meje janë thjeshtë stereotipizim, me qenë se po këta gjini kanë predispozita të njëjta për sa i përket idesë së hapjes së vetes. Unë do ndaja mendim të njëjtë për sa i përket

idesë së analizës së gjërave në aspekt të prapavijës kulturore, shkollimit qëndrimit dhe karakterit të atij personi. Dhe nuk mendoj që gjërat e tilla mund të gjeneralizohen aq lehtë.

Nga ana tjetër dëshiroja të dilja me një të dhënë konkrete, diçka që në fakt ka rezultate dhe duket haptazi apo qartë. Sipas hipotezës kryesore, parashihet që femrat do të hapin veten më tepër. Shpesh edhe në përditshmërinë tonë jemi mësuar të dëgjojmë përfundime të shumta që ne femrat flasim më tepër, fotografohemi më tepër, komentojmë më tepër apo promovojmë veten më tepër. Andaj jo rastësisht hipoteza kryesore mbështete këto fakte. Nga ana tjetër duke analizuar edhe përfundimet teorike veç më të analizuara paraprakisht vërehej lehtë që shumica e studiuesve mbështesin faktin që femrat vërtetë hapin vetën më tepër se meshkujt.

Nga vetë praktika e analizës së gjërave gjer më tani, dihet që femrat janë më të paraprirë për të ekspozuar veten. Femrat janë ajo gjini që din të dalë me qindra foto në pozitën e njëjtë gjer sat ë zgjedh atë të duhurën. Di të mbledh të gjitha fotografitë me radhe dhe nga ana tjetër po të njëjtat t'i paraqes të tjerëve. Ide të njëjta dalin edhe në shpjegimin e gjërave. Edhe në teorinë e gjinive thuhet që femrat dinë të flasin më gjatë, përderisa meshkujt janë më të shkurtër, qartë dhe konciz.

Metodologjia e shfrytëzuar në punim më pastaj dëshmon realisht qëndrimin e nxënësve të shkollave fillore në Gostivar. Pas kësaj analize mund të thuhet përfundimisht dhe me bindje në qoftë se femrat e hapin veten më tepër apo jo, normalisht duke u mbështetur në fakte dhe të dhëna konkrete.

5.2 Hipoteza e dytë ndihmëse është me sa vijon: Po që se nxënësit e shkollave fillore në Gostivar përdorin njëllor rrjetin social, atëherë shqiptarët do hapin veten më tepër se etnitë e tjera.

Edhe sipas kësaj hipoteze mendohet që shqiptarët nga natyra janë më komunikativ në krahasim me etnitë e tjera si maqedonasit ashtu edhe turqit. Shpesh kemi dëgjuar shprehjet ku thuhet se shqiptarët janë popull llafazan, njerëz që flasin shumë.

Edhe kjo hipotezë është mbështetur në të dhëna mbi përditshmërinë tonë. Normalisht të dhënat në terren do të pohojnë apo rrëzojnë këtë hipotezë varësisht rezultateve që do të dalin përfundimisht.

VI. Metodologjia e punës

Analiza mbi përdorimin e rrjetit social komunikues në shkollat fillore bazohet në krahasimin e gjithsej 237 shfrytëzuesve të shkollave fillore në qytetin e Gostivarit. Pjesëmarrësit i përkasin të tre etnive më të mëdha në përqindje në Maqedoni edhe atë: shqiptarë, turq dhe maqedonas. Laramania e pjesëmarrësve është bërë me qëllim pasqyrimi më të detajuar të një situate reale ekzistuese në terren.

Bazë analize janë numri i miqve që kanë ata në profilin e tyre, koha që kalojnë përpara rrjetit social komunikues, lloji i fotografive që kanë të publikuara aty, shkrimi i komenteve që ja bëjnë njëri tjetrit si dhe gjëra të ngjashme. Sa këto gjini-etni japin informata mbi atë se kush janë, nga vinë, cilat janë preferencat e tyre.

Metoda kryesore e përdorur në studim është ajo sasiore gjegjësisht pyetësi i përberë prej pyetjeve të disa natyrave edhe atë: pyetje të përgjithshme të cilat japin të dhëna mbi gjininë, shkollën, klasën e të anketuarit, pyetje të cilët nga i anketuari kërkojnë përgjigje shkallë si dhe grupi i tretë i pyetjeve kërkojnë nga i anketuari të japin mendimin e tyre të lirë mbi çështjet e përmendura aty, ndryshe thënë pyetje të hapura.

Ndërsa për sa i përket aspektit teorik dhe grumbullimit të dhënave, materialet janë marrë nga libra të ndryshëm shkencor, gazeta shkencore, revista, gazeta fitore, faqe të ndryshme të internetit.

VII. Instrumentet e përdorura në studim

7.1 Metoda kuantitative-sasiore, pyetësi

Numri i përgjithshëm i të anketuarve ka qenë 237. Pjesëmarrësit kanë qenë nxënës të katër shkollave fillore në Gostivar edhe atë: Ismail Qemali, Goce Dellçev, Vëllazërim Bashkimi si dhe Mustafa Kemal Atatürk. Nga këto katër shkolla janë bërë analiza me nxënës të shkollave fillore nga klasa e pestë, gjashtë, shtatë dhe e tetë. Të anketuarit i përkasin tre etnive edhe atë shqiptarë, maqedonas dhe turq andaj pyetësorët kanë qene të përgatitur në tre gjuhë. Analizat janë bërë në kabinete të informatikës nëpër këto shkolla me ç' rast përgjigjet janë plotësuar online në softuerin e gmalit-google doc¹². Mirëpo në disa klasa pyetësorët janë plotësuar në letër dhe të njëjtat më pastaj janë vendosur online.

Analiza ka zgjatur disa ditë varësisht grupit të analizës, orëve mësimore që ato kanë pesë dhe kohës kur kanë mbajtur mësim të informatikës. Kryesisht puna ka shkuar shumë mirë, udhëheqësit e shkollave së bashku me mësimdhënësit dhe nxënësit më kanë pritur shumë mirë. Ata kane treguar gatishmëri për ndihmë dhe analizat që unë kam bërë.

Në pyetësorë, nxënësit kanë pas të dhëna të detajuara rreth pyetjeve që janë kërkuar dhe mënyrës së përgjigjes me gojë dhe shkrim. Në fillim të çdo pyetësi nxënësit janë njoftuar rreth procesit të analizës dhe kjo u ka ndihmuar në procedurën e mëposhtme.

¹² Në kuadër të Makinës kërkimore të uebit Google.com ekziston shërbimi i përpilimit të Google doc. Ky shërbim ndihmon në krijimin e pyetësorëve online, me ç' rast nxjerra e rezultateve bëhet automatikisht.

Pyetësi përbëhet nga tri pjesë edhe atë: pjesës së parë, që përmban analizën e përgjigjeve në bazë të përkatësisë, gjinisë, shkollës dhe klasës, në këtë rast të dhënat janë më të detajuara dhe unë kam një përshkrim edhe më të qartë të këtyre elementeve. Pjesa e dytë përbëhet nga grupi i pyetjeve me përgjigje, duke rrethuar njërin prej tyre apo përgjigje të hapura me ç ‘rast i lihet hapësira të anketuarit të përgjigjet ashtu siç është më mirë. Krejt në fund gjendet hapësira për analizë e disave nga të anketuarve me ç ‘rast ata me japin leje për të analizuar profilin e tyre në facebook.

Pyetësi është shpërndarë në tre gjuhë edhe atë, në gjuhën shqipe, maqedonase dhe turke. Pyetësi përbëhet nga gjithsej 16 pyetjeve me ç ‘rast 14 prej tyre ishin shkallë më pastaj të anketuarit kishin mundësinë të zgjedhin në mes të përgjigjes që më së afërmi korrespondon sjelljes së tyre dhe dy prej atyre ishin të lira. Në grupin e pyetjeve shkallë, të anketuarit kanë pasur mundësi të zgjedhin në mes të 3 apo katër varianteve, dhe në disa nga ato ka pasur zgjidhje tjetër, me ç ‘rast të anketuarve u është dhënë mundësia të përgjigjen në një mënyrë ndryshe nga ato të përcaktuarat paraprakisht. Krejtësisht në fund pyetësi është përmbyllur me në pyetje ku të anketuarit i është dhënë mundësia të zgjedh të behet mik apo jo me mua. Në këtë rast të gjithë ata të cilat kanë pranuar të bëhen miq me mua, kanë dhënë mundësinë e bërjes së analizave të profilit të tyre. Me disa nga ato unë kam bërë analiza edhe më të detajuara.

7.2 Metoda kualitative

a) Studim rasti

Analiza e profilit të nxënësve të shkollave fillore në Gostivar

Studimi i rasti është zhvilluar më nxënësit e shkollave fillore të qytetit të Gostivarit me ç ‘rast pas lejes që kanë dhënë ata për tu bërë analiza e profilit të tyre, unë kam analizuar llojin e fotografive që ata kanë publikuar aty, llojin e videove, komentet që kanë bërë në profil, mënyra e komunikimit që përdorin me të tërët, gjuha që komunikojnë ato dhe të ngjashme. Nxënësve i është marrë lejë për të analizuar profilin e tyre dhe me lejen e tyre unë kam bërë analizat nevojshme. Normalisht çështje esenciale në këtë analizë kanë qenë kërkesat e parashtruara paraprakisht. Gjetja e argumenteve pro dhe kundër formulimeve teorike si dhe mbështetja e hipotezave të paraqitura paraprakisht. Duhet të them që kjo si metodë më ka ndihmuar shumë gjatë analizës së gjërave.

b) Intervista

Intervista është zhvilluar në katër shkollat fillore me nxënës të klasave varësisht mundësisë që ata kanë dhënë për të bërë intervistën. Pas lejes së tyre, kam zhvilluar intervistë me gjithsej 20 nxënës edhe atë: pesë nxënës shqiptarë të shkollës fillore Ismail Qemali, pesë nxënës të shkollës Goce Dellçev (3 shqiptarë dhe 2 maqedonas), pesë shqiptarë të Vëllazërim bashkimit si dhe pesë turq të shkollës Mustafa Kemal Atatürk.

Intervista është zhvilluar me secilin nxënës veçmas. Ajo përbëhej prej pyetjeve të hapura duke sjellë në pah interesat, qëllimet preferencat e nxënësve. Gjatë kësaj faze jam munduar të nxjerr nga nxënësit atë që nuk e kanë thanë më parë, apo nuk e kanë shënuar në pyetësor. Pyetjet e tilla kanë ndihmuar më pastaj në forcimin apo kundërshtimin e përfundimeve teorike të nxjerra më parë.

Facebook Pyetëtori

Ky pyetësor ka për qëllim të analizojë situatën e përdorimit të facebook-ut tek nxënësit e katër shkollave fillore në qytetin e Gostivarit. Ekzistojnë ide që nxënësit përdorin facebook-un më tepër se librin. Të tjerë mendojnë që facebook-u u ndihmon njerëzve për tu shoqëruar në mes veti.

Ju lutem ndani 5 minuta kohë për t'ju përgjigjur këtyre pyetjeve.

Të dhënat tuaja janë të besueshme, anonimiteti është i garantuar. Ju lutem bëhuni sa më të sinqertë.

*** Required**

Gjinia *

- ☐ mashkull
☐ femër

Etniteti *

- ☐ shqiptar
☐ maqedonas
☐ turk
☐ tjetër

Klasa *

- ☐ e pestë (V)
☐ e gjashtë (VI)
☐ e shtatë (VII)
☐ e tetë (VIII)

Shkolla *

- ☐ Ismail Qemali
☐ Goce Dellçev
☐ Vëllazërim Bashkimi
☐ Mustafa Kemal Ataturk

E-Mail Adresa e profilit tuaj ne Facebook

Kur keni krijuar profilin tuaj në facebook? *

- ☐ para 1 jave
- ☐ para 6 muajve
- ☐ para 1-2 vite
- ☐ para më tepër se 2 vite

Sa orë në ditë shfrytëzoni facebook? *

- ☐ më pak se 2 orë
- ☐ 2 orë
- ☐ më shumë se 2 orë
- ☐ më shumë se 5 orë

Pse keni hapur profilin tuaj në facebook? *

- ☐ Për shoqërim, zbavitje
- ☐ Për mësim
- ☐ Për kureshtje
- ☐ E gjithë shoqëria ime kanë fb, desha të kem edhe unë
- ☐ Për të kaluar kohën

Sa miq keni të regjistruar në fb? *

- ☐ më pak se 50
- ☐ përafërsisht 100
- ☐ 200
- ☐ mbi 200

Ku e përdorni më së shumti facebook-un *

- ☐ në shkollë
- ☒ në shtëpi
- ☐ tjetër

Sa fotografi keni të publikuara në profilin tuaj *

- ☒ më pak se 10
- ☐ deri 50
- ☐ 100
- ☐ mbi 100

A mendoni që fb ju pengon në kryerjen e punëve tuaja shkollore *

- ☐ Po
- ☐ Jo
- ☒ Ndoshta
- ☐ Nuk e di

Sa prej tyre janë gjysmë lakuriqe, lakuriqe? *

- ☐ aspak
- ☒ mesatarisht
- ☐ shumë
- ☐ tjetër

☐ aspak e vërtetë

☐ mesatarisht e vërtetë

Facebook është humbje kohe për mua! Sa e identifikoni veten me këtë shprehje? *

☐ aspak

☐ shumë pak

☐ mesatarisht

☐ tërësisht

Është e pamundur të paramendosh këtë shekull pa fb! Cili është mendimi juaj mbi këtë shprehje? *

Shkruani disa ide tuaja si të parandalohet përdorimi i tepërt i fb *

A dëshironi të bëheni mike me mua në fb? Në qoftë se po, ju lutem më lejonit të analizoj përmbajtjen e profilit tuaj. *

☐ Po

☐ Jo

Powered by [Google Docs](#)

[Report Abuse](#) - [Terms of Service](#) - [Additional Terms](#)

Figura 1.2 Pamja e pyetësorit e skanuar nga Interneti

VIII. Etika e hulumtimit

Studimi mbi përdorimin e rrjetit social komunikues tërë kohën është mbështetur në të dhëna të cilat dëshmojnë të anketuarit që përgjigjet e tyre nuk do të keqpërdoren dhe anonimiteti i tyre është theksuar në fillim të çdo pyetësi.

Ky pyetësor ka për qëllim të analizojë situatën e përdorimit të facebook-ut tek nxënësit e katër shkollave fillore në qytetin e Gostivarit. Ekzistojnë ide që nxënësit përdorin facebook-un më tepër se librin. Të tjerë mendojnë që facebook-u u ndihmon njerëzve për tu shoqëruar në mes veti.

Ju lutem ndani **5 minuta** kohë për t'ju përgjigjur këtyre pyetjeve.

Të dhënat tuaja janë të besueshme, anonimiteti është i garantuar. Ju lutem bëhuni sa më të sinqertë.

Me këtë rast edhe nxënësit apo ndryshe thënë të anketuarit kanë mirëpritur këtë pyetësor pasi që kanë qenë të bindur që keqpërdorimi i të dhënave të tyre nuk do bëhet.

Nga ana tjetër pikërisht elementi etik mundëson afërsinë me të anketuarit me ç 'rast që në fillim të çdo pyetësi ata kanë qenë të informuar që sinqeriteti dhe konciziteti janë pika referuese e të gjithë përgjigjeve.

Duke u nisur nga ky fakt këto të dhëna janë të besueshme dhe të vërteta. Vërtetësia e tyre ndihmon në sjelljen e përfundimeve më të përafërta me realitetin, të cilat përfundime më pastaj ndihmojnë në nxjerrjen e të dhënave të tjera.

Pjesa e tretë

IX Grumbullimi dhe analiza e të dhënave

9.1 Të dhënat e përgjithshme

Numri i përgjithshëm i të anketuarve është 237 prej të cilëve, shqiptarë¹³ janë 157 ose përafërsisht 66%. Numri i përgjithshëm i nxënësve maqedonas është 23 ose ndryshe 9 % ndërsa numri i nxënësve turq është 57 dhe në përqindje afërsisht 23 %. Numri i nxënësve shqiptarë meshkuj është 107 ose në përqindje 45.14 %, ndërsa femra 50 ose 21.09%, maqedonas 7 ose në përqindje 2.95% dhe femra 16 ose 6.75% ndërsa turq ka pasur gjithsej 34 ose 14.34% dhe femra 23 apo 9.70%.

Përfundimisht mund të vërehet lehtë që përqindja më e madhe e të anketuarve ka qenë e nxënësve shqiptar edhe atë gjithsej 66% ndërsa për sa i përket gjinive ajo e meshkujve me afërsisht 45% nga pjesëmarrja e përgjithshme e të anketuarve.

Etniteti	Gjinia	
	Meshkuj	Femra
Shqiptarë	107	50
Maqedonas	7	16
Turq	34	23
Total	148	89

Tabela 1: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të gjinisë dhe etnitetit

¹³ Të gjithë të dhënat janë krahasuar nëpërmes të dy gjinive (meshkuj, femra) si dhe tre etnive (shqiptar, maqedonas dhe turq). Këto të dhëna janë shpërndarë në tabela dhe grafikone të veçanta.





Figura 1 paraqet përqindjen e pjesëmarrjeve në bazë të gjinive të anketuarve me ç'rast vërehet lehtë që përqindja më e madhe e tyre ka qenë meshkuj shqiptarë edhe atë gjithsej 45.14%. Pas kësaj përqindjeje renditen femrat shqiptare të anketuara edhe atë afërsisht 21 %. Laramania e pjesëmarrësve në anketë është bërë me qëllim grumbullimi rezultatesh nga të gjitha llojet, dy gjinitë dhe tre etnitë.

Etniteti:	
Shqiptarë	157
Maqedonas	23
Turq	57

Tabela 2: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të etnitetit

Në tabelën e dytë janë pjesëmarrësit e të tri etnive përkatëse edhe atë: shqiptarët me gjithsej pjesëmarrje prej 157, maqedonasit me një numër prej 23 si dhe turqit 57. Ky numër është seleksionuar në bazë të pjesëmarrësve varësisht shkollës dhe klasës që ata i përkasin.



Në figurën e dytë paraqitet qartë shpërndarja e pjesëmarrësve në bazë të përqindjes edhe atë: Shqiptarët me një përqindje prej 66 % maqedonasit afërsisht 10% si dhe turqit gjithsej 24%. Nga këto të dhëna mund të përfundojmë që shqiptarët në përqindje të pjesëmarrësve kanë qenë më në numër edhe atë mbi gjysma ndërsa turqit kanë përfshirë një përqindje afërsisht një të tretën e tërësisë së përgjithshme. Nga të anketuarit më pak në numër kanë qenë maqedonasit me gjithsej afërsisht 10 %.

Numri i të anketuarve shqiptarë ka qenë në përqindje më të madhe me gjithsej 66% më pastaj e turqve me gjithsej 24% dhe më pak në numër kanë qenë maqedonasit me gjithsej 10%.


Klasa:				
Klasa	E pestë (V)	E gjashtë (VI)	E shtatë (VII)	E tetë (VIII)
Shqiptarë	0	71	25	61
Maqedonas	5	3	9	6
Turq	0	1	14	42
Total	5	75	48	109

Tabela 3: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të klasës

Në tabelën e tretë përshkruhet qartazi analiza e pjesëmarrësve në bazë të klasës së përfshirjes dhe normalisht etnisë që ata i takojnë. Duke marrë parasysh që pyetëtorët janë shpërndarë veçmas varësisht etnisë që ata i përkasin edhe unë tërë kohën kamë bërë krahasime në mes të këtyre tre etnive në numër në qytetin e Gostivarit.

Nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve, 71 prej tyre kanë qenë të klasës së gjashtë, 25 të klasës së shtatë dhe 61 nxënës të klasës së tetë. Ndërsa maqedonasit kanë përfshirë një numër prej 5 nxënësve të klasës së pestë, 3 të klasës së gjashtë, 9 të klasës së shtatë dhe 6 të klasës së tetë.

Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, turq kanë qenë 1 nxënës i klasës së gjashtë, 14 të klasës së shtatë dhe 42 të klasës së tetë.



Sipas figurës tre mund të vërehet që përqindja më e madhe e të anketuarve ka qenë shqiptarë të klasës së gjashtë me gjithsej 30% dhe të atyre të klasës së tetë me gjithsej 25%. Ndërsa përqindja më e vogël e pjesëmarrësve kanë qenë nxënësit e klasës së pestë me gjithsej afërsisht 3% nga përqindja e duhur.

Pjesëmarrja e nxënësve shqiptarë në grupin e të anketuarve ka qenë me sa vijon: Nxënësit e klasës së gjashtë 30%, të klasës së shtatë 11% dhe asaj të tetë 25%. Ndërsa pjesëmarrja e nxënësve maqedonas ka qenë 2% e klasës së pestë, 1% e klasës së gjashtë, 4 % e klasës së shtatë dhe 3 % të klasës së tetë. Ndërsa shpërndarja e të anketuarve në bazë të klasës, nxënës të etnitetit turk kanë qenë: më pak se 1% nxënës të klasës së gjashtë, 6% të klasës së shtatë dhe 17% të klasës së tetë.

Ajo që bie në sy nga figura paraprake dhe që vlen të përmendet është se pjesëmarrja e nxënësve maqedonas edhe pse jo shumë e madhe në numër ka qenë e përfshirë nga të katër klasat edhe atë pjesëmarrës të klasave të pesta, gjashta, shtata dhe të teta. Që nuk është rasti me nxënësit turq, me ç ‘rast nuk kemi asnjë pjesëmarrës të klasave të pesta dhe po ashtu shqiptarë më ç ‘rast paraqitet mospjesëmarrje të nxënësve të klasave të pesta.

Përqindja më e madhe e pjesëmarrësve është e nxënësve shqiptarë të klasës së gjashtë dhe të tetë me afërsisht 30 dhe 25%, më pastaj e nxënësve turq të klasës së tetë me afërsisht 17 %. Ajo që bie në sy në këtë grafion është pjesëmarrja e nxënësve maqedonas edhe pse pak në numër por, nga të katër klasat e

mundshme edhe atë: 1% e nxënësve të klasës së pestë, 2% e nxënësve të klasës së gjashtë, 3% e klasës së shtatë si dhe 2% e atyre të klasës së tetë.

Shkolla:				
Etniteti	Ismail Qemali	Goce Dellçev	Vëllazërim bashkimi	Mustafa Kemal Ataturk
Shqiptarë	72	50	35	0
Maqedonas	0	23	1	0
Turq	0	0	0	56
Total	72	73	36	56

Tabela 4: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të shkollës

Në tabelën e katërt është paraqitur shpërndarja e pjesëmarrësve në bazë të shkollave edhe atë: 72 nxënës shqiptarë nga shkolla Ismail Qemali, 50 nga shkolla Goce Dellçev dhe 35 nga Vëllazërim Bashkimi.

Ndërsa nxënësit maqedonas kanë qenë pjesëmarrës nga shkolla Goce Dellçev gjithsej 23, si dhe Vëllazërim Bashkimi 1. Turqit vinë vetëm nga shkolla Mustafa Kemal Ataturk edhe atë me një numër të pjesëmarrësve prej 56.




Figura 4: Shkolla

Nga figura katër mund të vërehet lehtë përqindja e pjesëmarrësve në bazë të shkollave edhe atë: 30% shqiptarë nga Ismail Qemali, 21% nga Goce Dellçev, 14% nga Vëllazërim bashkimi. Përderisa përqindja e nxënësve maqedonas është nga shkolla Goce Dellçev me gjithsej afërsisht 10% dhe më pak se 1% nga Vëllazërim Bashkimi.

Një shpërndarje e njëjtë në shkollë është tek nxënësit turq të cilët vinë vetëm nga shkolla Kemal Atatürk me gjithsej 23 %. Nga figura duket qartë që pjesëmarrja më e madhe e nxënësve ka qene e atyre të shkollës fillore Ismail Qemali-shqiptarë dhe po aq afërsisht e atyre të shkollës Goce Dellçev afërsisht 30%. Përqindja më e vogël e pjesëmarrësve ka qen e nxënësve të shkollës Vëllazërim bashkimi me afërsisht 15%.

Analizuar në tërësi nxënës pjesëmarrës me më në numër kanë qenë nxënësit e shkollës fillore Ismail Qemali me gjithsej 30% shqiptarë ndërsa përqindje më të vogël kanë pas nxënësit maqedonas të shkollës Vëllazërim bashkimi duke mos përfshirë aspak përqindjen që është në 0 e disa shkollave ku nuk ka paralel në ato gjuhë siç është rasti i paraleleve maqedonase në shkollën Ismail Qemali apo turke në Goce Dellçev.

9.2 Analiza e rezultateve në bazë të pyetësorit

Pyetësori përbëhet nga tri pjesë edhe atë: pjesës së parë, që përmban analizën e përgjigjeve në bazë të përkatësisë, gjinisë, shkollës dhe klasës, në këtë rast të dhënat janë më të detajuara dhe unë kam një përshkrim edhe më të qartë të këtyre elementeve. Pjesa e dytë përbëhet nga grupi i pyetjeve me përgjigje, duke rrethuar njërën prej tyre apo përgjigje të hapura me ç ‘rast i lihet hapësira të anketuarit të përgjigjet ashtu siç është më mirë. Krejt në fund gjendet hapësira për analizë e disave nga të anketuarve me ç ‘rast ata me japin leje për të analizuar profilin e tyre në facebook.

Pyetësori është shpërndarë në tre gjuhë edhe atë, në gjuhën shqipe, maqedonase dhe turke. Pyetësori përbëhet nga gjithsej 16 pyetjeve me ç ‘rast 14 prej tyre ishin shkallë më pastaj të anketuarit kishin mundësinë të zgjedhin në mes të përgjigjes që më së afërmi korrespondon sjelljes së tyre dhe dy prej atyre ishin të lira.

Në grupin e pyetjeve shkallë, të anketuarit kanë pasur mundësi të zgjedhin ne mes të 3 apo katër varianteve, dhe në disa nga ato ka pasur zgjidhje tjetër, me ç ‘rast të anketuarve u është dhënë mundësia të përgjigjen në një mënyrë ndryshe nga ato të përcaktuarat paraprakisht.

Krejtësisht në fund pyetësori është përmbyllur me në pyetje ku të anketuarit i është dhënë mundësia të zgjedh të behet mik apo jo me mua. Në këtë rast të gjithë ata të cilat kanë pranuar të bëhen miq me mua, kanë dhënë mundësinë e bërjes së analizave të profilit të tyre. Me disa nga ato unë kam bërë analiza edhe më të detajuara.

1. Kur keni krijuar profilin tuaj në facebook?				
Etni.	a) para 1 jave	b) para 6 muajve	c) para 1-2 viteve	d) para më tepër se 2 viteve
Alb	9	39	74	35
Mac	1	4	15	3
Tr	2	10	37	8
Total	12	53	126	46

Tabela 5: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të kohës kur kanë krijuar profilin në facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të etnive).

Pyetja e parë i përket natyrës së pyetjeve informative edhe atë duke i vënë theks të veçantë periudhës kohore kur të intervistuarit kanë hapur facebook-un. Nga numri i përgjithshëm mundësi zgjedhjeje kanë pas versionin e parë, para një jave që në fakt përfshin të intervistuarit të cilët për para shumë pak kohe kanë hapur profilin e tyre në facebook, përpara 6 muajve, 1-2 viteve apo më tepër se dy viteve që në fakt renditen në grupin e shfrytëzuesve më të hershëm të cilët kanë krijuar profilin e tyre.

Në pyetjen kur keni hapur profilin tuaj në facebook, 9 shqiptarë janë përgjigjur para një jave, variantin e parë të zgjedhjes, 39 prej tyre kanë hapur profil para 6 muajve, 74 që është numër më i madh nga të tjetër janë përgjigjur që profilin e tyre e kanë hapur përpara 1-2 dhe 35 prej tyre më parë se dy vite.

Nga ana tjetër maqedonasit në këtë pyetje janë përgjigjur me sa vijon: 1 prej tyre shumë shpejt, para një jave, do të thotë përdorues shumë i ri i këtij rrjeti social, 4 prej tyre para gjashtë muajve, 15 para 1-2 viteve dhe 3 prej tyre më tepër se aq.


Ndërsa turqit janë përgjigjur 2 prej tyre para një jave, 10 para 6 muajve, 37 do me thënë më shumë nga ata para 1-2 viteve si dhe 8 më tepër se dy viteve. Kjo përfshirje në përqindje do të dukej me sa vijon.

1. Kur keni krijuar profilin tuaj në facebook?				
Gend	a) para 1 jave	b) para 6 muajve	c) para 1-2 viteve	d) para më tepër se 2 viteve
Fem	5	25	53	10
Mal	7	28	80	33
Total	12	53	133	43

Tabela 5: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të kohës kur kanë krijuar profilin në facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të gjinive).


Sipas tabelës më lartë mund të vërehet lehtë që pjesa më e madhe e femrave kanë hapur profilin e tyre në facebook edhe atë 53 prej tyre para 1-2 viteve gjersa një numër i konsiderueshëm i meshkujve kanë hapur po këtë profil para të njëjtës kohë edhe atë 80 prej tyre. Një numër shumë i vogël i shfrytëzuesve të

facebook kanë hapur profil një kohë më parë edhe atë 5 femra dhe 7 meshkuj. Përderisa pjesë e konsiderueshme e tyre koncentrohen më shumë në periudhën 1-2 vite dhe para 6 muajve. Afërsisht 53 dhe 133 prej tyre.



Afërsisht 4% e shqiptarëve kanë hapur profilin e tyre pak kohë më parë, 16% para 6 muajve, 31% prej tyre ara 1-2 viteve si dhe 14% më parë se dy viteve. Nga maqedonasit më pak se një për qind e tyre kanë hapur profilin para një jave, 1 % para 6 muajve, 6% para 1-2 viteve dhe 1 % me tepër se dy viteve. Nga nxënësit turq, më pak se 1% e tyre kanë hapur profilin e tyre para 1 jave, 4% para 6 muajve, 15% para 1-2 viteve dhe 3% më tepër se dy vite.

Nga pyetja e parë e cila i vë theks të veçantë periudhës kohore se kur kanë hapur profilin e tyre në facebook nxënësit e shkollave fillore në Gostivar, mund të vërehet që përqindja më e madhe e të anketuarve shqiptarë, turq apo maqedonas kanë hapur profil përpara 1-2 viteve edhe atë 53% e tyre që do të thotë mbi gjysma e tërësisë së përgjithshme.



Shpërndarja e nxënësve të shkollave fillore të Gostivarit në bazë të përqindjes dhe kohës kur ata kanë krijuar profilin e tyre në rrjetin social duket me sa vijon. Përqindja më e madhe e meshkujve kanë klikuar profilin e facebook-ut më parë edhe atë 33% në periudhë kohore prej para 1-2 viteve, derisa sa kjo përqindje për femrat del të jetë 22% afërsisht 10% e meshkujve kanë hapur profilin e tyre më tepër nga femrat. Duke krahasuar periudhën kohore të hapjes së profilit sipas gjinive në përqindje del që afërsisht 25% e femrave kanë hapur profilin e tyre kohë më parë përderisa 12% e tyre shumë shpejt dhe 47% e meshkujve kanë hapur profilin e tyre shumë kohë më parë dhe 13% shumë shpejt. Nga këtu shohim që meshkujt kanë hapur profilin e tyre më parë por, mos harrojmë që pjesëmarrja e femrave dhe e meshkujve në këtë pyetësori ka qenë në me dy edhe atë për meshkujt në shumice. Por, si do që të jetë përsëri meshkujt dalin që më herët nga femrat kanë hapur profilin e tyre në facebook.

Pyetja e parë dëshmon që meshkujt hapin veten më parë nga femrat ndërsa për sa i përket etnive, turqit e hapin veten më tepër se shqiptaret dhe maqedonasit. Duke krahasuar pjesëmarrjen e etnive nga përqindja e përgjithshme del që 72% e turqve kanë hapur facebook disa vite më parë dhe 70% e maqedonasve dhe shqiptarëve po në këtë periudhë kohore.

2. Sa orë në ditë shfrytëzoni facebook?

Ethn.	a) më pak se 2 orë	b) 2 orë	c) më shumë se 2 orë	d) më shumë se 5 orë
Alb	61	43	35	18
Mac	11	7	5	0
Tr	27	12	15	3
Total	99	62	55	21

Tabela 6: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë orëve që përdorin facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të etnive).


Nga tabela 6 mund të vërehet lehtë që pjesa më e madhe e shqiptarëve përdorin facebook-un më pak se 4 orë në ditë. Për dallim nga maqedonasit të cilët shfrytëzojnë këtë rrjet 2 dhe më pak se 2 orë. Ndërsa turqit pjesa më e madhe e tyre përdorin facebook gjithashtu 2 dhe më pak se dy orë.

2. Sa orë në ditë shfrytëzoni facebook?

Gend	a) më pak se 2 orë	b) 2 orë	c) më shumë se 2 orë	d) më shumë se 5 orë
Fem	48	23	15	3
Mal	51	39	39	19
Total	99	62	54	22


Tabela 6: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë orëve që përdorin facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të gjinive).

Duke krahasuar përdorimin e facebook-ut në bazë të gjinive del që pjesa më e madhe e tyre afërsisht 70 prej tyre përdorin këtë rrjet 2 dhe më pak se 2 orë. Për dallim nga meshkujt mbi 80 prej tyre përdorin facebook 2 dhe më pak se 2 orë dhe afërsisht 60 prej tyre mbi 2 orë.



Në grafikun 6 është paraqitur qartë përdorimi i rrjetit social në bazë të përqindjeve. Sipas shfrytëzimit të facebook-it në bazë të etnive del që shqiptarët përdorin facebook-un dy dhe më pak se dy orë 65% e tyre, turqit përdorin këtë rrjet 64%, dhe maqedonasit 60%, derisa shqiptarët përdorin rrjetin social 2 dhe më tepër se dy orë 31% e tyre, që nuk mund të llogaritet si përqindje e vogël, turqit shfrytëzojnë këtë rrjet 28 % dhe maqedonasit 20 %.

Nga përqindja e përgjithshme del që 65 % e shqiptarëve përdorin rrjetin social facebook 2 dhe më pak se dy orë dhe po të njëjtit, 31% e tyre përdorin këtë rrjet mbi 2 orë.



Në bazë të gjinive dhe përdorimit të facebook del që 20% e femrave përdorin facebook më pak se dy orë, përderisa 85% e tyre përdorin atë më tepër se dy orë. Nga ana tjetër kalkulimi në përqindje del që 38% e

meshkujve përdorin facebook më pak se dy orë dhe 62 % e tyre më tepër se dy orë. Pjesa më e madhe e meshkujve në krahasim me femrat përdorin facebook më tepër se 2 orë edhe atë 38% afërsisht 14% më tepër në krahasim me femrat, ndërsa femrat janë më në përqindje për sa i përket shfrytëzimit të facebook për periudhë prej 2 dhe më pak se 2 orë. Ndryshe thënë ky kalkulum në përqindje del afërsisht 85 % ndërsa meshkujt 59 %.

Përfundimisht del që 65 % e shqiptarëve përdorin rrjetin social facebook 2 dhe më pak se dy orë dhe po të njëjtit, 31% e tyre përdorin këtë rrjet mbi 2 orë. Për sa i përket shpërndarjes në bazë të gjinive, meshkujt në krahasim me femrat përdorin facebook më tepër se 2 orë edhe atë 38% ndërsa femrat janë më në përqindje për sa i përket shfrytëzimit të facebook për periudhë prej 2 dhe më pak se 2 orë. Ndryshe thënë ky kalkulum në përqindje del afërsisht 85 %.

3. Pse keni hapur profilin tuaj në facebook?					
Ethn	a) për shoqërim-zbavitje	b) mësim	c) kureshtje	d) të gjithë kanë fb, edhe unë dua	e) kaluar kohën
Alb	79	6	3	39	30
Mac	19	0	2	2	0
Tr	26	0	8	14	9
Total	124	6	13	55	39

Tabela 7: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të arsyes së hapjes së profilit në facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të etnive).

Në vazhdim, tabela 7 përshkruan arsyen e hapjes së rrjetit social. Në bazë të dhënave del që 79 prej të anketuarve shqiptarë kanë hapur profil në rrjetin social për zbavitje, 6 prej tyre për mësim, 3 për kureshtje, 39 sepse të gjithë të tjerët kanë, dëshirojnë të kenë edhe ata si dhe 30 prej tyre vetëm për të kaluar kohën. Për dallim nga shqiptarët, 19 maqedonas nga numri i përgjithshëm i të anketuarve kanë hapur profil në facebook për zbavitje, 2 prej tyre për kureshtje, 2 për shkak se e tërë shoqëria e tyre kanë facebook. Maqedonasit në dallim nga shqiptarët asnjëri nga ata nuk kanë hapur facebook për mësim apo për të kaluar kohën. Nxënësit turq nga ana tjetër paraqiten me një pjesëmarrje tjetër edhe atë: 26 prej tyre kanë hapur profil për shoqërim, 8 për kureshtje, 14 për shkak se e tërë shoqëria kanë facebook dëshirojnë të kenë edhe atë si dhe 9 për të kaluar kohën.

3. Pse keni hapur profilin tuaj në facebook?

Gend	a) për shoqërim-zbavitje	b) mësim	c) kureshtje	d) të gjithë kanë fb, edhe unë dua	e) kaluar kohën
Fem	43	3	6	23	14
Mal	81	3	7	32	25
Total	124	6	13	55	39

Tabela 7: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të arsyes së hapjes së profilit në facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të gjinive).

Në tabelën 7 paraqitet qartë arsyeja e hapjes së rrjetit social duke u ndarë nëpër gjini. Nga të dhënat vërehet lehtë që pjesa më e madhe femrave kanë hapur rrjetin social për zbavitje, gjersa pjesa më e vogël e tyre për mësim edhe atë 3 prej tyre. Duke krahasuar meshkujt shohim që edhe shumica e meshkujve janë përgjigjur duke thënë që kanë hapur profil për shoqërim apo zbavitje. Numri më i vogël i tyre kontrollojnë profilin për mësim.





Figura 7: Pse keni hapur profilin tuaj në facebook?

Duke analizuar këto të dhëna në përqindje shohim artë që 33.3% e shqiptarëve kanë hapur profilin tyre në facebook për shoqërim gjersa pjesa prej 1.26% e tyre për kureshtje. Duke analizuar maqedonasit shohim që pjesa më e madhe e tyre përdorin rrjeti social për shoqërim ndërsa aspak nga ato nuk përdorin facebook për mësim apo për të kaluar kohën. Një situatë pak a shumë e ngjashme është edhe tek turqit më ç ‘rast shumica e tyre afërsisht 11% përdorin facebook për shoqërim dhe asnjëri nga ato nuk hapën facebook për mësim.

Duke analizuar të gjithë etnitë dhe pjesëmarrje e tyre në bazë të përqindjes së përgjithshme del që gjysma e nxënësve shqiptarë hapin profil në facebook për shoqërim gjersa përqindja më e vogël e tyre, 1.5% hapin facebook për kureshtje. Pjesa më e madhe e maqedonasve hapin profil në facebook për shoqërim 80% e tyre dhe asnjëri nga ata nuk konsulton facebook për mësim apo për të kaluar kohën. 40% e nxënësve turq hapin profil për shoqërim gjersa asnjëri nga ato nuk ka profil për mësim. Përfundimisht nxënësit maqedonas përdorin facebook-un për shoqërim, gjysma e nxënësve shqiptarë përdorin facebook për zbavitje, dhe asnjëri nga nxënësit maqedonas dhe turq nuk përdorin rrjetin social për mësim.



Në figurën 7 është bërë paraqitja reale në përqindje për sa i përket arsyes së hapjes së facebook në bazë të gjinive. Nga trafikoni lartë duket qartë që pjesa më e madhe e femrave afërsisht 53% e tyre kanë hapur profil në facebook për shoqërim ndërsa pjesa më e vogël, 4% për mësim. Në krahasim prej meshkujve të cilët pohojnë që kanë hapur profil për zbavitje edhe atë 55% e tyre dhe pjesa më e vogël prej 4% për mësim.

Përfundimisht nxënësit maqedonas përdorin facebook-un për shoqërim, gjysma e nxënësve shqiptarë përdorin atë për zbavitje, dhe asnjëri nga nxënësit maqedonas dhe turq nuk përdorin rrjetin social për mësim. Për dallim nga etnitë, afërsisht 53% e femrave kanë hapur profil në facebook për shoqërim ndërsa pjesa më e vogël, 4% për mësim. Në krahasim prej meshkujve të cilët pohojnë që kanë hapur profil për zbavitje edhe atë 55% e tyre dhe pjesa më e vogël prej 4% për mësim.

4. Sa miq keni të regjistruar në facebook?				
Ethn.	a) më pak se 50	b) përafërsisht 100	c) 200	d) mbi 200
Alb	32	52	27	46
Mac	0	6	3	14
Tr	9	16	13	19
Total	41	74	43	79


Tabela 8: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të numrit të miqve të regjistruar në facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të etnive).

Pyetja e katërt paraqet sasinë, kuantitetin në numër të miqve që nxënësit e shkollave fillore në Gostivar kanë. Duke analizuar këtë shohim që pjesa më e madhe e shqiptarëve, maqedonasve dhe turqve kanë të regjistruar një numër të konsiderueshëm të miqve në facebook. Vërehet lehtë që asnjë nga nxënësit maqedonas nuk ka më pak se 50 miq të regjistruar në profil. Nga ana tjetër një numër i konsiderueshëm i tyre, 32 nxënës shqiptarë kanë më pak se 50 miq të regjistruar në facebook që nuk ndodh me etnitetet tjera, turqit dhe maqedonasit.

4. Sa miq keni të regjistruar në facebook?				
Gend	a) më pak se 50	b) përafërsisht 100	c) 200	d) mbi 200
Fem	22	31	11	25
Mal	19	43	32	54
Total	41	74	43	79


Tabela 8: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të numrit të miqve të regjistruar në facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të gjinive).

Duke krahasuar këtë sasi të caktuar në ndarje sipas gjinive, del që pjesa më e madhe e femrave kanë një numër mbi 50 të miqve të regjistruar në profilin e tyre përderisa një pasqyrë e njëjtë vlen edhe për gjininë tjetër, për meshkujt me ç 'rast pjesa më e madhe e tyre kanë mbi 520 miq të regjistruar në facebook.



Duke krahasuar grafikonet më lartë dhe shpërndarjen e të dhënave në përqindje mund të vërejmë lehtë që 13% e shqiptarëve kanë të regjistruar më pak se 50 miq, ndërsa pjesa tjetër e tyre 51% kanë të regjistruar në profil mbi 50 miq në profil. Kjo është në përqindje e konsiderueshme për të dëshmuar që shqiptarët janë popull i shoqërueshëm dhe të hapur në pikëpamje të miqësive. Tek maqedonasit del që asnjë për qind e tyre nuk kanë më pak se 50 miq të regjistruar në facebook. Nga këtu del që nxënësit maqedonas janë nxënësit më të hapur në krahasim prej shqiptarëve dhe turqve. Këta të fundit, dëshmojnë që vetëm afërsisht 4% e tyre nga përqindja e përgjithshme janë kanë të regjistruar më pak se 50 % në profil.

Duke krahasuar këto të dhëna mund të përfundojmë që nxënësit më të hapur janë maqedonasit, dhe të gjithë nga ata kanë të regjistruar në profil mbi 50 miq, më pastaj turqit më një përqindje prej 15% dhe më në fund shqiptarët të cilët paraqiten me një përqindje prej 20%.



Në krahasim me përqindjen e etniteteve në shpërndarje të gjinive del që 9% e femrave kanë të regjistruar në profil më pak se 50 miq përderisa tek meshkujt, 8% e tyre. Duke krahasuar këtë shpërndarje në bazë të pjesëmarrjes së përgjithshme të këtyre dy gjinive del që 27 % e femrave kanë të regjistruar më pak se 50 miq në facebook përderisa 12% e meshkujve kanë të regjistruar më pak se 50 miq.

Përfundimisht në bazë të shpërndarjes së të dhënave në përqindje mund të themi që meshkujt janë më të hapur se femrat me ç ‘rast dallimi në përqindje është afërsisht 15% meshkujt janë më të hapur se femrat për të krijuar miq në rrjetin social facebook.

Duke krahasuar këto të dhëna mund të përfundojmë që nxënësit më të hapur janë maqedonasit, dhe të gjithë nga ata kanë të regjistruar në profil mbi 50 miq, më pastaj turqit më një përqindje prej 15% dhe më në fund shqiptarët të cilët paraqiten me një përqindje prej 20%.

Në bazë të shpërndarjes së të dhënave në përqindje mund të themi që meshkujt janë më të hapur se femrat me ç ‘rast dallimi në përqindje është afërsisht 15% meshkujt janë më të hapur se femrat për të krijuar miq në rrjetin social facebook.

5. Ku e përdorni më së shumti facebook-un?			
Ethn.	a) në shkollë	b) në shtëpi	c) tjetër
Alb	6	137	14
Mac	0	23	0
Tr	3	46	8
Total	9	206	22


Tabela 9: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të lokacionit-vendit ku përdorin rrjetin social-facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të etnive).

Tabela 9 paraqet të dhënat e përdorimit të rrjetit social dhe lokacioni i përdorimit të tij. Në këtë tabelë vërehet lehtë që shumica e nxënësve shqiptarë përdor rrjetin social në shtëpi edhe atë në një numër prej 137 nxënësve. Përderisa pjesa më e vogël e tyre përdorin rrjetin në shkollë edhe atë vetëm 6 nga ata. Kjo është një përqindje e mirë për të vërtetuar që nxënësit nuk e keqpërdorin orën mësimore duke u kyçur në rrjet. Tek nxënësit maqedonas shpërndarja e të dhënave është më ndryshe, të gjitha nxënësit përdorin facebook në shtëpi. Kjo do të thotë që nga të dhënat tona të gjithë nxënësit maqedonas kanë kompjuterë dhe internet të instaluar në shtëpi. Te nxënësit turq del që pjesa më e madhe e tyre kyçen në facebook në shtëpi edhe e atë 46 prej tyre.

5. Ku e përdorni më së shumti facebook-un?			
Gend	a) në shkollë	b) në shtëpi	c) tjetër
Fem	0	86	3
Mal	9	120	19
Total	9	206	22

Tabela 9: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të lokacionit-vendit ku përdorin rrjetin social-facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të gjinive).


Duke krahasuar këto të dhëna në bazë të gjinive del që pjesa më e madhe e femrave përdorin facebook në shtëpi edhe atë 86 prej tyre dhe shumë pak në shkollë e tjetër. Përderisa tek meshkujt 120 prej tyre kyçen në rrjet në shtëpi, 9 prej tyre në shkollë dhe 19 diku tjetër që në këtë rast mund të jenë internet kafetë, ose lokacionet tjera të frekuentuara nga fëmijët e këtyre grup moshave.



Në bazë të shpërndarjes së të dhënave në përqindje del që 87% e shqiptarëve përdorin facebook në shtëpi përderisa 4% në shkollë dhe pjesa tjetër diku tjetër që mund të jenë internet kafetë apo lokacionet e

tjera të cilat i frekuentojnë fëmijët e këtyre grup moshave. Të gjithë maqedonasit 100% e tyre përdorin facebook në shtëpi, shpresoj prindërit e tyre e dinë këtë gjë. Ky fakt është një mundësi shumë e mirë për t'i kontrolluar fëmijë në shtëpi dhe përdorimin e internetit. 77% e nxënësve turq përdorin facebook në shtëpi ndërsa 5% e tyre në shkollë dhe pjesa tjetër diku tjetër.

Duke krahasuar të gjithë pjesëmarrësit del që nxënësit maqedonas në pjesëmarrje absolute përdorin facebook në shtëpi, me pastaj shqiptaret me një përqindje prej 87% dhe në fund turqit me një pjesëmarrje prej 77%. Ndërsa për sa i përket përdorimit të rrjetit në shkollë, më tepër në përqindje janë turqit me një përqindje prej 5%, shumë afër shqiptarët edhe atë 4% e tyre ndërsa maqedonasit nuk përdorin rrjetin social aspak në shkollë.



Asnjë i anketuar nga gjinia femërore nuk përdorin rrjetin social në shkollë dhe përqindja më e madhe e tyre 36% përdorin rrjetin social në shtëpi. Tek meshkujt del që 81% e tyre përdorin rrjetin social në shtëpi dhe 6% e tyre në shkollë.

Përfundimisht del që nxënësit maqedonas në pjesëmarrje absolute përdorin facebook në shtëpi, më pastaj shqiptarët me një përqindje prej 87% dhe në fund turqit me një pjesëmarrje prej 77%. Ndërsa për sa i përket përdorimit të rrjetit në shkollë, më tepër në përqindje janë turqit me një përqindje prej 5%, shumë afër shqiptarët edhe atë 4% e tyre ndërsa maqedonasit nuk përdorin rrjetin social aspak në shkollë. Në bazë të gjinive del që 36% e femrave përdorin rrjetin social në shtëpi, asnjëra nga ata nuk përdor facebook në shkollë. Tek meshkujt del që 81% e tyre përdorin rrjetin social në shtëpi dhe 6% e tyre në shkollë.

6. A mendoni që facebooku ju pengon në kryerjen e obligimeve tua?				
Ethn	a) Po	b) Jo	c) Ndoshta	d) Nuk e di
Alb	36	60	43	18
Mac	0	13	10	0
Tr	10	26	17	4
Total	46	99	70	22


Tabela 10: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të ndikimit negativ të rrjetit social (shpërndarja e përqindjes në bazë të etnive).

Në tabelën 10 është bërë paraqitja e të dhënave në bazë të përdorimit të facebook dhe efekteve që ai ka. çka mendojnë nxënësit për përdorimin e këtij rrjeti? A u pengon apo jo në kryerjen e obligimeve atyre? Pjesa më e madhe e tyre mendojnë që nuk u pengon në kryerjen e obligimeve të tyre. 36 nxënës mendojnë që po u pengon dhe pjesa tjetër janë përgjigjur duke rrethuar versionin nuk e di apo ndoshta. Asnjë nxënës maqedonas nuk mendon që facebook i pengon në kryerjen e obligimeve. Ndërsa përqindja më e madhe nuk mendojnë aspak që rrjeti social u pengon në kryerjen e obligimeve të tyre. Duke krahasuar nxënësit turq del që 10 prej tyre mendojnë që po rrjeti social u pengon në kryerjen e obligimeve të tyre ndërsa pjesa më e madhe e nxënësve turq nuk mendojnë që facebook ju pengon në kryerjen e obligimeve të tyre.


6. A mendoni që facebook-ku ju pengon në kryerjen e obligimeve tua?				
Gend	a) Po	b) Jo	c) Ndoshta	d) Nuk e di
Fem	17	34	27	11
Mal	29	65	43	11
Total	46	99	70	22

Tabela 10: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të ndikimit negativ të rrjetit social (shpërndarja e përqindjes në bazë të gjinive).

Në bazë të shpërndarjes së gjinive del që pjesa më e madhe e femrave nuk mendon që facebook ju pengon në kryerjen e obligimeve të tyre. Diku afër një numër i caktuar i tyre janë përgjigjur që ndoshta. Në krahasim prej meshkujve të cilët mendojnë që nuk u pengon në kryerjen e obligimeve të tyre derisa një pjesë e madhe e tyre mendojnë që ndoshta.



Në bazë të përqindjes del që pjesa më e madhe e shqiptarëve edhe atë 50 % e tyre mendojnë që facebooku u pengon në kryerjen e obligimeve të tyre dhe 37% mendojnë që nuk u pengon. Tek maqedonasit, pjesa më e madhe mendojnë që nuk u pengon edhe atë 54% e tyre, ndërsa vetëm 42% e tyre mendojnë që facebooku ndoshta u pengon në kryerjen e obligimeve të tyre. Tek nxënësit turq kemi një përqindje prej 45% që mendojnë po dhe ndoshta mund tu pengojën rrjeti social facebook në kryerjen e obligimeve të tyre dhe 43% e tyre nuk mendojnë që facebook ju pengon për kryerjen e obligimeve të tre.



Në bazë të gjinive del që 54% e femrave mendojnë që facebook ju pengona atyre në kryerjen e obligimeve dhe 42% deklarohen që nuk u pengon rrjeti social në kryerjen e obligimeve të tyre. Përderisa tek meshkujt, 44% mendojnë që facebook nuk u pengon atyre për të kryer obligimet dhe 48% u pengon atyre.

Pjesa më e madhe e shqiptarëve edhe atë 50 % e tyre mendojnë që facebook u pengon në kryerjen e obligimeve të tyre dhe 37% mendojnë që nuk u pengon. Tek maqedonasit, pjesa më e madhe mendojnë që nuk n u pengon edhe atë 54% e tyre, ndërsa vetëm 42% e tyre mendojnë që facebook ndoshta u pengon në kryerjen e obligimeve të tyre. Tek nxënësit turq kemi një përqindje prej 45% që mendojnë po dhe ndoshta mund tu pengojnë rrjeti social facebook në kryerjen e obligimeve të tyre dhe 43% e tyre nuk mendojnë që facebook ju pengon për kryerjen e obligimeve të tyre. 54% e femrave mendojnë që facebook ju pengona tyre në kryerjen obligimeve dhe 42% deklarohen që nuk u pengon rrjeti social në kryerjen e obligimeve të tyre. Përderisa tek meshkujt, 44% mendojnë që facebook nuk u pengon atyre për të kryer obligimet dhe 48% u pengon atyre.

Gjysma e nxënësve shqiptarë 50% deklarojnë që facebook ju pengon në kryerjen e obligimeve të tyre, mbi gjysma, 54% e nxënësve maqedonas nuk mendon që facebook ju pengon.

Pjesa më e madhe e meshkujve dhe femrave mendojnë që facebook ju pengon në kryerjen e obligimeve edhe atë 54% femra dhe 48% meshkuj.

7. Sa fotografi keni të publikuara në profilin tuaj?				
Ethn.	a) më pak se 10	b) deri 50	c) 100	d) mbi 100
Alb	69	58	10	20
Mac	7	10	3	3
Tr	34	13	6	4
Total	110	81	19	27

Tabela 11: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të numrit të fotografive-sasisë të publikuara në facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të etnive).


Në tabelën 11 është paraqitur numri i fotografie i publikuar në profilin e secilit student në facebook. Nga këtu mund të vërejmë që pjesa më e madhe e nxënësve shqiptarë ka të publikuara 50 dhe më pak se aq. Njëlloj vlen edhe për nxënësit maqedonas dhe turq.

7. Sa fotografi keni të publikuara në profilin tuaj?

Gend	a) më pak se 10	b) deri 50	c) 100	d) mbi 100
Fem	53	23	5	8
Mal	57	58	14	19
Total	110	81	19	27


Tabela 11: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të numrit të fotografive-sasisë të publikuara në facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të gjinive).

Për sa i përket numrit të fotografive të publikuara në facebook dhe shpërndarjes sipas gjinive del që pjesa më e madhe e meshkujve dhe femrave deklarojnë që kanë të publikuara në profilin tyre 50 dhe më pak se aq fotografi në facebook.



Duke krahasuar këto të dhëna në përqindje del që 81% e nxënësve shqiptarë kanë të publikuara në profil 50 dhe më pak se aq fotografi në profilin e tyre në facebook. Përderisa pjesa tjetër e tyre më tepër se aq. Në krahasim prej tyre, 71% e nxënësve maqedonas kanë të publikuara 50 dhe më pak foto në profilin e tyre, si dhe 79% e nxënësve turq kanë 50 dhe më pak fotografi të publikuara në profilin tyre.

Nga këto të dhëna mund të vërejmë që nxënësit maqedonas janë më të hapur në publikim të fotografive në krahasim me nxënësit e tjerë edhe atë, maqedonasit kanë më tepër se 100 fotografi të publikuara në facebook 29% e tyre, më pastaj turqit me gjithsej 21% dhe shqiptarët me gjithsej 19%.



Nga shpërndarja e përqindjes në bazë të gjinive del që 94% e femrave kanë të publikuara në profil 50 dhe më pak fotografi në profilin tyre, përderisa 78% e meshkujve kanë këtë numër. Nga ana tjetër vërehet lehtë që meshkujt kanë më tepër se 100 fotografi të publikuara në facebook edhe atë 22% e tyre ndërsa vetëm 6% e femrave kanë mbi 100 foto të publikuara në profilin e tyre.

Nga këto të dhëna mund të vërejmë që nxënësit maqedonas janë më të hapur në publikim të fotografive në krahasim me nxënësit e tjerë edhe atë, maqedonasit kanë më tepër se 100 fotografi të publikuara në facebook 29% e tyre, më pastaj turqit me gjithsejtë 21% dhe shqiptarët me gjithsej 19%. Nga ana tjetër vërehet lehtë që meshkujt kanë më tepër se 100 fotografi të publikuara në facebook edhe atë 22% e tyre ndërsa vetëm 6% e femrave kanë mbi 100 foto të publikuara në profilin e tyre.

8. Sa prej tyre janë gjysmë lakuriqe apo lakuriqe?

Ethn.	a) aspak	b) mesatarisht	c) shumë	d) tjetër
Alb	100	38	17	2
Mac	21	1	0	1
Tr	54	3	0	0
Total	175	42	17	3

Tabela 12: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të numrit të fotografive provokative të publikuara në facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të etnive).

Tabela 12 paraqet llojin e fotografive të publikuara në facebook. A janë këto fotografi probokative apo jo? Sa prej tyre janë lakuriqe apo gjysmë lakuriqe. Kam vërejtur në profilin e disa nxënësve që kanë


publikuar fotografi me rroba banjë në pushim, vende bregdetare apo meshkujt fotografi me pjese të sipërme të trupit lakuriqe. Nga të dhënat mund të vërejmë që shumica e nxënësve të shkollave fillore në Gostivar qoftë shqiptarë maqedonas apo turq janë përgjigjur duke rrethuar që nuk kanë asnjë foto provokative të publikuar në profilin tyre. Përderisa disa nga ata kanë rrethuar duke thënë që kanë mesatarisht, shumë apo tjetër.

8. Sa prej tyre janë gjysmë lakuriqe apo lakuriqe?¹⁴

Gend	a) aspak	b) mesatarisht	c) shumë	d) tjetër
Fem	77	7	3	2
Mal	98	35	14	1
Total	175	42	17	3


Tabela 12: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të numrit të fotografive provokative të publikuara në facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të gjinive).

Në bazë të publikimit të fotove në profilin e tyre në facebook nxënëset dhe nxënësit e shkollave fillore në Gostivar anë përgjigjur duke rrethuar që pjesa më e madhe tyre nuk kanë të publikuar asnjë foto në profilin tyre. Përderisa disa nga meshkujt dhe femrat janë deklaruar që kanë publikuar foto të tilla në facebook.



¹⁴ Fjala lakuriqe apo gjysmë lakuriqe përshkuan llojin e fotove të cilat të rinjtë i publikojnë duke nxjerr foto në plazh, disko, pube të ndryshme.

Duke krahasuar këto të dhëna në bazë të përqindjes del që 63% e nxënësve shqiptarë nuk kanë të publikuar asnjë foto provokative në profilin tyre, 88% e nxënësve maqedonas dhe 91 e atyre turq. Përderisa pjesa më e madhe nxënësve shqiptarë 37% e tyre kanë të publikuara foto të tilla në rrjetin social më pastaj nxënësit maqedonas, 12% e tyre si dhe 9% e nxënësve turq.



Në bazë të shpërndarjes në përqindje në bazë të gjinive del që 95% e vajzave deklarojnë që nuk kanë të publikuar asnjë foto provokative, gjysmëlakuriqe apo lakuriqe në profilin tyre. Për dallim nga femrat, 66% e meshkujve deklarojnë që nuk kanë të publikuara foto të tilla në profilin tyre. Ndryshe thënë 34% e meshkujve kanë të publikuara fotografi provokative në profilin tyre përderisa, vetëm 5% e femrave kanë foto të tilla në profil.

Pjesa më e madhe e nxënësve shqiptarë 37% e tyre kanë të publikuara foto provokative në rrjetin social më pastaj nxënësit maqedonas më nj pjesëmarrje prej gjithsej, 12% si dhe nxënësit turq më gjithsej 9%. 34% e meshkujve kanë të publikuara fotografi provokative në profilin tyre përderisa, vetëm 5% e femrave kanë foto të tilla në profil.

9. Sa herë u shkruani komente miqve, familjarëve?

Ethn.	a) aspak	b) rrallëherë	c) shpesh	d) çdo herë
Alb	10	57	50	40
Mac	0	17	5	1
Tr	2	37	8	10
Total	12	111	63	51


Tabela 13: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të numrit të fotografive-sasisë të publikuara në facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të etnive).

Tabela 13 paraqet të dhënat në bazë të etnive në lidhje me komentet që këta bëjnë në facebook. Sa shpesh nxënësit e shkollave fillore në Gostivar u bëjnë komente miqve apo familjarëve. Nga të dhënat del që pjesa më e madhe e nxënësve shqiptar, turq apo maqedonas u shkruajnë komente miqve të tyre në facebook shpesh edhe atë 147 prej tyre shqiptarë, 23 maqedonas si dhe mbi 50 turq.

9. Sa herë u shkruani komente miqve, familjarëve?				
Gend	a) aspak	b) rrallëherë	c) shpesh	d) çdo herë
Fem	5	48	24	12
Mal	7	63	39	39
Total	12	111	63	51


Tabela 13: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të numrit të fotografive-sasisë të publikuara në facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të gjinive).

Duke krahasuar këto të dhëna në bazë të gjinive del që një pjesë shumë e vogël e nxënësve femra dhe meshkuj nuk u shkruajnë asnjëherë komente femrave apo meshkujve edhe atë vetëm 5 nxënës femra si dhe 7 nxënës meshkuj.



Në bazë të shpërndarjes së të dhënave në përqindje del që 94% e nxënësve shqiptarë të shkollave fillore në Gostivar u shkruajnë komente miqve, familjarëve të tyre, 100% nxënësit maqedonas, si dhe 97% e nxënësve turq. Nga ana tjetër 6% e nxënësve shqiptarë nuk u shkruajnë asnjëherë komente miqve apo familjarëve, si dhe 3% e nxënësve turq.

Përfundimisht del që nxënësit maqedonas u shkruajnë më shumë komente miqve dhe familjarëve të tyre, me pastaj nxënësit turq me gjithsej 97% si dhe shqiptarët me një përqindje prej 94%.



Sipas të dhënave në bazë të gjinive dhe shkrimit të komenteve del që 94% e femrave bëjnë komente në facebook, miqve familjarëve të tyre si dhe 96% e meshkujve. Për dallim nga kjo 6% e femrave deklarojnë që asnjëherë nuk u bëjnë komente miqve apo familjarëve të tyre si dhe 4% e meshkujve thonë që asnjëherë nuk bëjnë komente në facebook. Nga këtu del që meshkujt bëjnë më shumë komente miqve apo familjarëve se sa femrat.

Për sa i përket komenteve që bëjnë përdoruesit e rrjetit social mund të themi që nxënësit maqedonas u shkruajnë më shumë komente miqve dhe familjarëve të tyre 100%, më pastaj nxënësit turq me gjithsej 97% si dhe shqiptarët me një përqindje prej 94%. Në aspekt të gjinive del që 94% e femrave u bëjnë komente në facebook, miqve familjarëve të tyre si dhe 96% e meshkujve.

10. A e kontrolloni facebook-un gjatë orës së mësimit?

Ethn	a) asnjëherë	b) ndonjëherë	c) rrallëherë	d) shpesh	e) çdo herë
Alb	95	44	7	11	0
Mac	17	1	4	0	1
Tr	27	16	5	4	5
Total	139	61	16	15	6

Tabela 14: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të kontrollimit të facebook-ut në orë të mësimit (shpërndarja e përqindjes në bazë të etnive).


Nga të dhënat në tabelën 14 e cila mat përdorimin e facebook-ut gjatë orës së mësimi, del që pjesa më e madhe e nxënësve shqiptarë nuk e përdorën facebook-un gjatë orës së mësimi, përdorisa në bazë të përqindjes nxënësit maqedonas gjithashtu pohojnë të njëjtën. Një dallim kemi tek nxënësit turq, më ç ‘rast përqindja më e madhe e tyre kontrollojë profilin e tyre gjatë orës së mësimi.

10. A e kontrolloni facebook-un gjatë orës së mësimi?

Gend	a) asnjëherë	b) ndonjëherë	c) rrallëherë	d) shpesh	e) çdo herë
Fem	62	15	6	3	3
Mal	77	46	10	12	3
Total	139	61	16	15	6


Tabela 14: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të kontrollimit të facebook-ut në orë të mësimi (shpërndarja e përqindjes në bazë të gjinive).

Dukë analizuar përdorimin e rrjetit social nga nxënësit e shkollave fillore në Gostivar del që pjesa më e madhe e femrave pohojnë që nuk hapin profilin tyre gjatë orës së mësimi. Ndërsa tek meshkujt kjo përqindje nuk ka shumë dallim. Gati se gjysma e tyre pohojnë që nuk hapin asnjëherë facebook në orë të mësimi dhe po e njëjta përqindje që po e hapin facebook gjatë orës së mësimi.



Duke krahasuar këto të dhëna në bazë të përqindjes del që 60% e nxënësve shqiptarë nuk kontrollojnë profilin e tyre në facebook gjatë orës së mësimi, 71% të nxënësve maqedonas, si dhe 45% e nxënësve turq. Nga ana tjetër del që 55% e nxënësve turq e kontrollojë profilin gjatë orës së mësimi, 40% e nxënësve shqiptarë si dhe 29% e atyre maqedonas. Nxënësit turq kontrollojnë profilin tyre në facebook më

shumë nga nxënësit e tjerë edhe atë 55% që është më shumë se gjysma, dhe kjo gjë sipas meje nuk është aspak mirë. Më pastaj shqiptarët me gjithsej 40% si dhe maqedonasit me një paraqitje prej gjithsej 29%. Asnjëra nga këto përqindjet nuk është e kënaqshme pasi që përdorimi i rrjetit social gjatë orës së mësimi pengon zhvillimin e rregullt të orës mësimore.



Në bazë të gjinive del që 76% e nxënësve nuk kontrollojnë profilin e tyre në facebook përderisa 52% e nxënësve meshkuj deklarojnë që asnjëherë nuk e hapin faqen e facebook gjatë orës së mësimi. Duke krahasuar këto të dhëna me përqindjen e përgjithshme del që 24% e femrave kontrollojnë facebook-un gjatë orës së mësimi, gjersa 48% e meshkujve kontrollojnë profilin në facebook.

Për të rumbullakësuar këto të dhëna përfundimisht del që nxënësit turq kontrollojnë profilin tyre në facebook më shumë nga nxënësit e tjerë edhe atë 55% që është më shumë se gjysma, më pastaj shqiptarët me gjithsej 40% si dhe maqedonasit me një paraqitje prej gjithsej 29%. Ndërsa në bazë të gjinive del që 24% e femrave kontrollojnë facebook-un gjatë orës së mësimi, gjersa 48% e meshkujve kontrollojnë profilin e facebook-ut gjithashtu gjatë orës së mësimi.

11. Fotografive të meshkujve u bëj më tepër komente se femrave dhe e kundërta?

Ethn.	a) po, është e vërtetë	b) jo nuk është e vërtetë	c) të dy gjinive njëloj	d) tjetër
Alb	33	46	75	3
Mac	1	7	15	0
Tr	23	15	19	0
Total	57	68	109	3

Tabela 15: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të komenteve që u bëhet të dy gjinive në rrjetin social (shpërndarja e përqindjes në bazë të etnive).


Në tabelën 15 është bërë përshkrimi i të dhënave në bazë të komenteve që u bëjnë gjinive. Cilave gjini të tri etnitete u bëjnë më shumë komente? Nga të dhënat e përgjithshme del që pjesa më e madhe e shqiptarëve u bëjnë komente ose meshkujve më tepër ose femrave, përderisa më pak se gjysma të dy gjinive njëjloj. Nxënësit maqedonas janë deklaruar duke thënë që më shumë se gjysma e tyre u bëjnë njëjloj komente të dy gjinive. Për dallim nga ata nxënësit turq janë deklaruar duke rrethuar që gjinive në mes veti u bëjnë më shumë komente nga të dy gjinive njëjloj.

11. Fotografive të meshkujve u bëj më tepër komente se femrave dhe e kundërta?

Gend	a) po, është e vërtetë	b) jo nuk është e vërtetë	c) të dy gjinive njëjloj	d) tjetër
Fem	7	38	43	1
Mal	50	30	66	2
Total	57	68	109	3


Tabela 15: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të komenteve që u bëhet të dy gjinive në rrjetin social (shpërndarja e përqindjes në bazë të gjinive).

Në bazë të dhënave mbi shkrimin e komenteve në rrjetin social në bazë të gjinive del që gjysma e femrave janë përgjigjur duke thënë që komente u bëjnë njëjloj edhe meshkujve edhe femrave, përderisa meshkujt janë deklaruar duke rrethuar që të dy gjinive u japin komente veçmas jo të dy gjinive njëjloj.



Në bazë të përqindjeve del që 50% e meshkujve u bëjnë më shumë komente gjinive varësisht gjinisë që ata i përkasin dhe 47% të dy gjinive njëloj për dallim nga maqedonasit të culet deklarohen që 63% e tyre u bëjnë komente të dy gjinive njëloj dhe 33% e tyre vetëm njërës apo tjetrës gjini. Turqit deklarojnë që pjesa më e madhe e tyre u bëjnë komente të tjerëve varësisht gjinisë edhe atë 64% e tyre dhe 32% e turqve u bëjnë komente të dy gjinive njëloj.

Përfundimisht Maqedonasit u bëjnë më shumë komente të dy gjinive njëloj edhe atë 63% e tyre, ndërsa turqit gjinive ndryshe varësisht gjinisë që ata i përkasin edhe atë 64% e tyre.



Në bazë të shpërndarjes së gjinive dhe komenteve që ata bëjnë del që 52% e femrave u bëjnë komente të dy gjinive njëloj dhe vetëm 48% e tyre gjinive ndaras, varësisht gjinive që ata i përkasin për dallim nga meshkujt të cilët deklarojnë që 53% e tyre u bëjnë më shumë komente gjinive varësisht gjinisë që ata kanë dhe 43% e tyre të dy gjinive njëloj.

Përfundimisht Maqedonasit u bëjnë më shumë komente të dy gjinive njëloj edhe atë 63% e tyre, ndërsa turqit gjinive ndryshe varësisht gjinisë që ata i përkasin edhe atë 64% e tyre. Femrat u bëjnë të dy gjinive njëloj komente edhe atë 52% e tyre ndërsa meshkujt gjinive varësisht gjinisë që ato kanë edhe atë 53% e tyre.

12. Komentet në facebook që ua bëj shokëve apo shoqeve janë?

Ethn	a) më të shkurtra se 1 fjali	b) 2 fjali	c) më shumë se 2 fjali
Alb	50	48	59
Mac	15	6	2
Tr	12	19	26
Total	77	73	87

Tabela 16: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të sasisë së komenteve që u bëhen në facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të etnive).


Tabela 16 përmban sasisë e komenteve që nxënësit njëri tjetrit. Me këtë rast rezultatet japin të dhëna në qoftë se meshkujt apo femrat bëjnë më shumë komente dhe cilat nga etnitë shkruajnë komente më të gjata. Nga të dhënat shihet që pjesa më e madhe e shqiptarëve bëjnë komente dy dhe më të gjata se dy fjali. Nga ana tjetër pjesa më e madhe e maqedonasit bëjnë komente më të shkurtra se 1 fjali. Tek turqit vlen e njëjta si me shqiptarët, shumica e tyre bëjnë komente dy apo më të gjata se dy fjali.

12. Komentet në facebook që ua bëj shokëve apo shoqeve janë?

Gend	a) më të shkurtra se 1 fjali	b) 2 fjali	c) më shumë se 2 fjali
Fem	33	28	28
Mal	44	45	59
Total	77	73	87


Tabela 16: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të sasisë së komenteve që u bëhen në facebook (shpërndarja e përqindjes në bazë të gjinive).

Duke krahasuar këto të dhëna në bazë të gjinive del që femrat shkruajnë më shumë komente me nga dy apo më tepër se dy fjali. E njëjta gjë shfaqet edhe me nxënësit meshkuj të cilët gjithashtu janë më në përqindje ata të cilët bëjnë komente më të gjata se dy fjali.



Nga të dhënat në përqindje del që 66% e nxënësve shqiptarë bëjnë komente më të gjata se 2 fjali, 31% e tyre nga një fjali. Tek nxënësit maqedonas del që 60% e tyre bëjnë komente me nga një fjali dhe 20% e tyre më të gjata se dy fjali. Tek nxënësit turq del që 72% e tyre bëjnë komente prej më të gjata se dy fjali përderisa 20% më të shkurtra se nga një fjali.

Nga këtu del që nxënësit turq shkruajnë fjali më të shkurtra nga nxënësit e tjerë edhe atë 20% e tyre. Përderisa fjali më të gjata shkruajnë turqit me 72%, më pastaj shqiptarët edhe atë 66% e tyre dhe në fund maqedonasit me gjithsej 33% e tyre.



Në figurën 16 përshkruhet shkrimi i komenteve në facebook në bazë të gjinive me ç'rast, 60% e femrave bëjnë komente më të gjata se 2 fjali përderisa 38% e tyre me nga 1 fjali. Ndërsa tek meshkujt del që 67% e tyre bëjnë komente me nga 2 fjali e më tepër dhe 39% e tyre komente me nga një fjali.

Nga këtu del që 60% e femrave bëjnë komente më të gjata se dy fjali dhe 38% e meshkujve komente me nga një fjali.

13. Kam frikë të eci natën vetë nëpër rrugë? ¹⁵			
Ethn.	a) shumë e vërtetë	b) aspak e vërtetë	c) mesatarisht e vërtetë
Alb	49	79	29
Mac	8	7	8
Tr	14	30	13
Total	71	116	50

Tabela 17: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të sjelljeve që bëjnë pas përdorimit të tepërt të rrjetit social (shpërndarja e përqindjes në bazë të etnive).


Nga të dhënat e përgjithshme del që pjesa më e madhe e nxënësve shqiptarë nuk kanë frikë të ecin natën vetë. Përderisa nxënësit maqedonas kanë frikë të ecin vetë natën nëpër rrugë. Tek turqit kemi një shpërndarje gati se të barabartë.

13. Kam frikë të eci natën vetë nëpër rrugë?			
Gend	a) shumë e vërtetë	b) aspak e vërtetë	c) mesatarisht e vërtetë
Fem	52	12	25
Mal	19	104	25
Total	71	116	50

Tabela 17: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të sjelljeve që bëjnë pas përdorimit të tepërt të rrjetit social (shpërndarja e përqindjes në bazë të gjinive).


Duke krahasuar këto të dhëna në bazë të gjinive del që shumica e femrave kanë frikë të ecin natën nëpër rrugë përderisa shumica e meshkujve nuk deklarojnë të njëjtën. Numri më i madh i meshkujve nuk kanë frikë të ecin natën vetë nëpër rrugë.

¹⁵ Pyetja mbi frikën qëndron si rrjedhojë e teorisë së Kultivimit të studiuesit Goerge Gerbner e cila u përshkrua në pjesën e analizës teorike.



Në figurën 17 është bërë kalkulimi në përqindje I nxënësve të shkollave fillore në Gostivar përdorimi I tepërt I facebook ndikon në ndryshimin e sjelljes së tyre. Nga këtu shohim që 50% e nxënësve shqiptarë deklarojnë që nuk kanë frikë të ecin vetë natën nëpër rrugë. Ndërsa përqindja e atyre që kanë frikë të ecin vetë nëpër rrugë është 48%. Nga ana tjetër shohim që 60% e nxënësve maqedonas deklarojnë që kanë frikë të ecin natën nëpër rrugë përderisa 20% e tyre jo, nuk kanë frikë. Tek nxënësit turq kemi një paraqitje pak a shumë të njëjtë më ç ‘rast del që 48% e nxënësve turq nuk kanë frikë të ecin nëpër rrugë dhe 40% e tyre po kanë frikë të ecin nëpër rrugë.

Nga këtu del që maqedonas kanë frikë të ecin natën vetë nëpër rrugë edhe atë 60% e tyre, përderisa 50% e shqiptarëve nuk kanë frikë të ecin natën vetë nëpër rrugë. Turqit nga ana tjetër janë gjysmë për gjysmë.



Nga të dhënat në bazë të gjinive del që 91% e nxënësve femra kanë frikë të ecin natën vetë nëpër rrugë përderisa 8% e tyre nuk kanë frikë. 69% e meshkujve nuk kanë frikë të ecin vetë nëpër rrugë përderisa 29% e tyre kanë frikë të ecin vetë nëpër rrugë.

91% e femrave frikohen të ecin vetë nëpër rrugë përderisa 69% e meshkujve nuk frikohen të ecin vetë nëpër rrugë.

14. Facebook është humbje kohe për mua! Sa e identifikoni veten me këtë shprehje?

Ethn	a) aspak	b) shumë pak	c) mesatarisht	d) tërësisht
Alb	31	51	45	30
Mac	5	17	1	0
Tr	27	14	12	4
Total	63	82	58	34

Tabela 18: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të kohës së tepërt që kalojnë në facebook dhe varshmërisë së sajë (shpërndarja e përqindjes në bazë të etnive).


Në tabelën 18 jepen të dhëna më të detajuara në lidhje me qëndrimin e nxënësve në lidhje me kohën që kalojnë përpara kompjuterit më saktësisht facebook-ut a është apo jo humbe kohe facebook për ta. Nga të dhënat e përgjithshme del që pjesa më e madhe e shqiptarëve mendojnë që po facebook është humbje kohe për ta, përderisa vetëm një pjesë e tyre pohojnë që jo aspak. Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e maqedonasve mendojnë që facebook është humbje kohe dhe vetëm disa nga ato nuk mendojnë që facebook është humbje kohe. Tek turqit kemi një shpërndarje të njëjtë të përqindjes më ç ‘rast, gjysma e tyre mendojnë që facebook është humbje kohe dhe po aq mendojnë që nuk është humbje kohe.

14. Facebook është humbje kohe për mua! Sa e identifikoni veten më këtë shprehje?

Gend	a) aspak	b) shumë pak	c) mesatarisht	d) tërësisht
Fem	20	37	21	11
Mal	43	45	37	23
Total	63	82	58	34


Tabela 18: Paraqitja e pjesëmarrësve në bazë të kohës së tepërt që kalojnë në facebook dhe varshmërisë së sajë (shpërndarja e përqindjes në bazë të gjinive).

Duke krahasuar të dhënat në bazë të gjinive del që pjesa më e madhe e femrave dhe meshkujve deklarojnë që facebook është humbje kohe përderisa një përqindje jo shumë e madhe tyre deklarojnë që facebook nuk është aspak humbje kohe.



Nga të dhënat e përgjithshme del që 77% e shqiptarëve mendojnë që po facebook është humbje kohe për ta, përderisa vetëm 19% e tyre jo aspak. Nga ana tjetër, 70% e maqedonasve mendojnë që facebook është humbje kohe dhe vetëm 20% e tyre nuk mendojnë që facebook është humbje kohe. 44% e tyre mendojnë që facebook është humbje kohe dhe po aq 44% mendojnë që nuk është humbje kohe.

Nga këtu del që pjesa më e madhe e nxënësve turq mendojnë që facebook nuk është humbje kohe edhe atë 44% e tyre përderisa 77% e nxënësve shqiptarë mendojnë që facebook është humbje kohe.



Për sa i përket të dhënave në bazë të gjinive del që pjesa më e madhe e femrave, 70% mendojnë që facebook është humbje kohe për to derisa 23% e tyre nuk mendojnë që facebook është humbje kohe. Për dallim nga femrat, 67% e meshkujve mendojnë që facebook është humbje kohe përderisa 29% e tyre mendojnë të kundërtën që facebook nuk është humbje kohe për ta.

Nga këtu del që 70% e femrave pohojnë që facebook është humbje për ta dhe 29% e meshkujve mendojnë që nuk është humbje kohe për ta.

II. Rishikimi i analizës së të dhënave-rezultatet

Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, gjithsej 237, shqiptarë janë 157 ose përafërsisht 66 %. Numri i përgjithshëm i nxënësve maqedonas është 23 ose ndryshe 9 %, ndërsa numri i nxënësve turq 57 dhe në përqindje 23 %.

Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve shqiptarë meshkuj janë 107 ose 45.14 %, ndërsa femra 50 ose 21.09%, maqedonas 7 ose 2.95% dhe femra 16 ose 6.75% ndërsa turq ka pasur gjithsej 34 ose 14.34% dhe femra 23 apo 9.70%.

Duke analizuar të dhënat e përgjithshme nga të anketuarit mund të vërehet lehtë që përqindja më e madhe e tyre ka qenë e nxënësve shqiptar edhe atë gjithsej 66% ndërsa për sa i përket gjinive ajo e meshkujve me afërsisht 45% nga pjesëmarrja e përgjithshme e të anketuarve.

Numri i të anketuarve shqiptarë ka qenë në përqindje më të madhe me gjithsej 66% më pastaj e turqve me gjithsej 24% dhe më pak në numër kanë qenë maqedonasit me gjithsej 10%.

Përqindja më e madhe e pjesëmarrësve është e nxënësve shqiptarë të klasës së gjashtë dhe të tetë me afërsisht 30 dhe 25%, më pastaj e nxënësve turq të klasës së tetë me afërsisht 17 %. Ajo që bie në sy është pjesëmarrja e nxënësve maqedonas edhe pse pak në numër por, nga të katër klasat e mundshme edhe atë: 1% e nxënësve të klasës së pestë, 2% e nxënësve të klasës së gjashtë, 3% e klasës së shtatë si dhe 2% e atyre të klasës së tetë.

Analizuar në tërësi nxënës pjesëmarrës me më në numër kanë qenë nxënësit e shkollës fillore Ismail Qemali me gjithsej 30% shqiptarë ndërsa përqindje më të vogël kanë pas nxënësit maqedonas të shkollës Vëllazërim bashkimi duke mos përfshirë aspak përqindjen që është në 0 e disa shkollave ku nuk ka paralel në ato gjuhë siç është rasti i paraleleve maqedonase në shkollën Ismail Qemali apo turke në Goce Dellçev.

Nga pyetja e parë e cila i vë theks të veçantë periudhës kohore se kur kanë hapur profilin e tyre në facebook nxënësit e shkollave fillore në Gostivar, mund të vërehet që përqindja më e madhe e të anketuarve shqiptarë, turq apo maqedonas kanë hapur profil përpara 1-2 viteve edhe atë 53% e tyre që do të thotë mbi gjysma e tërësisë së përgjithshme.

Pyetja e parë dëshmon që meshkujt hapin veten më parë nga femrat ndërsa për sa i përket etnive, turqit e hapin veten më tepër se shqiptaret dhe maqedonasit. Duke krahasuar pjesëmarrjen e etnive nga përqindja e përgjithshme del që 72% e turqve kanë hapur facebook disa vite më parë dhe 70% e maqedonasve dhe shqiptarëve po në këtë periudhë kohore.

Në pyetjen se sa kohë përdorin rrjetin social facebook, del që 65 % e shqiptarëve përdorin rrjetin social fb¹⁶ 2 dhe më pak se dy orë dhe po të njëjtit, 31% e tyre përdorin këtë rrjet mbi 2 orë. Për sa i përket shpërndarjes në bazë të gjinive, meshkujt në krahasim me femrat përdorin facebook më tepër se 2 orë edhe atë 38% ndërsa femrat janë më në përqindje për sa i përket shfrytëzimit të facebook për periudhë prej 2 dhe më pak se 2 orë. Ndryshe thënë ky kalkulim në përqindje del afërsisht 85 %.

Duke analizuar të gjithë etnitë dhe pjesëmarrje e tyre në bazë të përqindjes së përgjithshme del që gjysma e nxënësve shqiptarë hapin profil në facebook për shoqërim gjersa përqindja më e vogël e tyre, 1.5% hapin facebook për kureshtje. Pjesa më e madhe e maqedonasve hapin profil në facebook për shoqërim 80% e tyre dhe asnjëri nga ata nuk konsulton facebook për mësim apo për të kaluar kohën. 40% e nxënësve turq hapin profil për shoqërim gjersa asnjëri nga ato nuk ka profil për mësim. Përfundimisht nxënësit maqedonas përdorin facebook-un për shoqërim, gjysma e nxënësve shqiptarë përdorin facebook për zbavitje, dhe asnjëri nga nxënësit maqedonas dhe turq nuk përdorin rrjetin social për mësim. Për dallim nga etnitë, afërsisht 53% e femrave kanë hapur profil në facebook për shoqërim ndërsa pjesa më e vogël, 4% për

¹⁶ FB është shkurtesë e cila identifikon facebook-un apo rrjetin social bashkëkohor.

mësim. Në krahasim prej meshkujve të cilët pohojnë që kanë hapur profil për zbavitje edhe atë 55% e tyre dhe pjesa më e vogël prej 4% për mësim.

Duke krahasuar këto të dhëna mund të përfundojmë që nxënësit më të hapur janë maqedonasit, dhe të gjithë nga ata kanë të regjistruar në profil mbi 50 miq, më pastaj turqit më një përqindje prej 15% dhe më në fund shqiptarët të cilët paraqiten me një përqindje prej 20%.

Përfundimisht në bazë të shpërndarjes së të dhënave në përqindje mund të themi që meshkujt janë më të hapur se femrat me ç ‘rast dallimi në përqindje është afërsisht 15% meshkujt janë më të hapur se femrat për të krijuar miq në rrjetin social facebook.

Duke krahasuar të gjithë pjesëmarrësit del që nxënësit maqedonas në pjesëmarrje absolutë përdorin facebook në shtëpi, me pastaj shqiptaret me një përqindje prej 87% dhe në fund turqit me një pjesëmarrje prej 77%. Ndërsa për sa i përket përdorimit të rrjetit në shkollë, më tepër në përqindje janë turqit me një përqindje prej 5%, shumë afër shqiptarët edhe atë 4% e tyre ndërsa maqedonasit nuk përdorin rrjetin social aspak në shkollë. Tek meshkujt del që 81% e tyre përdorin rrjetin social në shtëpi dhe 6% e tyre në shkollë.

Pjesa më e madhe e shqiptarëve edhe atë 50 % e tyre mendojnë që facebook u pengon në kryerjen e obligimeve të tyre dhe 37% mendojnë që nuk u pengon. Tek maqedonasit, pjesa më e madhe mendojnë që nuk u pengon edhe atë 54% e tyre, ndërsa vetëm 42% e tyre mendojnë që facebook ndoshta u pengon në kryerjen e obligimeve të tyre. Tek nxënësit turq kemi një përqindje prej 45% që mendojnë po dhe ndoshta mund tu pengojnë rrjeti social facebook në kryerjen e obligimeve të tyre dhe 43% e tyre nuk mendojnë që facebook ju pengon për kryerjen e obligimeve të tyre. 54% e femrave mendojnë që facebook ju pengona tyre në kryerjen obligimeve dhe 42% deklarohen që nuk u pengon rrjeti social në kryerjen e obligimeve të tyre. Përderisa tek meshkujt, 44% mendojnë që facebook nuk u pengon atyre për të kryer obligimet dhe 48% u pengon atyre.

Gjysma e nxënësve shqiptarë 50% deklarojnë që facebook ju pengon në kryerjen e obligimeve të tyre, mbi gjysma, 54% e nxënësve maqedonas nuk mendon që facebook ju pengon.

Pjesa më e madhe e meshkujve dhe femrave mendojnë që facebook ju pengon në kryerjen e obligimeve edhe atë 54% femra dhe 48% meshkuj.

Nxënësit maqedonas janë më të hapur në publikim të fotografive në krahasim me nxënësit e tjerë edhe atë, maqedonasit kanë më tepër se 100 fotografi të publikuara në facebook 29% e tyre, më pastaj turqit me gjithsejtë 21% dhe shqiptarët me gjithsej 19%. Nga ana tjetër vërehet lehtë që meshkujt kanë më tepër se 100 fotografi të publikuara në facebook edhe atë 22% e tyre ndërsa vetëm 6%e femrave kanë mbi 100 foto të publikuara në profilin e tyre.

Pjesa më e madhe e nxënësve shqiptarë 37% e tyre kanë të publikuara foto provokative në rrjetin social më pastaj nxënësit maqedonas më nj pjesëmarrje prej gjithsej, 12% si dhe nxënësit turq më gjithsej

9%. 34% e meshkujve kanë të publikuara fotografi provokative në profilin tyre përderisa, vetëm 5% e femrave kanë foto të tilla në profil.

Për sa i përket komenteve që bëjnë përdoruesit e rrjetit social mund të themi që nxënësit maqedonas u shkruajnë më shumë komente miqve dhe familjarëve të tyre 100%, më pastaj nxënësit turq me gjithsej 97% si dhe shqiptarët me një përqindje prej 94%. Në aspekt të gjinive del që 94% e femrave u bëjnë komente në facebook, miqve familjarëve të tyre si dhe 96% e meshkujve.

Nxënësit turq kontrollojnë profilin tyre në facebook më shumë nga nxënësit e tjerë edhe atë 55% që është më shumë se gjysma, dhe kjo gjë sipas meje nuk është aspak mirë. Më pastaj shqiptarët me gjithsej 40% si dhe maqedonasit me një paraqitje prej gjithsej 29%. Asnjëra nga këto përqindjet nuk është e kënaqshme pasi që përdorimi i rrjetit social gjatë orës së mësimi pengon zhvillimin e rregullt të orës mësimore.

Për të rrumbullakësuar këto të dhëna nxënësit turq kontrollojnë profilin tyre në facebook më shumë nga nxënësit e tjerë edhe atë 55% që është më shumë se gjysma, më pastaj shqiptarët me gjithsej 40% si dhe maqedonasit me një paraqitje prej gjithsej 29%. Ndërsa në bazë të gjinive del që 24% e femrave kontrollojnë facebook-un gjatë orës së mësimi, gjersa 48% e meshkujve kontrollojnë profilin e facebook-ut gjithashtu gjatë orës së mësimi.

Maqedonasit u bëjnë më shumë komente të dy gjinive njëlloj edhe atë 63% e tyre, ndërsa turqit gjinive ndryshe varësisht gjinisë që ata i përkasin edhe atë 64% e tyre. Femrat u bëjnë të dy gjinive njëlloj komente edhe atë 52% e tyre ndërsa meshkujt gjinive varësisht gjinisë që ato kanë edhe atë 53% e tyre.

Nxënësit turq shkruajnë fjali më të shkurtra nga nxënësit e tjerë edhe atë 20% e tyre. Përderisa fali më të gjata shkruajnë turqit me 72%, më pastaj shqiptarët edhe atë 66% e tyre dhe në fund maqedonasit me gjithsej 33% e tyre. 60% e femrave bëjnë komente më të gjata se dy fjali dhe 38% e meshkujve komente me nga një fjali.

Nxënësit maqedonas kanë frikë të ecin natën vetë nëpër rrugë edhe atë 60% e tyre, përderisa 50% e shqiptarëve nuk kanë frikë të ecin natën vetë nëpër rrugë. Turqit nga ana tjetër janë gjysmë për gjysmë. 91% e femrave frikohen të ecin vetë nëpër rrugë përderisa 69% e meshkujve nuk frikohen të ecin vetë nëpër rrugë.

Pjesa më e madhe e nxënësve turq mendojnë që facebook nuk është humbje kohe edhe atë 44% e tyre përderisa 77% e nxënësve shqiptarë mendojnë që facebook është humbje kohe. 70% e femrave pohojnë që facebook është humbje për ta dhe 29% e meshkujve mendojnë që nuk është humbje kohe për ta.

10.1 Krahasimi i të dhënave teorike dhe rezultateve të nxjerra në terren

Duke krahasuar të dhanë teorike dhe përfundimet e argumentuara kemi disa qëndrime, pro dhe kundër. Nga ajo që u tha paraprakisht, studiues të ndryshëm kanë qëndrime të ndryshme për sa i përket këtyre çështjeve edhe atë:

Argumentet pro

- Përdorimi i gjuhës dhe gjinitë

Femrat janë ata të cilat gjatë komunikimit në CMC¹⁷ përdorin forma të tjera përderisa komunikojnë me femrat dhe, meshkujt janë ata të cilët përdorin formë komplet tjetër përderisa komunikojnë me meshkujt Savicki (2000).

Sipas qëndrimit tim në temë del që meshkujt dhe femrat në facebook janë ata të cilët përdorin forma të njëjta të komunikimit në kuptim të promovimit të vetes, paraqitjes së mesazheve, fotografive si dhe dhënies së informatave personale.

Ndoshta ka një kuptim të tillë në dhënien e komenteve të fotografive shembull apo videove që prezantohen aty meshkujve dhe femrave. Sigurisht që kjo formë e komunikimit nuk është e njëjtë kur epen komente femrave dhe e kundërta kur meshkujt komentojnë për njëri tjetrin. Është ky një përfundim që definitivisht jep të dhëna mbi hapjen e vetes.

Një thënie mbi këtë çështje qëndron: “Femrat kanë komunikimin e vet në mes veti”. Mjafton të jesh femër dhe e kupton autorin. Unë vërtetoj që kjo gjë është e vërtetë. Jo vetëm tek fotografitë por, edhe tek informatat e veta personale, ndryshe thënë profili i tyre, duket që gati se të gjitha femrat janë fans të nënave të tyre, baballarëve, artistëve gati se të njëjtat, komentet janë gati se të njëjta sikur shabllon, pa ndonjë individualizëm. Në asnjërën nga analizat që unë pashë të të anketuarve nuk ishte ndonjë koment komplet i ndryshëm nga ajo veç më e para gjer më tani. Ajo formalja dhe e njëjta.

Nga ana tjetër po të krahasojmë të dhënat e përgjithshme del që maqedonasit u bëjnë më shumë komente të dy gjinive njëloj edhe atë 63% e tyre. Duke krahasuar të dhënat në bazë të gjinive del që meshkujt u shkruajnë komente gjinive varësisht gjinisë që ato kanë edhe atë 53% e tyre. Nga këtu vijmë në përfundim që meshkujt dhe nxënësit maqedonas u bëjnë më shumë komente gjinive që ato i përkasin qoftë meshkuj apo femra.

- Konsistenca kognitive përballë bisedave kundër argumentuese

¹⁷ CSM është shkurtesë e lëndës Computer Mediated Communication apo Komunikimi i Ndërmjetësuar me Kompjuter.

Meshkujt janë ata të cilët janë më tepër të paraprirë të bëjnë kontribute autoritative dhe të shprehin mos pajtueshmëri përderisa femrat janë ata të cilat paraprinë të shprehin pajtueshmëri ndaj tjerëve Guiller & Durndell (2006).

Edhe ky përfundim shpreh idenë që meshkujt janë më të paraprirë për të paraqitur veten si “dominant” përderisa femrat janë ata të cilat shprehin veten në nivel më të ulët duke u pajtuar për vendimet apo qëndrimet që ka shprehur dikush tjetër. Paraprakisht në përfundimin e studiuesve të tjerë thash që femrat janë ata të cilat japin përfundime dhe qëndrime të njëjta përderisa tek meshkujt vërehet pak a shumë një individualizëm.

- Pseudonimi përballë zbulimi i vetes

Femrat janë ata të cilat tentojnë të fshehin veten nëpërmes pseudonimeve përderisa meshkujt janë at të cilët paraqesin emrat e vetë të vërtetë Lee & Oshagan (1998).

Është kjo një dukuri e hapjes së vetes. Ky në fakt është një argument i kundërt i qëndrimit tim. Faktikisht në këtë rast, meshkujt janë ata që hapin veten më tepër nga femrat. Dhe nga ajo që unë pash, rrash në përfundim që kishte disa nga femrat që kishin shumë pak të ekspozuara fotografi të tyre. Nga ana tjetër kishte edhe disa nga ata që paraqiten me emra të rrejshëm apo dhe fotografi jo të tyre. Interesant kjo gjë, këtu vërehet që meshkujt hapin më tepër veten nga femrat.

Nxënësit maqedonas janë më të hapur në publikim të fotografive në krahasim me nxënësit e tjerë edhe atë, maqedonasit kanë më tepër se 100 fotografi të publikuara në facebook 29% e tyre. Nga ana tjetër në bazë të gjinive del që meshkujt kanë më tepër se 100 fotografi të publikuara në facebook.

Në pyetjen rreth fotografive provokative që kanë të publikuara në profil del që pjesa më e madhe e nxënësve shqiptarë 37% kanë të publikuara foto provokative në rrjetin social për dallim nga etnitë e tjera të cilët kanë më pak foto nga këto. Në krahasim me etnitë, për sa i përket gjinive, rrjedh që 34% e meshkujve kanë të publikuara fotografi provokative në profilin tyre përderisa femrat shumë pak gati aspak.

Analizuar argumentin dhe praktikën shohim që meshkujt dhe maqedonasit e shqiptarët kanë më tepër foto të publikuara në rrjetin e tyre social.

- Promovimi i vetes përballë mbylljes së vetes

Nga ana tjetër, studiuesi Lee, mbi analizën e përbormit të gjuhëve që gjinitë shfrytëzojnë gjatë komunikimit nëpër CMC, thuhet që meshkujt dinë të pozicionohen duke bërë promovim të vetes, sarkazëm, ofendime dhe pohim përderisa femrat janë ata të cilat parapëlqejnë mesazhe të cilat paraqesin përkrahje dhe orientim personal Lee (2007).

Në këtë artikull më pëlqeu analiza e mesazheve të përmbajtjes me ç'rast del që meshkujt janë ata që dëshirojnë të promovojnë veten ndërsa femrat janë ata të cilat vetëm përkrahin atë që është thënë më parë. Këtu sikur qëndrimi im apo tema të cilën unë e prezantoj paraqet të kundërtën e qëndrimit tim.

Edhe nga analiza e gjërave që unë pash të individëve të anketuar del që vërtetë femrat janë ata të cilat gati se gjatë tërë kohës paraprihen të japin komente siç janë: shumë bukur dukesh, edhe unë mendoj ashtu, edhe unë pajtohem me X personin që je fenomenale, fustanin e kishe shumë të bukur, vërtetë fustani ishte fantazi.....

Përderisa meshkujt janë ata të cilët gjatë tërë kohës vetëm shprehin të kundërtën e asaj që mendojnë, katastrofë dukesh, çarë deshe të thuash më ketë fotografi, me cinizëm, e kështu me radhë.

Nga analizat e bëra në terren del që fjali më të gjata shkruajnë turqit me gjithsej 72% ndërsa për sa u përket gjinive, femrat janë ata të cilat shkruajnë komente më të gjata apo flasin më tepër edhe atë 60% e femrave bëjnë komente më të gjata se dy fjali dhe 38% e meshkujve bëjnë komente me nga një fjali.

- Komunikimi i argumentuar përballë komunikimi i ndërtuar mbi marrëdhënie

Meshkujt janë ata të cilët parapëlqejnë të komunikojnë për objektet siç janë veturat dhe kompjuterët si dhe për evenimentet e jashtme siç janë politika dhe sporti Herring (2006).

Edhe këto janë të dhëna të cilat shprehin natyrën e hapur të meshkujve me ç'rast ata janë të paraprirë të hapin veten duke folur apo komunikuar tërë kohën për gjëra shumë të shpeshta, zakonshme që atyre ju interesojnë siç janë temat mbi politikën, veturat dhe kështu me radhë.

Edhe në facebook duket që meshkujt janë ata që gati se tërë kohën promovojnë foto, video, gjëra të lidhura e këto tema qoftë sporti, qoftë veturat. Ide të njëjta promovohen edhe në teori të tjera të komunikimit siç është ajo e gjinive. Aty dihet që meshkujt apriori parapëlqejnë të analizojnë gjëra mbi veturat, politikën dhe sportin përderisa femrat janë të paraprirë të flasin mbi shopping-un dhe makijazhin.

Duke mbështetur këto qëndrime unë solla disa të dhëna edhe atë: nxënësit maqedonas u shkruajnë më shumë komente miqve dhe familjarëve të tyre edhe atë 100% e tyre. Nga ana tjetër, 96% e meshkujve u shkruajnë komente miqve apo familjarëve të tyre.

Këto të dhëna mbështesin faktin që nxënësit maqedonas dhe meshkujt janë më të paraprirë për marrëdhënie në krahasim me etnitë e tjera apo me femrat.

Po të marrim parasysh pyetjen tjetër e cila flet për arsyen se pse kanë hapur profil në facebook del që pjesa më e madhe e nxënësve maqedonas hapin profil për shoqërim edhe atë 80% e tyre. Për sa i përket gjinive, 53% e femrave deklarojnë që kanë hapur profil në facebook për shoqërim e njëjta vlen edhe për meshkujt me ç'rast 55% e meshkujve deklarojnë të njëjtën arsye.

Argumentet koftra

- Temat diskutuese të femrave dhe meshkujve

Sipas studiuesit Soukup (1998) në artikullin e tij mbi ndërveprimet e gjinive në CMC, meshkujt janë ata të cilët vrapojnë pas paraqitjes më të argumentuar nëpër “chatet” e ndryshme në internet, përderisa femrat parapëlqejnë krijim të raporteve-marrëdhënieve dhe intimitetit.

Nga ky paragraf mund të shohim që femrat janë ata gjini të cilat dëshirojnë të krijojnë lidhje intime përderisa meshkujt janë ata të cilët dëshirojnë të duken më të fuqishëm dhe me inde të argumentuara.

Ajo që lindën menjëherë në këtë dilemë është në qoftë se, ideja e lartshënuar është thjesht një stereotipizëm apo thjesht një gjë e vërtetë. Pas këtij përfundimi ajo që lind menjëherë është pyetja cila është ideja që i bën meshkujt më të argumentueshëm dhe femrat më pak të argumentueshme? Çka në fakt nënkuptojmë me krijimin e lidhjeve apo raporteve? Nga përfundimet e analizave të mia del që nxënësit maqedonas në profilin e tyre kanë të regjistruar mbi 50 miq, ndërsa për sa i përket gjinive sipas rezultateve, 15% meshkujt janë më të hapur se femrat për të krijuar miq në rrjetin social facebook. Do me thënë meshkujt janë më të paraprirë për të krijuar raporte dhe jo femrat.

Në çështjen e prezantimit të bisedave të argumentuara del që 50 % e shqiptarëve mendojnë që facebook u pengon në kryerjen e obligimeve të tyre, maqedonasit, pjesa më e madhe mendojnë që nuk u pengon edhe atë 54% e tyre. 54% e femrave mendojnë që facebook ju pengon atyre në kryerjen obligimeve. Qe del se femrat dhe shqiptarët janë më argumentues me qenë se mendojnë që facebook është humbje kohe për ta.

Edhe pse për sa i përket idesë së paraqitjes së argumentueshme, nuk mendoj që rrjeti facebook ka shumë hapësirë për krijim të përfundimeve kushedi sa të argumentueshme. Kjo nuk do të thotë që aty nuk qarkullojnë ide të argumentuara por, nuk mund të them që ka shumë hapësirë për sa i përket këtij drejtimi.

- Koha dhe vendi i zhvillimit të komunikimit

Njerëzit janë ata të cilët bëjnë vendime personalisht për veten e tyre kur dhe si do të hapin veten e tyre Walther, Heid, Kim, Westerman, Tong (2008). Kjo është një argument mbi atë se si do qoftë gjinia femërore apo mashkullore janë vetë ata persona që vendosin për veten e tyre kur dhe si do të hapin veten e tyre.

Kam përshtypjen që ideja mbi hapje në vetes ka të bëjë me atë individualen dhe kjo gjë është më se normale mirëpo nga ana tjetër edhe rrethi ndikon. Ti përderisa sheh që të tjerët tërë kohën promovojnë fotografi, video japin komente, normalisht që edhe ti do të duhet të jesh një nga ata. Kjo është edhe vetë ideja e facebook-ut. Vetë fakti që ti je pjesë e këtij rrjeti normalisht që t'i si i tillë nuk mund të sillesh apo të zbulosh rregulla që nuk janë të tilla dhe në pajtueshmëri me vetë rregullat e tij të përgjithshme. Nuk e di

në qoftë se rrjetet e këtilla lejojnë idenë e asaj që quhet individuale. Ky rrjet pak a shumë si të tjerat promovon idenë e unitetit dhe bashkësisë. Sërish mendoj që varet nga rregullat e lojës. Sipas meje këto rregulla janë më veç të caktuara ideja jote është të luash në bazë të atyre.

Këtë argument sërish do ta kisha ndërlidhur me dukurinë e përdorimit të facebook-ut dhe keqpërdorimit të tij. Vendi se ku përdoret facebook dhe si flet për kontrollin që ato kanë ndaj këtij rrejt. Në një pyetje të parashutuar nxënësi është dashur të japin përgjigje lokacionin gjegjësisht vendin se ku përdorin këtë rrjet. Sipas kësaj më vonë është parashtruar pyetja se a e përdorin facebook-un edhe gjatë orës së mësimi. Duke krahasuar të gjithë pjesëmarrësit del që nxënësit maqedonas në pjesëmarrje absolute përdorin facebook në shtëpi. Përderisa në shkollë, më tepër në përqindje janë turqit ata të cilët përdorin këtë rrjet me një përqindje prej 5%, shumë afër shqiptarët edhe atë 4% e tyre. Tek meshkujt del që 81% e tyre përdorin rrjetin social në shtëpi dhe 6% e tyre në shkollë. Kjo do me thënë që nxënësit nga të tri etnitë dhe gjinitë komunikojnë nëpërmes të rrjetit të njohur social në shtëpi dhe shumë pak në shkollë.

Duke krahasuar këtë të dhënë me përgjigjen tjetër del që, nxënësit turq kontrollojnë profilin tyre gjatë orës së mësimi më shumë nga nxënësit e tjerë edhe atë 55% e tyre. Për dallim nga ata tek gjinitë rrjedh që 48% e meshkujve kontrollojnë profilin e facebook-ut gjithashtu gjatë orës së mësimi. Kjo do të thotë që nxënësit vendosin vetë kur do e kontrollojnë profilin e tyre në facebook po qoftë edhe gjatë orës së mësimi.

- Aktiviteti meshkuj përballë femra

Meshkujt janë pjesëtarë më aktiv nëpër “chate” të ndryshme përderisa femrat janë më pak aktive Krivak (2008). Ky përfundim është një e dhënë konkrete mbi atë se kush hapën veten më tepër, meshkujt apo femrat dhe nga kjo e dhënë del që meshkujt janë më aktiv nga femrat.

Por nga na tjetër vazhdon duke thënë që edhe hapja e vetes dhe dhënia e informatave mbi veten e tyre dhe komentet mbi të tjerat varet nga edukimi i atij individi, prapavija kulturore, etnike religjioze dhe kështu me radhë.

Unë mendoj që personalisht kjo është një e dhënë shumë e rëndësishme pasi që në fakt ka shumë rëndësi në qoftë se dëshirojmë të analizojmë cila është prapavija kulturore e individit? Cili është arsimimi i tij, cilës përkatësi etnike i përket dhe kështu me radhë. Dhe me këtë rast është vështirë që të gjithë njerëzit të grupohen në të njëjtën grup.

Çështjen në fjalë do e kisha analizuar edhe me kohën të cilën nxënësit e shkollave fillore e kalojnë përpara rrjetit social komunikues. Nga analizat e bëra del që 65 % e shqiptarëve përdorin rrjetin social facebook 2 dhe më pak se dy orë. Meshkujt në krahasim me femrat përdorin facebook më tepër se 2 orë edhe atë 38%. Nga këtu shohim që meshkujt dhe shqiptarët janë më aktiv në kohën që ia kushtojnë rrjetit social komunikues.

Studiuesit e shkencave të komunikimit dhe informatikës elaborojnë disa çështje shumë thelbësore për sa u përket elementeve të theksuara paraprakisht.

Pikë e rëndësishme në këtë punim është ideja e patjetërsueshme dhe e nevojshme e qenieve sociale për të komunikuar ashtu siç thotë edhe vetë Paul Watzlawick në librin e tij *Pragmatics of human communication*: “*Ne nuk mund të mos komunikojmë*”.

Duke ndier nevojën e patjetërsueshme të individëve për të komunikuar, menjëherë pas kësaj na lindin disa çështje të tjera.

Po që se potencojmë idetë e studiuesve Altman dhe Taylor, do të shohim që ata i japin një rëndësi shumë të veçantë mënyrës së komunikimit që njerëzit bëjnë në mes veti. Ndër të tjera do të ndalem në pikat:

- Sipas studiuesve të dhënat periferike apo më të përgjithshme këmbehen më shumë dhe më shpejtë nga informatat private Altman, Taylor (121).

Po të analizohen bisedat e zakonshme që nxënësit e shkollave fillore në Gostivar bëjnë, do të vëreni që ato janë biseda të zakonshme, sipërfaqësore, duke i dhënë komplimente njëri tjetrit dhe të ngjashme. Përderisa të njëjtit publikojnë edhe shumë foto, video private të cilat shprehin raporte afërsie me miqtë që kanë të regjistruar në profil. Ndonëse këto të dhëna nuk shkruhen shpesh, ato shpalosen nëpërmes fotografive apo videove të ndryshme.

- Sipas studiuesit Jhon Stuart Mill, njerëzit shikojnë apo tentojnë t’i *maksimizojnë* principet e sjelljeve njerëzore dhe t’i *minimizojnë* kostot e tyre Altman, Taylor (123).

Natyra njerëzore funksion në atë mënyrë që njerëzit tërë kohës mundohen të marrin më shumë në krahasim me atë që japin. Njerëzit edhe në raport me të tjerët dëshirojnë të jenë fitimtarë. Krahasuar në komunikimin që të rinjtë zhvillojnë në rrjetin social do të shohim që në përgjithësi tentojnë të mbajnë raport të balancuar me ç’rast gjatë tërë kohës i komentojnë gjërave që të tjerët u kanë komentuar atyre, normalisht me përjashtime rastet kur një individ nuk parapëlqen të japë komente për gjëra të ndryshme.

Cila është mënyra e komunikimit që të rinjtë në Gostivar përdorin? Sa të rinjtë mbajnë llogari për të “hyrat” dhe “dalat” që ata krijojnë në shoqëri, janë fitimtarë apo humbës ata?

Po që se Deborah Tannen pohon që meshkujt dhe femrat janë një kulturë në vetë atëherë cila është kjo kulturë, a mësohet vështirë ajo, a duhet ta dijë çdo gjini atë? Sipas saj, biseda e meshkujve dhe femrave është komunikim ndërkulturor Tannen (470).

Nga ajo që thotë studiuesja Tannen mund të vërejmë që vërtetë gjinitë në përgjithësi kanë preferenca të ndryshme, qëndrime të ndryshme ndaj çështjeve dhe interesa të ndryshme. Thjesht vajzat parapëlqejnë të pozojnë përpara një vendi bregdetar, përderisa meshkujt afër një veture shumë të bukur apo edhe një motori.

Mënyra se si i shprehin mendimet, mënyra se si komunikojnë në mes veti normalisht që dallohet.

Nga ana tjetër në këtë rast vlen të përmendet fakti që të dy gjinitë, etnitë apo në përgjithësi përdoruesit e rrjetit social kanë krijuar simbole të përbashkëta, gjuhë të përbashkët, mënyrë komunikimi të përbashkët, mënyrë shpërndarjeje fotografive të njëjta, lojëra të njëjta dhe kjo gjë në fakt e homogjenizon audiencën. Ta thjeshtë funksionojnë si një fshat në vete apo edhe si një shtëpi e madhe në vete.

Dhe nga na tjetër në pyetjen se çka njerëzit zakonisht shikojnë në televizion Gerbner thotë “*dhunë*” Gerbner (385). Por, përpos dhunës, njerëzit fillojnë ta parafytyrojnë realitetin shoqëror ashtu siç prezantohet nëpër këto media Gerbner (386).

Si prezantohet realiteti shoqëror në facebook? Si ndikon ky realitete tek të rinjtë?

Psikologja e Universitetit të Kalifornisë-Los Angeles Joanna Lipari emëron facebook-un si një tokë të lumtur *happyland*, por a thua në të vërtetë kjo është toka e lumtur?

Është interesant të përmendet fakti që përdoruesit e rrjetit social gjatë tërë kohës publikojnë materiale me ç’rast të dy gjinitë apo të tre etnitë janë çdo herë të lumtur, të buzëqeshur, në deponim. A hua vallë bota të cilën ata e jetojnë është çdo herë e lumtur.

Kohë pas kohe këta nxënës publikojnë edhe informata që do kenë test të nesërmen, përsëritje, jam i shqetësuar dhe menjëherë pas kësaj, simbole të cilat shprehin lumturi, nuk kam brenga, gjithçka do të shkojnë mirë.

Po që se vërtetë vlej ajo që thotë Gerbner, atëherë të gjithë të rinjtë duhet të jenë në diskonim, dhe kjo nuk ndodh ashtu.

Nga ana tjetër studiuesi Gerben thotë që njerëzit të cilët shikojnë shumë televizion, dhe media jonë në këtë rast është rrejt social facebook, gjasat janë më të mëdha që të frikohen natën.

Nga pyetja mbi këtë çështje del që nxënësit maqedonas kanë frikë të ecin natën vetë nëpër rrugë edhe atë 60% e tyre, 91% e femrave frikohen të ecin vetë nëpër rrugë. Është e vërtetë që maqedonasit kalojnë një kohë të konsiderueshme përpara këtij rrjeti dhe normalisht shfaqin simptome të atilla por, femrat nuk janë dhe aq përdoruese të mëdha, sipas të vërtetës, meshkujt do të duhet të frikoheshin më shumë. Por, ndoshta edhe meshkujt janë turpëruar të tregojnë që vërtetë frikohen të ecin natën vetë.

Janë këto disa nga çështjet që të nxisin ide diskutabile në kokë para së gjithash përpara vetes dhe të tjerëve më pastaj. Nga ana tjetër, na preokupojnë të gjithëve, ne jemi pjesë e këtyre ngjarjeve dhe si të tilla nuk mund t’i anashkalojmë pa i vënë re.

Përfundimi

Duke ndjekur vazhden e zhvillimeve në këtë punim nëpërmes të disa pikave të shkurtra do të përmbledhje idetë më relevante dhe përfundimet e nxjerra në praktikë.

Përsëri nisemi nga fakti që qeniet njerëzore ndiejnë nevojën për të komunikuar. Dhe ky proces si i tillë mund të zhvillohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Rrjeti social facebook ka zbatuar botën, ndërsa studimi im fokusohet në mënyrën e komunikimit që të rinjtë e qytetit të Gostivarit zhvillon ë aty.

Është interesant të përmendet fakti që disa nga idetë teorike i kundërshton praktika dhe disa të tjera i mbështet po e njëjta.

Pikërisht ky punim sjell në vete këto përfundime dhe këtë shumësi laramanishë.

Studiuesit Altman dhe Taylor, i japin një rëndësi shumë të veçantë mënyrës së komunikimit që njerëzit bëjnë në mes veti. Bisedat e nxënësve të shkollave fillore në Gostivar janë biseda të zakonshme, sipërfaqësore, duke i dhënë komplimente njëri tjetrit dhe të ngjashme. Përderisa të njëjtit publikojnë edhe shumë foto, video private të cilat shprehin raporte afërsie me miqtë që kanë të regjistruar në profil.

Të rinjtë tentojnë të mbajnë raport të balancuara me ç'rast gjatë tërë kohës i komentojnë gjërave që të tjerët u kanë komentuar atyre, normalisht me përjashtime rastet kur një individ nuk parapëlqen të japë komente për gjëra të ndryshme.

Nga ana tjetër në këtë rast vlen të përmendet fakti që të dy gjinitë, etnitë apo në përgjithësi përdoruesit e rrjetit social kanë krijuar simbole të përbashkëta, gjuhë të përbashkët, mënyrë komunikimi të përbashkët, mënyrë shpërndarjeje fotografive të njëjta, lojëra të njëjta dhe kjo gjë në fakt e homogjenizon audiencën. Ta thjeshtë funksionojnë si një fshat në vete apo edhe si një shtëpi e madhe në vete.

Si prezantohet realiteti shoqëror në facebook? Si ndikon ky realitete tek të rinjtë?

Psikologja Joanna Lipari emëron facebook-un si një tokë të lumtur *happyland*, por a thua në të vërtetë kjo është toka e lumtur?

Meshkuj dhe femrat

- Meshkujt dhe nxënësit maqedonas u bëjnë më shumë komente gjinive që ato i përkasin.
- Meshkujt janë më të paraprirë për të paraqitur veten si “dominant” përderisa femrat janë ata të cilat shprehin veten në nivel më të ulët duke u pajtuar për vendimet apo qëndrimet që ka shprehur dikush tjetër.
- Meshkujt janë ata që dëshirojnë të promovojnë veten ndërsa femrat janë ata të cilat vetëm përkrahin atë që është thënë më parë femrat janë ata të cilat gati se gjatë tërë kohës

paraprihen të japin komente siç janë: shumë bukur dukesh, edhe unë mendoj ashtu, edhe unë pajtohem me X personin që je fenomenale, fustanin e kishe shumë të bukur, vërtetë fustani ishte fantazi.....

- Femrat janë ata të cilat japin përfundime dhe qëndrime të njëjta përdorisa tek meshkujt vërehet pak a shumë një individualizëm.

Shqiptarët, turqit dhe maqedonasit

- 37% e nxënësve shqiptarë kanë të publikuara foto provokative në rrjetin social për dallim nga etnitë e tjera të cilët kanë më pak foto nga këto. Në krahasim me etnitë, për sa i përket gjinive, rrjedh që 34% e meshkujve kanë të publikuara fotografi provokative në profilin tyre përdorisa femrat shumë pak gati aspak.
- Gjysma e shqiptarëve deklarojnë që facebook ju pengon në kryerjen e obligimeve, përdorisa pjesa më e madhe e maqedonasve mendojnë që nuk u pengon facebook.
- Turqit dhe femrat shkruajnë fjali më të gjata, shkruajnë komente më të gjata apo flasin më tepër.
- Nxënësit maqedonas janë më të hapur në publikim të fotografive në krahasim me nxënësit e tjerë në bazë të gjinive del që meshkujt kanë më tepër se 100 fotografi të publikuara në facebook.
- Nxënësit turq kontrollojnë profilin tyre gjatë orës së mësimi më shumë nga nxënësit e tjerë, meshkujve kontrollojnë profilin e facebook-ut gjithashtu gjatë orës së mësimi.
- Të tri etnitë dhe gjinitë përdorin rrjetin social facebook në shtëpi, besoj prindërit e tyre të jenë në dijeni për këtë gjë.

Po të analizojmë hipotezën kryesore dhe ndihmëse do të shohim që maqedonasit dhe meshkujt janë grupet të cilat më së tepërmi e hapin vetën dhe këto përfundime nuk mbajnë dy hipotezat e mia.

Duke krahasuar të dhënat teorike dhe praktike të përmendura paraprakisht mund të shohim që të dy aspektet kanë pika të përbashkëta dhe nga njëra anë kundërshtojnë njëra tjetrën në pika të tjera.

Të dy hipotezat e mia ajo kryesorja: Po që se gjinitë përdorin internetin njëllë, atëherë femrat do të hapin veten më tepër se meshkujt si dhe ndihmëse: Po që se nxënësit e shkollave fillorë në Gostivar përdorin njëllë rrjetin social, atëherë shqiptarët do hapin veten më tepër se etnitë tjera, dalin që nuk përkrahen në bazë të aspektit praktik gjegjësisht rezultatet e nxjerra në terren dëshmojnë një realitet tjetër.

Përfundimisht mund të thuhet që studimi mbi “*Teoritë bashkëkohore të komunikimit dhe sjellja e gjinive në rrjetet sociale komunikuese*” solli një mori çështjes të cilat nxisin analiza të tjera. Analiza mbi sjelljet e gjinive, etnive, raporteve shoqërore, mënyrat e komunikimit dhe normalisht lidhshmëritë e tyre me teori të komunikimit apo informatikës. Nga ana tjetër përpara vetes kemi një analizë më të detajuar të çështjeve mbi komunikimin ndërkulturor, multikulturor dhe ati gjinor. Këto rezultate përshkruajnë situatën e detajuar të këtyre çështjeve dhe normalisht nxisin fusha të tjera studimi jo vetëm atyre të komunikimit.

Shtojca 1-PYETËSORI

Ky pyetësor¹⁸ ka për qëllim të analizojë situatën e përdorimit të facebook-ut tek nxënësit e katër shkollave fillore në qytetin e Gostivarit. Ekzistojnë ide që nxënësit përdorin facebook-un më tepër se librin. Të tjerë mendojnë që facebook-u u ndihmon njerëzve për tu shoqëruar në mes veti.

Ju lutem ndani **5 minuta** kohë për t'ju përgjigjur këtyre pyetjeve.

Të dhënat tuaja janë të besueshme, anonimiteti është i garantuar. Ju lutem bëhuni sa më të sinqertë.

Të dhëna të përgjithshme:

Gjinia a) mashkull b) femër

Etniteti a) shqiptar b) maqedonas c) turk d) tjetër

Klasa
a) e pestë (V)
b) e gjashtë (VI)
c) e shtatë (VII)
d) e tetë (VIII)

Shkolla:
a) Ismail Qemali
b) Goce Dellçev
c) Vëllazërim Bashkimi
d) Mustafa Kemal Ataturk

e-mail adresa e profilit tuaj ne face book _____

PËRDORIMI I FACEBOOK-UT NË SHKOLLAT FILLORE TË GOSTIVARIT

Ju lutem përgjigjuni duke rrethuar vetëm njërën nga mundësitë

1. Kur keni krijuar profilin tuaj në facebook?

- a) para 1 jave
- b) para 6 muajve
- c) para 1-2 vite
- d) para më tepër se 2 viteve

2. Sa orë në ditë shfrytëzoni facebook?

- a) më pak se 2 orë
- b) 2 orë

¹⁸ Pyetësori është përkthyer në tre gjuhë, dhe të anketuarit janë përgjigjur varësisht etnisë që ata i përkasin.

- c) më shumë se 2 orë
 - d) më shumë se 5 orë
3. Pse keni hapur profilin tuaj në facebook
- a. Për shoqërim, zbavitje
 - b. Për mësim
 - c. Për kureshtje
 - d. E gjithë shoqëria ime kanë facebook, desha të kem edhe unë
 - e. Për të kaluar kohën
4. Sa miq keni të regjistruar në facebook
- a) më pak së 50
 - b) përafërsisht 100
 - c) 200
 - d) mbi 200
5. Ku e përdorni më së shumti facebook-un
- a) në shkollë
 - b) në shtëpi
 - c) tjetër
6. A mendoni që facebook ju pengon në kryerjen e punëve tuaja shkollore
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Ndoshta
 - d) Nuk e di
7. Sa fotografi keni të publikuara në profilin tuaj
- a) më pak se 10
 - b) deri 50
 - c) 100
 - d) mbi 100
8. Sa prej tyre janë gjysmë lakuriqe, lakuriqe?
- a) aspak
 - b) mesatarisht
 - c) shumë
 - d) tjetër
9. Sa herë u shkruani komente miqve, familjarëve?

- a) aspak
- b) rrallëherë
- c) shpesh
- d) çdo herë

10. A e kontrolloni facebook gjatë orës së mësimit?

- a) asnjëherë
- b) ndonjëherë
- c) rrallëherë
- d) shpesh
- e) çdo herë

11. Fotografive të meshkujve u bëj me tepër komente se femrave dhe e kundërta?

- a) po, është plotësisht e vërtetë
- b) jo, nuk është aspak e vërtetë
- d) të dy gjinive njëloj
- e) tjetër

12. Komentet në facebook që ua bëj shokëve apo shoqeve janë?

- a) më të shkurtra se një fjali
- b) 2 fjali
- c) më shumë se 2 fjali

13. Kam frikë të eci natën vetë nëpër rrugë

- a) shumë e vërtetë
- b) aspak e vërtetë
- c) mesatarisht e vërtetë

14. Facebook është humbje kohe për mua! Sa e identifikoni veten me këtë shprehje?

- a) aspak
- b) shumë pak
- c) mesatarisht
- d) tërësisht

15. Është e pamundur të paramendosh këtë shekull pa facebook! Cili është mendimi juaj mbi këtë shprehje?

Shkruani disa ide tuaja si të parandalohet përdorimi i tepërt i facebook

A dëshironi të bëheni mike me mua në facebook? Në qoftë se po, ju lutem më lejoni të analizoj përmbajtjen e profilit tuaj.

Ju faleminderit!

Овој прашалник има за цел да ја анализира состојбата со користењето на facebook кај учениците во четири основни училишта во општина Гостивар. Постојат идеи дека учениците го користат facebook повеќе од книгата. Други пак мислат дека facebook им помага на луѓето за да се дружат меѓу себе.

Ве молиме во рок од 5 минути да им одговорите на овие прашања.

Вашите податоци се доверливи, анонимноста е загарантирана. Ве молиме бидете што е можно по искрени.

Општи податоци:

Род а) машки б) женски

Етнитет а) Албанец б) Македонец в) Турчин г) други

Одделение а) петто (V)
б) шесто (VI)
в) седмо (VII)
г) осмо (VIII)

Училиште а) Исмаил Кемали
б) Гоце Делчев
в) Братство Единство
г) Мустафа Кемал Ататурк

е-маил адреса на вашиот профил на facebook _____

КОРИСТЕЊЕ НА facebook ВО ОСНОВНИТЕ УЧИЛИШТА ВО ГОСТИВАР

Ве молиме одговорете заокружувајќи само една од можностите

1. Кога го создадовте вашиот профил на facebook?

- а) пред една недела
- б) пред 6 месеци
- в) пред 1-2 години
- г) пред повеќе од 2 години

4. Колку часа дневно го користите facebook?

- а) помалку од 2 часа
- б) 2 часа
- в) повеќе од 2 часа
- г) повеќе од 5 часа

5. Зошто сте отвориле ваш профил на facebook
 - а) За дружење, забава
 - б) За настава
 - в) Од љубопитност
 - г) Целото мое друштво има facebook, сакав и ја да имам
 - д) За да ми помине времето
4. Колку пријатели имате регистрирано на facebook
 - а) помалку од 50
 - б) приближно 100
 - в) 200
 - г) над 200
5. Каде го користите најповеќе facebook
 - а) во училиште
 - б) дома
 - в) друго
6. Дали мислите дека facebook ви смета во вршењето на вашите училишни работи
 - а) Да
 - б) Не
 - в) Можеби
 - г) Друго
16. Колку фотографии имате објавено во вашиот профил
 - а) помалку 10
 - б) приближно 50
 - в) 100
 - г) над 100
8. Колку од нив се половина голи, голи?
 - а) воопшто
 - б) просечно
 - в) многу
 - г) друго
9. Колку пати им пишувате коментари на пријателите, роднините?
 - а) никогаш
 - б) понекогаш

в) често

г) секогаш

10. Дали го контролирате facebook во текот на наставата?

а) никогаш

б) понекогаш

в) ретко

г) често

д) секогаш

11. На фотографиите на машките им правам повеќе коментар отколку на женските и обратно?

а) да, тоа е целосна вистина

б) не, не е воопшто вистина

в) на двата рода исто

г) друго

12. Коментарите што им ги правам на facebook на пријателите или пријателките се?

а) пократки од една реченица

б) 2 реченици

в) повеќе од 2 реченици

13. Се плашам да се движам навечер сама на улица

а) целосна вистина

б) воопшто не е вистина

в) приближно е вистина

14. Facebook е губење време за мене! Колку се идентификувате со овој израз?

а) воопшто

б) многу малку

в) просечно

г) целосно

15. Невозможно е да се замисли овој век без facebook! Кое е вашето мислење околу овој израз?

16. Напишете некои ваши идеи како ја замислувате преголемата употреба на facebook _____

Дали сакате да бидете пријатели со мене на facebook? Доколку да ве молам дозволете ми да ја анализирам содржината на вашиот профил.

Ви благодарам!

Bu anketin amaci Gostivardaki mevcut dört ilk okul öğretimlerindeki öğrencilerin facebook durumunu analiz etmehtir. Bazı kişilere göre öğrencilerin facebook'u kitaptan daha fazla kullandıklarına dair görüş belirtilmektedir, diğerlerine göre ise facebook-un öğrencilerin arkadaşlık kurmalarına yardımcı olduğunu belirtilmektedir.

Lütfen 5 dakikanızı ayırıp aşağıdaki anketimizi doldurunuz.

Verilerinizin gizliliği garantidir. Lütfen vereceğiniz cevaplarda dürüstlüğünüzü koruyunuz.

Genel veriler:

Cinsiyet: erkek kadın

Etnisite: a) arnavut b) makedon c) türk d) diğer

Sınıf: a) beşinci (V)
b) altıncı (VI)
c) yedinci (VII)
d) sekizinci (VIII)

Okul: a) İsmail Kemal
b) Goce Delçev
c) Kardeşlik birliği
d) Mustafa Kemal Atatürk

Facebookta ki hesabınızın e-posta adresi: _____

GOSTIVAR İLK OKUL ÖĞRETİMLERİNDEKİ FACEBOOKUN KULLANIMI

Lütfen verilen şıklardan birini seçerek cevaplayınız:

1. Facebook hesabınızı ne zaman açtınız?

- a) 1 hafta önce
- b) 6 ay önce
- c) 1-2 yıl önce
- d) 2 yıl önceden fazla

2. Günde kaç saatinizi facebookta geçirirsiniz?

- a) 2 saatten daha az
- b) 2 saat
- c) 2 saatten fazla
- d) 5 saatten fazla

3. Facebookta hesap açma sebebiniz?
 - a) Arkadaşlık için, eğlence.
 - b) Ders için
 - c) Merak ettiğim için
 - d) Bütün arkadaşlarımın facebooku var, benim de olsun istedim
 - e) Vakit geçirmek için
4. Facebook'a kayıtlı kaç arkadaşınız var?
 - a) 50'den az
 - b) aşağı yukarı 100
 - c) 200
 - d) 200'den fazla
5. Facebook'u daha sıkça kullandığınız yer neresidir?
 - a) okul
 - b) ev
 - c) diğer
6. Facebookun sizin okul işlerinizi yapmanızı önlediğini düşünüyor musun?
 - a) Evet
 - b) Hayır
 - c) Belki
 - d) Bilmiyorum
7. Profilinizde kaç fotoğraf yayınlamaktasınız?
 - a) 10'dan daha az
 - b) 50'ye kadar
 - c) 100
 - d) 100'den fazla
8. Yayınladığınız fotoğraflardan kaç tanesi yarım-çıplak, veya çıplak fotoğraftır?
 - a) hiçbir tanesi
 - b) ortalama
 - c) çoğu
 - d) diğer
9. Facebookta dostlarınıza, ailenize ne sıklıkta yorum yazarsınız?
 - a) Hiç yazmam

- b) Bazen yazarım
- c) Sıkça yazarım
- d) Her zaman yazarım

10. Ders süresinde facebookunuzu kontrol eder misiniz?

- a) Hiçbir zaman
- b) Bazen
- c) Seyrek
- d) Sıkça
- e) Her zaman

11. Erkeklerin veya tam tersi kızların fotoğraflarına daha fazla yorum yazarım,

- a) evet, kesinlikle doğru
- b) hayır, kesinlikle doğru değil
- d) her iki cinsiyete aynı
- e) diğer

12. Facebooktaki arkadaşlarıma yaptığım yorumlar _____ oluşur:

- a) bir cümleden daha az
- b) iki cümle
- c) iki cümleden fazla

13. Akşamları yolda yalnız yürümekten korkarım

- a) Çok doğru
- b) Hiç doğru değil
- c) Biraz doğru

14. Facebook benim için vakit kaybı! Bu beyan ile kendinizi nasıl tanıtırınız?

- a) Hiç te bile
- b) Çok az
- c) Orta
- d) Tamamen

15. Bu yüzyılı facebooksuz düşünmek imkansızdır. Bu ifade hakkında düşünceniz nedir?

16. Facebookun aşırı derecede kullanılmasına önlemleri için fikirlerinizi yazınız:

Benimle facebookta arkadaş olmayı istiyor musunuz? Eğer istiyorsanız, lütfen profilinizin içeriğini analiz etmemi izin veriniz.

Teşekkür Ederiz!

Bibliografia:

- Argandona A., (2008). Consistency in decision making in companies. *Humanasing the firm and the management profession* (http://www.iese.edu/en/files/6_40617.pdf).
- Aziri E., *Sociologjia*. Arberia Design, Tetovë.
- Banjaluka-news, (25-Novembar-2010). *U novum Sadu otvorena klinika za odvikavanje od Facebooka* (<http://www.banjaluka-news.com/regija-i-svijet/4414-u-novom-sadu-otvorena-klinika-za-odvikavanje-od-facebook>).
- Bodin, A. M. (1934 renewed 1962). *Paul Watzlawick: A Commemoration*.
- Chandler, Daniel (1995). *Cultivation Theory*. UWA.
- Changing Minds.org. (2002). *Reframing*
- Cincilei D., (2009). Facebook users want the old Facebook back. *Internet stories Blog* (<http://danielfive.com/facebook-design-sucks-facebook-users-facebook/>).
- Communication: Examining Perceptions and Accuracy. *Cyber Psychology and Behavior*.
- Cornetto K., Nowak K. (2006) Utilizing Usernames for Sex Categorization in Computer-Mediated
- Craig, B. (24-January-2010). *Meta discourse*.
- Fakti, (7-Dhjetor-2010). *Varshmëria nga Facebook*.
- Frasier T., (2010). Addicted to Facebook. *Teen Talk*.
(http://www.youngwomenshealth.org/PDFs/Teen%20Talk%20Archives/2010_Spring.pdf)
- Gaudin Sh., (12-July-2010). Women say they're increasingly addicted to Facebook. *Computer World* (http://www.computerworld.com/s/article/9179100/Women_say_they_re_increasingly_addicted_to_Facebook).
- Grej Xh., (2001) *Meshkujt vinë nga Marsi Femrat nga Venera*. Globus R, Tiranë
- Griffin E. (2005). *A first look at Communication Theory*. McGraw-Hill Higher Education.
- Guiller L., Durndell A. (2006) "I totally agree with you": gender interactions in educational online discussion groups. *Journal of Computer assisted learning* 22, pp 368-381.
- Herring S., Paolillo J. (2006) Gender and genre variation in weblogs. *Journal of Sociolinguistics* 10/4, 2006: 439-459.
- Heylighen F. Joslyn C. (Novembre 1, 1992). *What is System Theory*. Principa Cybernetica
- Honors: Communication Capstone. (14-February-2001). *Communication Pragmatics/Interactional View*.
- Huber H., (1995). Internet theory. *Hans Dieter Huber* (<http://www.hgb-leipzig.de/ARTNINE/huber/writings/internete.html>).

Huber D.H. (1995). *Internet Theory*.

(<http://www.hgb-leipzig.de/ARTNINE/huber/writings/internete.html>)

Jaffe J., Lee E., Huang L., Oshagan H. (1998) Gender Identification, Interdependence, and Pseudonyms in CMC: Language Patterns in an Electronic Conference.

Koha, (2010, Shkurt 10). *Koha e tepërt në internet çon në depresion*, f20.

Krivak Th. (2008) Facebook 101: Ten Things You Need to Know About Face book. *The Newspaper for Users Producers of Electronic Information Services* 42 (2008) 41-45

Krolokke Ch. "Impossible Speech"? Chat and Feminist Linguistic Theory. *Women and Language*, Vol.26, No.2, Pg. 5

Lawrence J. (Fall-2006). *The Interactional View Applied to a Practical Relational Communication Problem*.

Lee, E. (2007) Effects of Gendered language on tender stereotyping in computer mediated communication: the moderating role of depersonalization and tender-role orientation. *Human communication research* 33 (2007) 515-535.

Lee E. (2007) Wired for Gender: Experientiality and Gender-Stereotyping in Computer-Mediated Communication. *Media Psychology*.

McLuhan, M (1964). *Marshall McLuhan Foresees The Global Village*.

Moore N. (2006). *How to do a research. A practical guide to designing and managing research projects*. Bodmin, Cornwall: Facet Publishing

Norton & Company New York. London National Communication Association Orr D. (1994) Not only gender: more on debating markets. *Feminist Economics* 3 (1), 1997, 121-126

Nettadiction, (1995). The center for internet addiction. *Netaddiction* (<http://netaddiction.com/>)

O'Neill N., (8-July-2010). Yes, Young women are addicted to Facebook. *All Facebook*.

(<http://www.allfacebook.com/women-addicted-facebook-2010-07>).

Parks M., Roberts L. (1999) The social geography of gender-switching in Virtual environments on the internet. *Information, Communication & Society* 2:4 1999.

Perez Yamilé. Cognitive Consistency Theory. *Motivation* (<http://astro.temple.edu/~yperez/Consistency.htm>)

Rajani, Meena Kumari, and Chandio M.S. (2004). *Use of Internet and its effects on our Society*, f.157-161.

National Conference on Emerging Technologies.

Reiner R., (1989). When Harry met Sally. *The Internet Movie Database*.

(<http://www.imdb.com/title/tt0098635/>).

RingsWorld.com (2005). *The spiritus Temporis Web Ring Community*.

Savicki, V., Kelley, M. (2000) Computer Mediated Communication: Gender and Group Composition. *Cyber Psychology & Behavior*, Number 5,2000.

- Shvoong. (13-November-2005). *Pragmatics of Human Communication*.
- Silverman, David (2005). *Doing a Qualitative Research*. Trowbridge Wiltshire. SEAGE Publications.
- Soukup, Ch. (1998). The gendered interactional patterns of computer-mediated chat rooms: a critical ethnographic study. *National Communication Association* (169-170).
- Tannen D, (4-July-1999). Genderlect Styles of Deborah Tannen. *University of Southern Maine-Communication*. (<http://www.usm.maine.edu/com/genderlect/index.htm>)
- Tannen D, (4-July-1999). Genderlect Styles of Deborah Tannen. *University of Southern Maine-Communication* (<http://www.usm.maine.edu/com/genderlect/sld008.htm>).
- The Bell System Technical Journal. (October-1948). *A Mathematical Theory of Communication*.
- Walther J., Heid B., Kim S., Westerman D., Tong S. (2008) The Role of Friends' Appearance and Behavior on Evaluations of Individuals on Face book: Are We Known by the Company We Keep? *Human Communication Research* **34** (2008) 28-49.
- Watzlawick, P., Beavelas B.J., Jackson D. D. (1967). *Pragmatics of Human Communication-A study of Interactional Patterns Pathologies, and Paradoxes*. W.W.
- WebMD (2010). *Symptoms of Depression*. Better information. Better health.
- Wikipedia, (11-Janyary-2010). Compete.com. *Wikipedia the free Encyclopedia* (<http://en.wikipedia.org/wiki/Compete.com>).
- Wikipedia, (1-March-2010). Facebook. *Wikipedia the free Encyclopedia* (<http://en.wikipedia.org/wiki/Facebook>).
- Zacharias U., Arthus J. (2008) Commentary and Criticism. *Feminist Media Studies*, Vol 8, No. 2, 200.